



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

00 Numër: 145/2025
Data: 23.07.2025



Komuna e Istog
Opština Istok
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>
Tel: 038/200 438 14

KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG
Për: Të gjithë anëtarët e Kuvendit të Komunës-Istog

Në bazë të nenit 43 neni 45 dhe neni 47 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe neni 48.3 të Statutit të Komunës së Istogut 01Nr.62/2010, neni 5 i Udhëzimit Administrativ MAPL Nr.02-2015 për Mbajtjen e Mbledhjeve të Kuvendit të Komunës.

T H Ë R R A S

Mbledhjen e 40-të të rregullt të Legjislacionit të VII-të të Kuvendit të Komunës.
Mbledhja do të mbahet më: **31.07.2025, e Enjte**, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, kati III, duke filluar me punë në ora 10:00.

R E N D D I T E:

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
3. Shqyrtimi i raportit financiar për tre mujorin e dytë të vitit fiskal 2025,
4. Njoftim me Raportin e punës së Kryetarit të komunës për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025,
5. Njoftim me Raportin e punës së KKS-së për gjashtë mujorin e parë të vitit 2025,
6. Shpallja në Diskutim Publik mbi Planin Strategjik për Përfshirje Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025-2027,
7. Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr. 98/2025 i datës 30.05.2025
8. Rishqyrtimi i Vendimit 00 Nr.127/2025 i datës 25.06.2025,
9. Diskutimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2024 dhe miratimi i Planit të Veprimit për Eliminimin e të metave të rekomanduara nga AP,
10. Shqyrtimi dhe miratimi i Rregullores për Subvencione,
11. Të ndryshme.

Vërejtje :

Lidhur me çështjen e mospjesëmarrjes në mbledhje,
t'i referoheni dispozitës së nenit 39 paragrafi 39.8 të LVL.

Kryesuesi i Kuvendit
z. Enver Rugova

E Rugova





Republika e Kosovës

Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istogut

Opstina Istok
Istog Municipality

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi RAPORTI I PUNËS PËR GJASHTËMUJORIN E VITIT 2025

Raporti është hartuar bazuar në procesverbalet nga mbledhjet e KKSBB-së për periudhën raportuese.

Nr	Emri i iniciativës/projektit	Përshkrimi i iniciativës/projektit	Raporti mbi realizimin e iniciativës/ projektit
1	Problemet e infrastruktures që ndikojn në siguri, në zonat urbane të minoriteteve	Të ftohen në bashkëbisedim Drejtorati i Urbanizmit dhe i Sherbimeve Publike	Rasim Mahmutoviq, Shef i ZLK-së- ZLK-ja punon sipas planit të kontakteve me përfaqësuesit e komuniteteve. Bazuar në të dhënat nga përfaqësuesit e komuniteteve situata e përgjithshme është e qet dhe stabile me disa probleme që koh pas kohe i shqetsojnë qytetarët por që nuk ndikojn në situatën e përgjithshme të sigurisë së komuniteteve. Shqetsimi kryesor që ka qenë në kohët e më hershme viedhjet qoftë të objekteve të banimit apo kafshëve në komunitete tani së fundmi nuk janë shqetsim me që ka përmirësime të dukshme. Kërkesat e komuniteteve të cilat mund të ndikojn pozitivisht në sigurinë e komuniteteve e që kanë të bëjnë me projekte janë: -Ndertimi i trotuarit dhe ndriçimit publik në Rr. Sarajevska si dhe shenjat horizontale, gjegjësisht pengesat horizontale në rrugë. -Rregullimi i rruges Serbobran-Osojan e cila ka gropa të mëdha dhe thuajse është e pa kalueshme -Deponitë e mbeturinave në Llukavc të Begut
2	Mbrojtja e pyjeve nga zjarret	Të ftohen në bashkëbisedim nga Ministria e	Haki Belaj, inspektorin e parandalimit - me që jemi para një sezoni që do të jetë tejte e nxehtë dhe me mungesa të të reshurave atmosferike. Duhet të jemi tejte përgjegjës gjithë qytetarët e Komunes në ndërmarrjen e masave

	Mirmbajtja e rrugve malore	Bujqësis,Drejtora i Bujqësis Inspektori i Preventives AME	preventive per parandalimin e zjarreve dhe ti zbatojm udhizimet per mos ndezjen e zjarreve në hapsira. Sa ju perket institucioneve duhet që ti kryejm të gjith detyrimet dhe më lejoni të theksoj se Agjencioni i Pyjeve e ka detyr parsore si menaxhimin poashtu edhe mbrojtjen qoft nga prerjet poashtu edhe nga zjarret , ndersa ne si NJPZSH jemi mbeshtetes në mbrojtjen e pyjeve nga zjarret. Ne e kemi bër një shkres zyrtare Agjencionit për masat të cilat duhet ti ndermarrin në mbrojtjen e Pyjeve nga zjarri dhe njëkohcisht i kemi informu me kapacitetet e limituara si në teknik poashtu edhe në personel. Tani do hyjm edhe në fazen e fushates së korrjeshirjes e cila do të jet mjaft sfiduese në këto temperatura, andaj ftoj që të gjithë që ti zbatojn kompetencat e veta dhe të jen të ndergjegjshëm në zbatimin e tyre. Shfrytzoj rastin që të bëj apel tek bujqit dhe tek Drejtoria e Bujqësisë që fushat e korrura të lavrohen menjëhere për ti evituar zjarret fushore dhe perhapjen e tyre duke rrezikuar edhe objekte banimi etj. Rifat Dreshaj, Agjencioni i Pyjeve të Kosovës – si Agjencion i kemi bër pergatitjet për mbrojtje nga zjarret dhe per momentin nuk kemi këso problemesh, ballafaqohemi me prerjet ilegale por edhe këto kanë rënje të dukshme. Astrit Hajrizaj, Drejtor i Drejtoratit të Bujqësis – sa i perket mirëmbajtjes së rrugve malore jemi per momentin duke punuar në tri akse rrugore, të cilat perpos krijimit të kushteve të mira për fermer dhe vizitor të bjeshkëve krijojn edhe kushte optimale në aspektin e siguris duke ju ofruar kushte qarkullimi si Policis, KFOR-it dhe në raste emergjente qoftë zjarrëfikësve qoft autoambulancave. Në të kalueren sa ka qen sektori i Pylltaris në kuader të Drejtyoratit kemi pas bashkëpunim të mirë me zjarrëfikës, Polici dhe institucione tjera dhe shpresoj se edhe tani në kuader të pergjegjsive tona të vazhdojm bashkëpunimin e mirë. Sa i perket korrjeshirjeve kemi formuar shtabin dhe pergatitjet lidhur me këtë fushat. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar – a ka ndonjë struktur e veçant në Komunë e cila është pergjegjëse që merret me planifikimin dhe masat e parapara për parandalimin e zjarreve. Ndersa sa i perket rrugve malore çka nënkuptojm me termin rrug malore a janë vetëm ato kah qarkullojn
--	----------------------------	---	--

automjetet apo edhe rrugët kah levizin këmbësorët apo turistët sepse të njëjtat pothuejse janë mbyllë, a janë të perfhira edhe këto për hapjen e tyre.

Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave-Koordinator i KKS-së

– Në kuader të Administratës komunale funksionon Drejtoria për Emergjenca, Mbrojtje dhe Shpëtim, e cila bazuar në Legjislacionin për menaxhimin e fatkeqsive natyrore është përgjegjëse për planin e Vlersimit të rrezikut dhe hartimin e Planit Operativ Emergjent, ku perfatkeqsi të ndryshme parashihen institucionet bartëse dhe institucionet mbështetëse. Nga referimet e zyrtarve ju patet mundsi ta verejini se sa ju perket zjarreve i kemi tri institucione që reagojnë por u tha kush është bartësi i përgjegjësisë. Kur sektori i Pylltarisë ishte pjesë e Drejtoratit të Bujqësisë, Nga niveli qendror gjegjësisht nga Ministria e Bujqësisë për tërë territorin e Kosovës i prenonte një numer Zjarrëfikësish, në Istog kanë qenë katër, si vrojtues të pyjeve për të kryer detyrën e parandalimit dhe lajmërimit të hershëm në raste zjarresh. Sa i perket NJPZSH-së në Istog janë nën menaxhimin e Drejtorisë por janë staf i AME-së dhe kapacitetet janë të limituara si në personel (10 zjarrëfikës) poashtu edhe në teknik. Pa marrë parasysh Ligjin për vetqeverisje Lkale dhe legjislacionin në fuqi ku parashihen shumë obligime gjegjësisht detyrime Komunave, niveli Qendror çdo ditë e më shumë është duke i marrë kompetencat por që legjislacioni mbetet i njëjt si detyrime të Komunave. Ligji i fatkeqsive natyrore e obligon çdo qytetar të ndermerr masat për mbrojtje nga fatkeqsi natyrore dhe fatkeqsi tjera. Dalja e turistve apo qytetarve për piknik në bjeshkë duhet menaxhuar ku dhe si dhezin zjarmije dhe këtë do të duhej ta rregulloj dhe ta përciell Agjencioni i Pylltarisë si përgjegjës për Pyjet dhe bartës e reagimit eventuale në zjarre malore, andaj nese nuk e kanë bërë deri me tani do të duhej të marrin masa për senzibilizimin e opinionit dhe parandalimin e ndezjes së zjarreve në vende të hapura. Gjitha parashikimet hidrometeorologjike janë që ky vit do të jetë tejet i nxehtë dhe i thatë andaj rreziku nga zjarret është potencial, kur kësaj i shtohet edhe mungesa e ujit në regjionin e mbivades si e quejmë ne por jo vetëm dhe kërkesat e shumta për furnizim me uj, e që në të kaluarën e kemi bërë me zjarrëfikës të cilët janë në ndërrim, këtë vit duhet menduar dhe kërkuar një zgjidhje tjetër ose të angazhohet staf si punë shtesë në kohën e lirë të tij

			ose të ngarkohet institucion tjetër. Numri i kufizuar i Zjarrëfikësve nuk është problem vetëm i Istogut por i Krejt Kosovës anadaj në takimin e OSBES-së në Pejë Drejtoresha e Emergjencave e Prizrenit e ngrit si çështje me që ishin të Pranishim zyrtar nga MPB-ja edhe pse jo nga AME-ja, por me kërkesë që tju transmetohet ky shqetsim i Komunave. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar – pikrisht këtu ishte fokusimi i pyetjes sime tek vrojtimi, parandalimi dhe lajmrimi i hershëm, a do të thotë se po egzistojka ky sherbim. Është e rëndësishme që qytetarët të shohin se po egzistojka ky sherbim dhe kanë tjetër qasje kur janë të vetdijshëm se këta zyrtar janë prezent. Haki Belaj, inspektorin e parandalimit - Agjencioni Pyjor e ka Planin e Menaxhimit të Pyjeve, e në kuader të saj edhe Planin e mbrojtjes nga zjarret. Aktivizimi i hershëm i ketyre Planeve është i domosdoshëm dhe është preventiv dhe sukses i reagimit. Do të ketë vizita sbashku me Policinë dhe Agjencionin e Pylltarisë në senzibilizimin e opinjonit dhe nëse si Drejtori kemi shpall edhe njoftime në mediat lokale. Rifat Dreshaj, Agjencioni i Pyjeve të Kosovës – sa i përket monitorimit, pylltarët janë 24orë në teren dhe kemi hapsirë për parandalim, sidomos vikendeve kur ka fluks më të madhë të vizitorëve. Në rast të zjarreve në tentojmë të ndermarrim masë dhe të ndalim zjarrin mirpo nëse është i permasave të mëdha ne e lajmrojmë rastin sepse nuk kemi kapacitete.
3	Konsumimi i drogave, tabaqeve dhe alkolit nëpër shkollat-teritorin e Komunës	Raport i Policisë, OJQ “Labirinti” Ftohen Kryetaret e këshillave të nxënësve dhe prindërve	Safet Blakaj, Drejtor i OJQ “Labirinti- Drogat janë të ndryshme por ajo që është më e përhapura në territorin e Kosovës është Marihuana. Sipas statistikave në Kosovë edhe pse mund të konstatojmë se nuk janë 100% të sakta por keto i disponojmë në Kosovë janë rreth 42.000 përdorues të drogave. Ne i ndajmë në dy grupe dhe atë: përdorues të drogave, kjo kategori janë përdorues të kohëpaskoshme, pra jo të rregullt dhe kategoria e dytë; përdorues problematik dhe në këtë kategori kemi 12-14.000 pra kjo kategori janë përdorues të mvarur nga drogat të cilët bien ndesh me Ligjin, konflikt me familjen dhe rrethin shoqëror. Moshë mesatare e përdoruesve ka qenë 35-45 vjet ndërsa nga viti i kaluar kjo mesatare ka rënë 25-27 vjet. Mvarsia nga droga është tejet e shpejtë dhe po që se nuk zbulohet në stazat fillestare të përdorimit atëherë mvarsia bëhet problematike dhe kryesisht

		këta perdorin tipin e droges Kokain. Kjo është droga më e shtrejt deri me tani. Natyrisht se ne bëjm ndarjen në regjione dhe këtu prinë Regjioni i Prishtinës, natyrisht për shkak të dinamikave të zhvillimeve në Kryeqytet. Perpara ka qën Gjilani si regjioni i dytë për kah perdoruesit tani si regjion i dytë është Ferizaji ndersa Gjilani ka rën në vendin e tretë , e pasuar nga Mitrovica ku hyjn edhe perdoruesit nga Mitrovica e Veriut dhe veriu në pergjithësi. Ajo çfar është fokusi i këtij takimi është Regjioni i Pejës. Sipas statistikave Peja ka numrin më të vogel të perdoruesve, megjithatë ne kemi të dhëna të besueshme nga tereni që tregojn tjera shifra në krahasim me statistikën, por serish janë më të ulta se në regjionet tjera, megjithatë kto të dhëna tregojn se po ndodh diçka e keqe edhe në Regjionin e Pejës. Kur e analizojm Regjionin e Pejës tani na intereson ku qendron Komuna e Istogut dhe ta bëjm një krahasim të Komunës me Komunat në tër Kosovën. Istogu dhe Dragashi janë dy komunat që kanë numrin më të vogel të perdoruesve të drogave në Kosovë. Nëse e krahasojm Istogun me Lipjanin si dy Komuna perafersisht të madhësis së njëjt, na del se Lipjani ka numer shumë më të madh të perdoruesve dhe kjo për arsyen që Lipjani graviton ma afer Kryeqytetit dh kjo ka ndiku në perhapje më të shpejt. Para dy viteve kemi vrejt një dukuri të çuditshme perhapjen me shpejtsi enorme tek Komunitetet RAE në Fush Kosovë, Gjilan, Prizeren etj, qe na bën me dije që nuk janë ma vetem shtresat e pasura fokus i shperdarsëve të drogave. Në Istog i kemi disa raste të perdoruesve të Kokaines, kur këto raste i krahasojm me komunat tjera nuk paraqesin shqetsim si statistik edhe pse deshira është të ket zero perdorues të drogave. Fokusi jonë kryesor është në parandalimin e perdorimit të drogave, jemi në perpjekje të vazhdueshme që së bashku me strukturat Nacionale të hartojm strategji dhe sistem të parandalimit të perdorimit të drogave, shpresojm që së shpejti të arrijm deri te ky program. Në këtë aspekt gjithnjë fokusi ynë është siguria në Shkollë. Para 15 vitesh mosha mesatare e fillimit apo perdorimit per her të par të droges ka qen mbi 21 vjet. Tani kjo mosh ka ra në 16 vjet, në disa raste ekstreme kemi numer të vogel edhe me 12 apo 13 vjet por janë raste simbolike. Rreziku më i madhi tani është nga mosha 15-17 vjet dhe fokusi
--	--	---

		jonë është kjo grupmosh. Kur flasim për këtë grupmosh domosdoshmerisht përmendet Shkolla me që kjo kategori janë ende në Shkolla, por berdorimi bëhet edhe jashta Shkollave dhe gjithnjë shtrohet pyetja pse spondermarrim diçka në Shkolla. Synimi është që ti përgatisim Psikologët e Shkollave, zyrtar në QPS-të që të mbahen ligjerata neper shkolla dhe të jen më të përgatitun që nga afer të vrejndryshimet dhe zbulimet e hershme eventuale apo si e quejm ne profesionalisht “ Identifikimi i hershem i perdoruesit të droges” gjë që mundson marrjen e masave në sherimin e hershem që është ma i lehtë. Identifikimi i vonshem i perdoruesit të drogave krijon veshtersi në marrjen e masaveqofshin ato represive qofshin sheruese. Për fillim kaq jam i gatshem tju përgjigjem pyetjeve. Enver Balaj, Kryesues i këshillit të prindërve të Arsimin në Komunë- pas identifikimit si e beni trajtimin e perdoruesve të drogave, a i dergoni në sherim apo cili është tretmani i më tutjeshem. A organizoni ligjerata neper shkolla në këtë tem në nivel vendit. Safet Blakaj, Drejtor i OJQ “ Labirinti- kur janë në pyetje moshat e reja gjegjësisht nxënës të Shkollave, faza fillestare është permes prindërve dhe QSP-së. Natyrisht se duhet të bëhet një vlersim për llojin e droges së perdorur, kohëzgjatjen e perdorimit dhe kjo nuk mund të arrihet vetem me vlersime psikologjike por kerkon edhe vlersime biologjike, në organizaten tonë nuk kemi trajtim terditor por vetem permes seancave. Nese nuk kan simptome psikologjike athere vie në shprehje vetem intervenimet mjeksore që të bëhet pastrimi i trupit, ndersa në raste të rënda mvarsie dhe problemeve psiqike ather duhet trajtimi hospitalor dhe kemi bashkpunim me qendrat psikologjike. Ndersa qëndrave për trajtim afatgjat ju ikin edhe vet pacientet gjegjësisht perdoruesit e drogave sepse edhe ata janë të vetëdijshëm se mund tja dalin edhe me metoda tjera. Edhe Evropa është duke ju ikur qendrave afatgjate të trajtimit sepse vet perdoruesit po ju ikin ketyre qendrave. Ukë Dollci, perfaqshues i Komuniteti Egjiptas- e përmendet komunitetin RAE si perdorues në kohen e fundit pyetja a jënë qytetar të kthyer nga perendimi apo janë vendas nese mund ti quaj ashtu, a ndermerr Policia masa.
--	--	---

		Safet Blakaj, Drejtor i OJQ “ Labirinti- një pjesë e tyre janë të kthyer nga vendet perëndimore, shqetsimi jonë kryesor është shembull numri i madh i përdoruesve në Fushë Kosovë dhe Plemetin që për një kohë shumë të shkurt ka marrë përmasa shqetsuese, sepse nuk kemi prit që aty të ketë përdorues të Heroines për vetëm një vit e gjysëm 72 persona si përdorues të rregullt ka qenë tejet shqetsuese sikur të kishin qenë vetëm përdorues të Marihuanes edhe nuk do të ishte aq problem për neve. Sepse ky është komunitet tejet i vogël. Pjesa më e madhe e tyre janë kyq në programet tona, dikur 58 prej tyre janë në programet tona rehabilituese. Zenun Bujupaj, Komuniteti Shqipëtar – prezantohet për të pranishmit, nuk e di a është kompetencë e juaja apo a keni njohuri për kanalet e furnizimit, a janë të identifikueshme grupe të organizuara trafikantësh, a mund të bëhet ndërprerja e këtyre kanaleve dhe pyetja e dytë a mund të bëhet kategorizimi i grupeve si shtresa shoqërore gjegjësisht të pasur të mesme apo të varfëra. A ka Kosova kapacitete të mjaftueshme për trajtimin e përdoruesve të drogave për t'i rehabilituar, për t'i kthyer në bashkëpunëtor për parandalimin e përdorimit të drogës dhe a ka statistika për trendin a është në rritje apo si qëndron gjendja. Safet Blakaj, Drejtor i OJQ “ Labirinti- Trendi mvaret sipas llojit të Drogave, ka vit që përdoret një lloj ndërsa tjetri vit është tjetra drogë, sidoqoft trendi i përgjithshëm është në rritje, bile në rritje të shpejtë dhe është shumë afër nivelit që të bëhet alarmante. Përdoruesit e Heroines i kemi nën vëzhgim dhe kontrollë, përdoruesit e marihuanes dhe kokainës nuk i dimë dhe nuk i kemi në kontroll. Sa i përket trajtimit po me trajtim merret Labirini, kemi Klinika private, qendra tjera rehabilitimi në komunitet dhe sa i përket rezultateve krejtë mvaret nga programi që e ndërmerr çdo njëra nga këto qendra. Ndërsa sa i përket shtresave sociale, viteve të fundit gjithçka ka ndryshu, pa marrë parasysh shtresë sociale apo ekonomike tanimë të gjitha janë target grup. Edhe Familja funksionale apo mirë e organizuar një ditë e vren fëmijën si përdorues njëjtë si ato familjet më dobët të organizuara, e kur vjen çështja të trajtimi atëherë kemi lehtësi në trajtim tek familjet e mirë organizuara.
--	--	--

			Nuk kemi has grupe të strukturuar të trafikantëve të drogave. Droga Heroina ka ardh nga Turqia në Ballkan dhe per Evrop, Kokaina dhe kanabisi janë më të shtrejta dhe pak konsumohen tek ne, kryesisht janë vetem si rrug kaluese per Evrop. Pra janë kryesisht individ që trafikojn nga jashta dhe piksynim e kan Evropën. Çështja është sa janë këta trafikant të inkriminuar në rrjetet egzistuese në Evrop, sa ndikojn njëni të tjetri, unë nuk jamë njohës i mirë i fushës së siguris por këto janë njohurit tona.
4	Shitja/Blerja e Ushqimit të përditshëm, data të skaduara, prodhim i pa kontrolluar	Të ftohen në bashkëbisedim përfaqësues të AUK- mbrojtja e konsumatorit dhe inspeksioni i Istogut	Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines – Në kuader të zyrës regjionale veprojm dy sektore ai i Veterines dhe ai i Sanitaris me nga dy Inspektor që është numer tejet i vogel per ta mbuluar regjionin e Pejës. AUV ka per detyr krijimin e kushteve për ushqim të sigurt dhe për të permbushur këtë detyr AUV merr produkte ushqimore qoft në Dogan apo në markete dhe i bën analizat, a i plotsojn gjitha kriteret për treg. Këto i bën me kontrolla të rregullta apo bazuar në kerkesat dhe shqetsimet e konsumatorve në rate të veçanta. Kemi kryer inspektime në komunën e Istogut dhe ka raste kur kemi shqiptuar edhe denime në raste të skadimit të afateve të gjerave ushqimore. Mund të kostatojm se gjendja në pergjithësi në Istog është e mirë megjithatë për ta konsumuar në pergjithësi këtë tem është dashur të jet edhe Inspektori Sanitar prezent sepse është pergjegjësi e tij a ka ndonjë produkt i cili shitet jashtëligjshëm apo që biznesi nuk e ka të drejtën ta shesë në veçanti per lokalet në afersi të Shkollave. Tani do ta kemi një problem në organizim me që Inspektori Sanitar ka kaluar në kuader të Ministris së Shendetsisë. Xhavit Blakaj, Inspektor i Veterinës Istog- pës ditë në javë bëjm inspektime të rregullta në thertoret e licencuara, gjithashtu inspektimet i bëjm edhe në mishtore dhe në markete. Problem na paraqesin fshatrat për inspektime të rregullta a shesin produkte të mishit dhe a bëhet therja sipas Ligjit. Fillimisht kaqnga ana ime jamë i hapur për pyetje. Blerim Gerguri, KLSP-Gurakoc- ka qen një shqetsim medial lidhur me importin e mishit të pules nga Brazili, a ka ndonjë informat lidhur me veprimet e AUV-ut per këtë çështje.

			Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines – janë marrë mostrat e këtij produkti dhe nuk ka figuruar me ndonjë problem për të cilin do të ndalohej konsumimi i këtij produkti. Kemi pas raste kur kemi ndaluar komplet importin për konsum. Naim Behluli, Drejtor i DKA-së- kërkoj që Inspektori sanitar ti inspektoj lokalet dhe kiosqet në afersi të Shkollave dhe të konstatoj a shitën produkte ushqimore jashta licences, a shiten cigare me copë dhe të na informoj lidhur me këtë shqetsim të prindërve të nxënësve. Enver Dembogaj, Inspektor pran Agjencionit të Ushqimit dhe Veterines –Planet janë që në kuader të AUV-së të pranohen Inspektor të sigurisë ushqimore dhe shpresojm që së shpejti të kryhet ky proces. Xhavit Blakaj, Inspektor i Veterinës Istog- ka pasur raste kur kemi dal në inspektim së bashku me inspektorin e tregut dhe i njëjti ka shqiptu edhe denime për parregullsit në biznesin e inspektuar. Por ka një seri çeshtjesh që nuk janë kompetenc e këtij Inspektori por të atij Sanitar. Ali Nimanaj, Nënkryetar i Komunës – shihet qart nga diskutimet që një seri çeshtjesh janë të Inspektorit sanitar andaj për mbledhjen e radhes të ftohet Inspektori dhe të na jep pergjigje në shqetsimet e ngritura. Me që nuk ka më pyetje kalojm në piken e radhes të rendit të ditës. Skender Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave-Koordinator i KKSB-së – Inspektorja sanitare që mbulon Komunen e Istogut është në pushim të lehonis dhe ky sektor ka kaluar në kuader të Ministris së Shendetsisë nuk kemi arritur që ta sigurojm prezencen dhe raportimin për mbledhjen e muejit Qershor andaj kjo pjes e raportimit është bart për mbledhjen e radhes.
--	--	--	---

Sipas Planit Vjetor të punës KKSB-ja ka mbajtur tri mbledhje në gjysem vjetorin e parë të vitin 2025.

Tema tjera që janë diskutuar jashtë planit të punës e që kanë të bëjnë me sigurin janë:

- Janë shtruar kërkesa për intervenime në shënja të komunikacionit dhe në sigurinë në përgjithësi në komunikacion.
- Janë shtruar kërkesa për intervenime në trotuare dhe në ndriçim publik për siguri të nxënësve dhe qytetarve në veçanti komuniteti Boshnjak në Dobrushë.
- Nga komuniteti serb është ngritë shqetësimi për gërmimet në pronat private në Lubozhdë. Policia e Kosovës ka dhënë sqarime se gërmimet janë bërë sipas Planit nga Ministria në Zonën Arkeologjike Lubozhdë-Vrellë dhe se çdo gërmim që bëhet nese nuk

ka gjetje, atëher prona, gjegjësishtë vendi kthehet në gjendjen e më parshme dhe Policia ju ka dhën sqarime qytetarve të prekur nga ky veprim.

- Shqetsim janë deponit ilegale të mbeturinave edhe pse janë pastruar nga Drejtoria për sherbime publike, por sërish krijohen nga qytetarët
- Ndotja e ambientit nga zjarret duke dhezur rrotoballa të kalbura apo goma
- Lënja e mbeturinave pas vetes në ditën e tregut pergjat rruges
- Shqetsim ka qën prezenca e numrit të madhë të qënve endacak dhe sulmet ndaj qytetarve.

1. Siguria në zonën e pergjithëshme të Policisë së Kosovës-Stacioni Istog

- Tog. Ramadan Gashi, Shef i Njësisë së Hetimeve i St. Policisë Istog – Situata në zonen e pergjegjësisë është e qet dhe stabile. Stacioni i Policisë vazhdon të punoj në bazë të Planeve Operative si dhe në bazë të Planeve dhe urdhërave nga niveli qendror dhe nga Komanda regjionale.Në vazhdim do ti paraqes disa statistika në krahasim me të njëjtën periudh të vitit të kaluar.
- Raste të inicuar, kemi ngritje krahasuar me periudhën e njëjt të vitit 2024
- vepra (kundervajtje dhe penale), kemi ngritje për 10 raste ma shumë
- Zbulueshmerua e 70.8% e rasteve në pergjithësi
- Aksidente trafiku, në krahasim me periudhën e njëjt të vitit 2024, ka rritje 100%, që është shqetsuese
- Në fillim të muejit kemi pas 1 tentim vrasje në Vrellë, në një ndermarrje kanë qën 3 punëtor njëni nga ta është i arrestuar dhe është në arrest shtepiak për rastin vrasje në tentativ
- Sa ju perket urdhëresave nga Prokuroria apo Gjykata për ndalesa-arrestime aktive janë vetëm 4, për arsye se të kerkuarit gjinden jashtë shtetit
- Zbulueshmeria e rasteve në krahasim me të njëjtën koh të vitit të kaluar është 76% që është shumë më e madhe
- Dhuna në familje kemi besueshmeri më të madhe në Polici dhe nuk hezitohet të paraqiten rastet
- Falë punës së Policisë në komunitet në Shkolla e kemi gjendjen shumë të mirë në krahasim me vitin e kaluar, kur ka të bëj me veprat kryesisht që kryhen nga nxënësit
- Këtë muej kemi Plan Operativ në ndalimin e ndertimit të staneve në bjeshkë dhe atë kryesisht në Parkun Nacional me kërkes të nivelit Qendror

Koordinatori i KKSB-së
Skender Hasangjekaj



PLANI STRATEGJIK PËR PËRFSHIRJE SOCIALE TË FËMIJËVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Komuna Istog, Kosovë

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës

Jam shumë krenar që Komuna e Istogut ka hartuar dhe miratuar Planin Strategjik për Përfshirje Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara për periudhën 2025–2027 – një dokument gjithëpërfshirës dhe konkret, me masa të qarta, të realizueshme dhe me kosto efektive, që synojnë zhbërjen e barrierave dhe përfshirjen e barabartë të fëmijëve me aftësi të kufizuara në çdo aspekt të jetës publike.

Ky plan është rezultat i një procesi të gjatë, të përkushtuar dhe thellësisht bashkëpunues. Ai është ndërtuar mbi takime të shumta, konsultime me qytetarë, institucione, organizata joqeveritare dhe profesionistë të fushës, për të reflektuar me besnikëri nevojat reale, specifike dhe urgjente të këtij grupi të ndjeshëm në komunitetin tonë.

Objektivat që dalin nga ky dokument nuk janë vizione të largëta – por masa të matshme, të cilat do të sjellin ndryshim të prekshëm në jetën e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, duke forcuar shërbimet sociale, mbështetjen arsimore, kujdesin shëndetësor dhe mundësitë për përfshirje kulturore, rekreative dhe në tregun e punës.

Një mirënjohje e veçantë shkon për Grupin Punues që ka kontribuar me përkushtim të jashtëzakonshëm në hartimin e këtij plani, si dhe për znj. Rrezarta Jashari, konsulente e angazhuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës, e cila ka ofruar mbështetje profesionale të paçmuar përgjatë të gjithë procesit. Ky projekt është realizuar me mbështetjen e qeverisë gjermane dhe është implementuar nga GIZ, NALAS dhe AKK, të cilëve u jemi thellësisht mirënjohës për partneritetin dhe besimin.

Ky plan përveç se dokument zyrtar, është edhe një zotim institucional dhe njerëzor. Është reflektim i vlerave tona si shoqëri që beson në dinjitetin, barazinë dhe mundësinë për çdo fëmijë që të jetojë dhe zhvillohet pa pengesa.

Me respekt,

Ilir Ferati

Kryetar i Komunës së Istogut

Përmbajtja

Fjala hyrëse e Kryetarit të Komunës	2
Shkurtesat	3
Profili i Komunës së Istogut	5
Organigrami i komunës së Istogut	9
Metodologjia dhe procesi i përpilimit të planit.....	18
II. Qëllimi i Planit Strategjik.....	22
III. Hartëzimi social dhe SWOT analiza.....	24
IV. Vizioni dhe Misioni i Komunës së Istogut për përfshirjen sociale të famijëve më aftësi të kufizuara	27
V. Qëllimi dhe Objektivat e Përfshirjes Sociale Strategjike të komunës së Istogut	28
VI. Deklaratë mbi Prioritetet e Përfshirjes Sociale	30
VII. Plani i Veprimit	32
VIII. Treguesit e Performancës (Indikatorët)	45
IX. Mekanizmat e Monitorimit dhe Vlerësimit	46
Kornizë për monitorimin e procesit të zbatimit të planit	46
X. Përfundim	47

Shkurtesat

DBF -Drejtoria për Buxhet dhe Financa

DKA -Drejtoria Komunale e Arsimit

DMS -Drejtoria e Mirëqenies Sociale

DSH -Drejtoria e Shëndetësisë

GP – Grupi Punues

MAPL-Ministria e Administrimit të Pushteti Lokal

MD -Ministria e Drejtësisë

MFPT -Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve

NJDN -Njësi për të Drejtat e Njeriut

OJQ -Organizatat jo-Qeveritare

OZHQ-Objektivat Zhvillimore të Qëndrueshme

QAP - Qendrat e Aftësimit Profesional.

QD - Qendra Ditore.

ZP - Zyret për Punësim.

Hyrje

Profili i Komunës së Istogut

Komuna e Istogut ndodhet në pjesën veriperëndimore të Republikës së Kosovës me një sipërfaqe prej 453.83 km² dhe renditet si komunë mesatare, e shtatë nga madhësia në Kosovë. Ajo përbëhet nga qyteti i Istogut dhe dy zonat e tij periferike, Gurakoc dhe Banjë, ndërsa ka gjithsej 51 fshatra nën qeverisjen e saj lokale.

Sa i përket popullsisë dhe strukturës etnike, sipas regjistrimit të popullsisë në vitin 2024, Istogu ka 33,008 banorë që tregon një rënie shumë të lehtë të numrit të popullsisë, që nga regjistrimi i mëhershëm, në vitin 2011. (<https://askapi.rks-gov.net/Custom/b45ea5db-09d5-4c97-9258-9d262cd8216f.pdf>).

Struktura etnike e Istogut është sic vijon :

Shqiptarë: 29.892- 92.0.2%

Boshnjakë: 996-2.91%

Romë, Ashkali dhe Egjiptianë të Ballkanit: 1,550-3.48%

Serbë: 563-1.89%

Turq: 3-0.009%

Numri i familjeve, në këtë komunë, sipas statistikave të (2019): 8,315(faqja zyrtare e Komunës së Istogut)

- Përqindja gjinore: Meshkuj: 49.3%, Femra: 50.7%

-Familje në asistencë sociale: 765 familje me 3,437 anëtarë

Komuna e Istogut është kryesisht rurale, me qytetin e Istogut që shërben si qendër administrative dhe ekonomike. Popullsia urbane është e përqendruar kryesisht në qytet, ndërsa pjesa tjetër e popullsisë jeton në 50 fshatra. Kjo ndarje ka ndikim në zhvillimin ekonomik dhe social të rajonit, ku qyteti ofron më shumë mundësi arsimore, shëndetësore dhe kulturore, ndërsa fshatrat mbështeten kryesisht në bujqësi dhe aktivitete tradicionale.

Situata e Personave me Aftësi të Kufizuara në Komunën e Istogut

Sipas të dhënave të fundit nga Agjencia e Statistikave të Kosovës, në komunën e Istogut aktualisht janë 63 familje që kanë fëmijë me nevoja të veçanta të moshës 1–18 vjeç. Numri i përgjithshëm i individëve me nevoja të veçanta që janë përfitues të skemës së pensioneve për aftësi të kufizuara është 375 persona.

Pavarësisht mungesës së politikave të përshtatura specifiku në nivel lokal – përveç atyre të hartuara në nivel qendror dhe të shpërndara nëpër komuna – Komuna e Istogut ka ndërmarrë përpjekje të dukshme për identifikimin dhe mbështetjen e kësaj kategorie të ndjeshme. Në ngjarjet e fundit, Kryetari i Komunës ka dhënë kontribut për Shoqatën e Paraplegjikëve dhe Fëmijëve me Paralizë, për çka është vlerësuar nga OJQ-ja HandiKOS, me seli në Istog. Përveç kësaj, janë organizuar aktivitete specifike për këtë komunitet, siç ishte shënimi i 3 Dhjetorit – Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara.

Procesi i decentralizimit të shërbimeve sociale në Kosovë nisi me qëllim të forcimit të pushtetit lokal dhe përmirësimit të ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Në vitin 2009, në kuadër të reformave institucionale pas shpalljes së pavarësisë, filloi transferimi i përgjegjësiave për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare nga niveli qendror tek komunat. Kjo synonte të rriste efikasitetin, llogaridhënien dhe afërsinë e institucioneve me nevojat reale të qytetarëve në terren.

Përmes këtij procesi, komunat morën përgjegjësinë për menaxhimin e Qendrave për Punë Sociale (QPSH), përfshirë administrimin e stafit, buxhetit dhe planifikimin e shërbimeve sociale në nivel lokal.

Megjithatë, decentralizimi ka sjellë edhe sfida të mëdha. Komunat më të vogla, si Istogu, përballen me vështirësi në sigurimin e kapaciteteve të nevojshme për menaxhimin efektiv të shërbimeve sociale. Mungesa e stafit profesional dhe të trajnuar, buxhetet e kufizuara dhe koordinimi joefikas ndërmjet dikastereve komunale dhe akterëve të tjerë, përfshirë edhe bashkëpunimin me nivelin qendror, kanë ndikuar negativisht në cilësinë dhe qasjen në këto shërbime – veçanërisht për grupet më të cënueshme.

Megjithë sfidat e hasura, procesi i decentralizimit përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi më të qëndrueshëm dhe të decentralizuar të mirëqenies sociale në Kosovë. Potenciali për përmirësim mbetet i madh, veçanërisht përmes mbështetjes institucionale, përkrahjes së donatorëve, të hyrave vetanake të komunave dhe trajnimeve të vazhdueshme për punonjësit socialë dhe profesionistët në nivel lokal.

Duke u nisur nga fakti se qasja dhe pjesëmarrja në një sistem të përshtatshëm të mbrojtjes sociale përbën një të drejtë themelore të njeriut, kjo është me rëndësi të veçantë si në legjislacionin kombëtar, ashtu edhe në atë lokal. Shërbimet sociale dhe të integruara të bazuara në komunitet synojnë të ofrojnë një qasje gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrëse, duke u fokusuar në përmbushjen e nevojave të individëve dhe grupeve përmes krijimit të shërbimeve të përshtatura dhe të koordinuara, me qëllim përmirësimin e mirëqenies dhe rritjen e pavarësisë së tyre.

Ky proces kërkon koordinim dhe bashkëpunim të strukturuar midis të gjitha palëve të interesuara në nivel qendror dhe lokal, përfshirë sektorët social, shëndetësor, të punësimit,

strehimit dhe arsimit. Këto shërbime përbëjnë themelin e sistemit të mbrojtjes sociale dhe forcimit të mirëqenies në nivel lokal dhe kombëtar, duke pasur për qëllim parandalimin e problemeve dhe privimeve sociale në të gjitha nivelet.

Në komunën e Istogut, fëmijët me aftësi të kufizuara nga zona urbane, rurale dhe grupet më të cënueshme përballen me forma të shumta diskriminimi në komunitetet e tyre, për shkak të mungesës së qasjes, pjesëmarrjes dhe përfitimit nga shërbimet bazë të integruara dhe të drejtat themelore të garantuara. Kjo situatë vjen si rezultat i një sërë faktorësh, ndër të cilët përfshihen:

- Mungesa e ndërgjegjësimit dhe e njohurive rreth të drejtave të tyre njerëzore, sociale, arsimore, shëndetësore dhe të punësimit;
- Mungesa e infrastrukturës së qasshme dhe të përshtatur, si dhe e pajisjeve ndihmëse;
- Mungesa e shërbimeve mbështetëse gjatë arsimit parashkollor, fillor dhe të lartë, përfshirë asistencën personale dhe arsimore;
- Mungesa e mbështetjes pas mësimi dhe e shërbimeve ditore për zhvillimin e aftësive sociale dhe të jetës së pavarur;
- Mungesa e aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit për pjesëmarrje të rregullt në sistemin arsimor;
- Mungesa e sigurimit shëndetësor dhe e qasjes në kujdesin shëndetësor themelor;
- Mungesa e mbështetjes për përfshirjen në aktivitete kulturore dhe sportive;
- Mungesa e mbështetjes psikosociale për prindërit, kujdestarët dhe përfaqësuesit ligjorë të tyre;
- Mungesa e masave që nxisin pjesëmarrjen e prindërve në tregun e punës.

Për të adresuar këto sfida, nevojitet krijimi i një game të gjerë të shërbimeve të bazuara në komunitet, përfshirë:

a) Shërbimet sociale:

- Qendrat e kujdesit ditor;
- Qendrat për rehabilitim dhe riintegrim;

- Kujdesi i përkohshëm për prindërit dhe kujdestarët;
- Kujdesi në shtëpi (asistencë personale, përkujdesje në shtëpi);
- Asistentët arsimorë;
- Jetesa e mbështetur me shërbime sociale;
- Shërbimet terapeutike dhe të këshillimit;
- Mbështetja psikosociale;
- Shërbimet e punës mobile dhe në terren.

b) Përfitimet në para, të parashikuara me legjislacionin në fuqi, si:

- Ligji për Mbrojtje Sociale;
- Ligji për Arsim;
- Ligji për Punësim;
- Ligji për Pensione dhe Sigurime;
- Ligji për Familjen, etj.

Një ndër pengesat më të mëdha në këtë drejtim është mungesa e dokumenteve strategjike dhe e politikave konkrete në nivel lokal. Kjo përfshin mungesën e:

- Ofruesve të shërbimeve esenciale;
- Koordinimit ndërmjet akterëve kryesorë;
- Regjistrit të personave me aftësi të kufizuara (aktualisht, mbi 70% janë djem dhe më pak se 30% janë vajza);

Një metodologji kombëtare për vlerësimin e nevojave të personave me aftësi të kufizuara, e cila do të mundësonte përcaktimin e qartë të të drejtave dhe shërbimeve përkatëse për ruajtjen apo përmirësimin e funksionalitetit të tyre. kryesore në nivel lokal për krijimin e politikave, programeve, masave dhe shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, mbledhjen dhe agregimin e të dhënave, zhvillimin e regjistrit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, ofruesit e shërbimeve të licencimit etj. Dhe në fund, rritjen e ndërgjegjësimit dhe integrimin e parimeve të aftësisë së kufizuar dhe dizajnit universal në të gjitha shërbimet, ambientet, ndërtesat dhe strukturat mjedisore në nivel lokal, me qëllim krijimin e një mjedisi

të arritshëm dhe mbështetës për personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara.


Ky Plan strategjik është ndërtuar mbi vizionin e transformimit të mbrojtjes sociale dhe me qëllim për përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Istog 2025-2027, si dhe synon të forcojë sistemin e mbrojtjes sociale të kujdesit social dhe shërbimeve të integruara të bazuara në komunitet dhe të adresojë jo vetëm ofrimin e shërbimeve sociale, por edhe aktiviteteve dhe masave, edhe mbështetjen kuptimplote për a) qasjen, pjesëmarrjen dhe integrimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara në shoqëri, sistemin arsimor (arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm), sistemin e mbrojtjes sociale, strehimin e denjë, kujdesin shëndetësor parësor dhe të ushqyerit, aktivitetet sportive dhe rekreative dhe b) ofrimin e stimuljeve, masave dhe shërbimeve shtesë mbështetëse për prindërit e tyre në mënyrë që të marrin pjesë në tregun e punës.

Organogrami i Komunës së Istogut

Organizimi institucional i Komunës së Istogut është i ndërtuar sipas strukturës standarde të pushtetit lokal në Kosovë, në përputhje me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale. Në krye të saj qëndron Kryetari i Komunës, i cili zgjidhet drejtpërdrejt nga qytetarët dhe është përgjegjës për ekzekutimin e politikave komunale dhe menaxhimin e administratës komunale. Kuvendi Komunal është organi më i lartë përfaqësues dhe vendimmarrës, i përbërë nga asamblistë të zgjedhur, që miratojnë buxhetin, rregulloret dhe vendimet strategjike për komunën. Brenda administratës komunale funksionojnë drejtori të ndryshme si ajo për arsim, shëndetësi, bujqësi, urbanizëm, mirëqenie sociale dhe financa, të cilat mbulojnë fushat përkatëse të zhvillimit dhe shërbimeve për qytetarët.

Përveç strukturave institucionale, Komuna e Istogut ka në funksion disa ndërmarrje publike lokale që ofrojnë shërbime esenciale për banorët. Ndër më të rëndësishmet janë: Ndërmarrja Publike “Radoniqi-Dukagjini”, që merret me furnizimin me ujë të pijshëm, ndërmarrja për pastrimin dhe menaxhimin e mbeturinave, si dhe ndërmarrjet që kujdesen për mirëmbajtjen e rrugëve dhe ndriçimin publik. Këto ndërmarrje operojnë në mbikëqyrjen e komunës dhe kanë rol kyç në ofrimin e shërbimeve të përditshme dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës në komunë. Përmes bashkëpunimit ndërmjet institucioneve komunale dhe ndërmarrjeve publike, Komuna e Istogut synon të realizojë zhvillim të qëndrueshëm dhe shërbime më efikase për qytetarët e saj

Shtojca Nr.2 - Organogrami i Administratës Komunale



Mirëqenia Sociale në Komunën e Istogut

Siç është theksuar edhe më herët, pas procesit të decentralizimit dhe ri-strukturimit të shërbimeve sociale, niveli komunal — përfshirë edhe Komunën e Istogut — ka themeluar drejtoritë përkatëse për ofrimin e shërbimeve sociale në nivel lokal.

Në Istog, ashtu si në shumicën e komunave në Kosovë, për shkak të nivelit të lartë të papunësisë dhe pasojave të luftës së fundit — të cilat ende nuk janë tejkaluar plotësisht — ekziston një numër i konsiderueshëm i rasteve sociale dhe familjeve në nevojë për shërbime të ndryshme sociale dhe mbështetëse.

Sipas statistikave të vitit 2024, në komunën e Istogut janë 365 familje me gjithsej 3,020 anëtarë të përfshirë në skemën e ndihmës sociale. Kërkesat për përfshirje në këtë skemë janë të vazhdueshme dhe Qendra për Punë Sociale (QPS) në Istog pranon mesatarisht 10 deri në 15 kërkesa të reja në vit. Aktualisht, 12 familje janë të vendosura në strehimore kolektive, ndërsa rreth 25 kërkesa për strehim social janë paraqitur nga individë dhe familje në nevojë.

QPS-ja përfaqëson institucionin kryesor të mbrojtjes sociale në komunë dhe është e organizuar në dy divizione: Divizioni i Ndihmës Sociale dhe Divizioni i Punës Sociale. Për shembull, asistencë mujore për një fëmijë me aftësi të kufizuara është 120 euro.

Megjithatë, QPS-ja aktualisht nuk posedon një sistem të veçantë për identifikimin proaktiv të fëmijëve me aftësi të kufizuara në zonat rurale. Informacionet rreth këtyre rasteve mblidhen kryesisht nga raportimet e vetë familjarëve, OJQ-të që veprojnë në fushën sociale apo përmes bashkëpunimit me institucione të tjera komunale, si shkollat, qendrat sportive dhe kulturore.

Në të gjithë vendin, përfshirë edhe Istogun, ofrohet një numër i kufizuar shërbimesh sociale, pavarësisht se në listën e shërbimeve të QPS përfshihen rreth 70 lloje të ndryshme të shërbimeve sociale dhe të ndihmës psikosociale dhe këshillimore. Njësia për Asistencë Sociale, ndër të paktat që funksionon në mënyrë të rregullt, merret me përpilimin e listave përfituesve dhe shpërndarjen e ndihmës financiare në para, në përputhje me buxhetin e ndarë nga niveli qendror.

Pjesa më e madhe e shërbimeve të tjera sociale nuk ofrohet, kryesisht për shkak të mungesës së kërkesave të qarta dhe mungesës së kapaciteteve profesionale dhe buxhetore. Megjithatë, Qendra për Punë Sociale (QPS) ka në dispozicion një fond emergjent të vogël nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, i cili u mundëson profesionistëve të shërbimeve sociale të ndërhyjnë me ndihmë të menjëhershme në raste urgjente.

Një zhvillim i rëndësishëm dhe pozitiv në drejtim të përmirësimit të përfshirjes sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara është arritur gjatë vitit 2025 nga Ministria e Transfereve dhe Financave, në bashkëpunim me GIZ, NALAS dhe Asociacionin e Komunave të Kosovës (AKK). Si rezultat i këtij bashkëpunimi, është nisur ofrimi i shërbimeve logopedike, psikologjike dhe sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara, shërbime të cilat janë të përshtatura sipas nevojave të tyre. Po ashtu, është ofruar mbështetje për shërbimet ditore të siguruara nga

organizata e specializuar HANDIKOS, e cila ofron përkujdesje dhe shërbime profesionale për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike. Vlen të theksohet se që nga muaji mars, kjo klasë ditore ka kaluar në kompetencat e Drejtorisë së Mirëqenies Sociale në Istog, ndërsa stafi i kësaj klase është kontraktuar nga komuna jonë, duke siguruar kështu një menaxhim më të mirë dhe një mbështetje më të qëndrueshme për këta fëmijë dhe familjet e tyre. Vlen të theksohet se Drejtoria e Mirëqenies Sociale është një hap para në koordinimin me Ministrinë e Transfereve dhe Financave për realizimin e hapjes së një Qendre Ditore në Komunën e Istogut në fshatin Gurrakoc, me qëllim që ka numër më të lartë të interesimit për shumë fëmijë dhe familje që të përfitojnë shërbime përkatëse për fëmijë me nevoja të veçanta, pasi që vetëm me klasën ditore nuk mund ti përfshijmë të gjitha familjet për shkak të hapësirës së kufizuar të ambientit.

Shëndetësia në Komunën e Istogut

Në Komunën e Istogut ofrohen shërbime shëndetësore të nivelit parësor dhe dytësor. Kujdesi shëndetësor parësor ofrohet për banorët e komunës përmes pesë (5) Qendrave të Mjekësisë Familjare (QMF) dhe dhjetë (10) ambulancave mjekësore (klinika të vogla) të vendosura në zonat rurale. Ndërkohë, për nevojat e shërbimeve dytësore, banorët i drejtohen Spitalit Rajonal të Pejës apo klinikave private.

Qendrat e Mjekësisë Familjare janë të vendosura në:

- Qytetin e Istogut,
- Fshatrat Vrellë, Banjë, Gurrakoc dhe Rakosh.

Ndërsa ambulancat (klinikat e vogla) funksionojnë në fshatrat:

Kaliqan, Sudenicë, Dobrushë, Saradran, Zallq, Dubravë, Cerkolez, Shushicë, Veriq dhe Osojan.

Në QMF ofrohen shërbime të ndryshme, përfshirë:

- Shërbimet emergjente,
- Mjekësinë familjare,
- Mjekësinë interne,
- Imunizimin,
- Kujdesin për nënën dhe fëmijën (maternitetin dhe pediatriinë),
- Shërbimet stomatologjike,
- Rëntgenin,

- Shërbimet laboratorike.

Në klinikat fshatare ofrohen kryesisht shërbime të mjekësisë familjare.

Stafi Shëndetësor

Në sektorin shëndetësor të komunës janë të punësuar gjithsej **123 punonjës**, të ndarë sipas profilit profesional si më poshtë:

- Mjekë: 26
- Teknikë mjekësorë (infermierë, laborantë, teknikë rëntgeni, etj.): 63
- Staf administrativ: 8
- Staf mbështetës teknik: 26

Nga numri i përgjithshëm, 88 janë gra dhe 35 burra.

Struktura shtesë shëndetësore

Në fshatin Osojan funksionon një strukturë shëndetësore e ndarë, e cila menaxhohet nga autoritetet shëndetësore serbe. Kjo njësi përbëhet nga shtatë (7) ambiente zyrash dhe ofron shërbime për komunitetin lokal serb.

Qasja në Shërbime Shëndetësore

Sipas të dhënave të Departamentit Komunal për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, të gjitha komunitetet në Komunën e Istogut kanë qasje në kujdes shëndetësor përmes rrjetit ekzistues të objekteve dhe shërbimeve publike shëndetësore.

Arsimi në Komunën e Istogut

Drejtorja për Arsim dhe Kulturë në Komunën e Istogut është përgjegjëse për zbatimin e politikave arsimore dhe kulturore në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës, përfshirë Ligjin për Arsimin në Komunitet të Kosovës, rregulloret komunale dhe statutin e komunës. Kjo drejtori menaxhon dhe mbikëqyr institucionet arsimore në të gjitha nivelet, si dhe organizon aktivitete kulturore, rinore dhe sportive.

Struktura arsimore

Deri në vitin shkollor 2024–2025, arsimi në Komunën e Istogut përfshin:

- Niveli parashkollor: 235 fëmijë në 15 grupe.
- Arsimi special: 18 fëmijë në 2 klasa.
- Arsimi i detyrueshëm (klasa 1–9): 7,251 nxënës në 308 klasa.
- Arsimi i mesëm i lartë: 2,237 nxënës në 70 klasa.

- Klasa speciale: 20 nxënës të tjerë në kuadër të arsimit të rregullt.

Numri i përgjithshëm i nxënësve është 9,772.

Stafi arsimor

Në institucionet arsimore janë të punësuar gjithsej **654 punonjës**, të ndarë si më poshtë:

- Mësimdhënës: 518
- Staf administrativ: 31
- Personel teknik dhe ndihmës: 105

Institucionet arsimore

Komuna e Istogut përfshin:

- 5 çerdhe publike
- 11 shkolla fillore
- 15 klasa periferike për arsimin fillor
- 2 shkolla të mesme
- 1 klasë periferike të shkollës së mesme profesionale “Rudina” në Banjë të Dubravës

Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara

Në komunën e Istogut funksionojnë dy institucione arsimore që ofrojnë departamente të veçanta për fëmijë me aftësi të kufizuara:

- Shkolla fillore “Bajram Curri”
- Gjimnazi “Haxhi Zeka”

Të dyja objektet shkollore ofrojnë qasje të përshtatshme fizike për fëmijët me aftësi të kufizuara, përmes shtigjeve dhe infrastrukturës mbështetëse të integruar.

Megjithatë, aktualisht nuk ka asistentë arsimorë në klasat e nivelit fillor apo të mesëm. Një pjesë e mbështetjes ofrohet nëpërmjet:

- Qendrës ditore së hapur rishtas për fëmijë me aftësi të kufizuara në zhvillim.
- OJQ-së HANDIKOS, e cila subvencionohet nga komuna dhe ofron shërbime terapeutike fizike për fëmijët me aftësi të kufizuara fizike.

Departamenti për Kulturë, Rini dhe Sport

Në kuadër të Drejtorisë së Arsimit funksionon edhe **Departamenti për Kulturë, Rini dhe Sport**, i cili organizon aktivitete kulturore, artistike, sportive dhe rinore. Istogu disponon:

- 1 Shtëpi të Kulturës

- 1 Qendër Kulturore
- 3 Biblioteka publike
- 5 Klube sportive
- 2 Qendra rinore
- 2 objekte për aktivitete rinore në zona të përbashkëta
- 1 objekt sportiv të përbashkët.

Klasë	Meshkuj							Femra						Gjithsej Meshkuj	Gjithsej Femra	Gjithsej
	Dëmtime intelektuale	Dëmtime në të parë	Dëmtime të shumëfishta	Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës	Autizëm	Çrregullime emocionale dhe të sjelljes	Sindromi Daun	Dëmtime intelektuale	Dëmtime në të dëgjuar	Dëmtime në të parë	Dëmtime fizike	Dëmtime të shumëfishta	Vështirësi në të folur, komunikim dhe të gjuhës			
Grupa 1-2	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Grupa 2-3	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Grupa 3-4	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Grupa 4-5	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1
Grupa 5-6 - Parafillor	0	0	1	2	0	0	1	0	1	1	0	0	1	4	3	7
Grupa 5-6 - Parashkollor(Çerdhe)	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Klasa 1	0	2	0	6	0	1	0	1	0	0	0	0	0	9	1	10
Klasa 2	0	2	3	2	0	1	1	0	0	5	0	0	1	9	6	15
Klasa 3	1	1	2	0	0	1	0	1	1	1	0	0	0	5	3	8
Klasa 4	2	0	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2	3	2	5
Klasa 5	0	1	0	1	1	0	0	0	0	1	0	0	0	3	1	4
Klasa 6	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	1	1
Klasa 7	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

Klasa 8	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	1	0	0	2	2
Klasa 9	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Klasa 10	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1	1
Klasa 11	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1	0	0	0	1	1
Klasa 12	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Gjithsej	4	6	7	11	1	3	2	2	2	2	8	2	2	5	34	55

Metodologjia dhe procesi i përpilimit të planit

Procesi i inicimit dhe planifikimit të dokumentit filloi në qershor të vitit 2024, kur u mbledhën rezultatet dhe të dhënat e para nga Raporti i Hartëzimit Social. Procesi i përpilimit të këtij plani është përshkruar nga disa hapa të rëndësishëm, që nga faza përgatitore, marrja dhe grumbullimi i të dhënave deri tek drafti final i këtij plan, siç janë më poshtë dhe janë përcaktuar sipas Udhëzuesit për Zhvillimin e Dokumenteve Strategjike Lokale për përfshirje sociale, i mbështetur nga GIZ, NALAS dhe AKK.

Disa nga të gjeturat dhe rekomandimet thelbësore të hartëzimit social, për fëmijët me aftësi të kufizuara në komunën e Istogut:

Statusi socio-ekonomik: Shumica e prindërve mendojnë se ndihma prej 120 eurosh në muaj nuk mjafton për të përmbushur nevojat bazë, si medikamentet apo mjetet e higjienës për foshnjat. Papunësia paraqet një problem të madh, për shkak të kujdesit të vazhdueshëm që kërkojnë fëmijët, dhe shumë prindër janë të detyruar të mbështeten te ndihma e familjarëve.

Gjeografia dhe shërbimet: Familjet jetojnë në zona rurale, larg qendrave të shërbimeve. Mungesa e transportit të organizuar e vështirëson qasjen në shërbimet shëndetësore dhe arsimore. Prindërit shpesh detyrohen të udhëtojnë në Prishtinë për ekzaminime të specializuara. Lista e barnave esenciale nuk përfshin shumicën e medikamenteve të nevojshme, ndërsa stafi mjekësor ka nevojë për trajnim shtesë.

Arsimi: Shumica e fëmijëve nuk janë të regjistruar në shkolla, ose i ndërpresin studimet pas moshës 16 vjeç. Klasat e integruara pritet të mbyllen dhe të bashkohen me klasat e zakonshme, pa ofruar mbështetjen e nevojshme për fëmijët me nevoja të veçanta. Ka nevojë të menjëhershme për asistentë edukativë personalë, veçanërisht për vajzat, të cilat janë edhe më të marginalizuara në këtë kontekst.

Qeverisja: Prindërit kanë mungesë besimi ndaj institucioneve dhe nuk marrin pjesë në politikëbërje. Janë të painformuar për ndryshimet në politika. Duhet përmirësim i komunikimit dhe promovim i zyrave si “Zyra e Ankesave”.

Diskriminimi: Ekzistojnë gjetje kontradiktore. Disa prindër raportojnë diskriminim, ndërsa të tjerë jo. Raporti thekson mungesën e një përkufizimi të qartë për “diskriminim”, dhe nevojën për trajnime sensibilizuese për stafin publik.

Cënueshmëria ndaj emergjencave: Familjet nuk ndihen të kërcënuara në mënyrë të drejtpërdrejtë, por mungon një plan për mbrojtje në raste katastrofash. Kërkohej një politikë e re që përfshin Procedura Standarde Operative për emergjencë.

Rekomandimet

Raporti paraqet një sërë rekomandimesh për përmirësimin e kushteve të jetesës për fëmijët me aftësi të kufizuara në Komunën e Istogut. Këto rekomandime përfshijnë: rritjen e ndërgjegjësimin për shërbimet ekzistuese; ofrimin e mbështetjes më të madhe ekonomike për familjet, veçanërisht për nënat; trajnimin dhe punësimin e prindërve; përmirësimin e qasjes në arsim dhe shëndetësi; si dhe krijimin e një Qendre Ditore të pajisur me shërbime të specializuara. Gjithashtu, theksohet nevoja për transport falas, mbrojtje më të mirë sociale, luftimin e diskriminimit dhe sigurimin e kushteve të barabarta për të gjithë fëmijët, përfshirë ata që jetojnë në zona rurale.

Në përgjithësi, raporti vë në dukje mungesën e mbështetjes së strukturuar dhe nevojën për politika më gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara në Istog.

Mund të konkludojmë se në përgjithësi, raporti thekson mungesën e mbështetjes së strukturuar dhe nevojën për politika më gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara në Istog.

Duke u bazuar në informatat si më lartë, procesi i vijuar për pëpilimin e Planit Strategjik ishte siç vijon:

Hapi i parë - Inicimi dhe planifikimi i zhvillimit të dokumentit strategjik lokal për përfshirje sociale, propozimi për këtë plan është dhënë nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale në Istog, dhe është përkrahur dhe mbështetur nga Kryetari i Komunës dhe Kuvendi Komunal i Istogut.

Hapi i dytë- Krijimi i strukturës institucionale, Grupit Punues – ky grup punues është themeluar nga DMS dhe në përbërje të veten ka: DMS, DKA, DSH, Zyrja për buxhet dhe financa, Njësia për të drejtat e njeriut, OJQ lokale, Zyrja për komunitete dhe Kthim, Drejtoria e Urbanizmit, Drejtorati për Rini, Sport dhe Kulturë. Roli dhe përgjegjësia e këtij GP është përgatitja e informatave, draftimi i planit dhe zbatimi si dhe mbikëqyrja, monitorimi dhe raportimi për këtë plan.

Hapi i tretë- Hartimi i dokumentit strategjik lokal për përfshirjen sociale-Plani Strategjik për përfshirje sociale në komunën e Istogut është shkruar duke u bazuar në të dhënat nga hartimi social, të dhënat relevante nga QPS, DKA, OJQ lokale, për fëmijët me aftësi të kufizuara (fizike dhe mendore; duke u bazuar në parimet bazë të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e

Fëmijëve¹; Konventa për të drejtat e Personave me aftësi të kufizuara² dhe ligjet e Kosovës, siç janë: Ligji për Mbrojtjen e Fëmijëve në Kosovë ³ dhe Ligji për Shërbime Sociale dhe Familjare ⁴ dhe ⁵ Manuali i Zyrës së Kryeministrit për hartimin dhe monitorimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të tyre të veprimit. Gjatë përpilimit të këtij plani strategjik është marrë parasysh aspekti i përfshirjes të fëmijëve me aftësi të kufizuara duke pasur qasje në të gjitha shërbimet sociale, arsimore, shëndetësore, kulturore dhe sportive e rekreative në komunën e Istogut.

Hapi i katërt- Miratimi i Dokumentit Strategjik-Plani Strategjik është aprovuar dhe përkrahur nga Kryetari i komunës së Istogut, Z.Illir Ferati dhe është miratuar në Gusht 2025, nga Kuvendi komunal i Istogut.

Hapi i pestë-Monitorimi dhe Raportimi-Monitorimi dhe raportimi për zbatimin e këtij plani do të bëhet nga GP dhe grupi monitorues i paraparë sipas këtij plani, në përbërje të përfaqësuesve të komunitetit me aftësi të kufizuara, shoqërisë civile dhe përfaqësues të institucioneve lokale.

Hapi i gjashtë- Vlerësimi i këtij plani do të realizohet nga përfaqësues të një kompanie profesionale të specializuar në monitorimin e planeve strategjike, e cila do të angazhohet nga komuna.

Që nga hapi i parë, adresimi i të gjeturave dhe rekomandimeve të dala nga procesi i hartëzimit social është marrë përsipër nga vetë Kryetari i Komunës, i cili përmes udhëheqjes së Drejtorisë së Mirëqenies Sociale (DMS) ka iniciuar dhe udhëhequr procesin e hartimit të Planit Strategjik për përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Istogut.

Ky plan është hartuar me synimin për të përfshirë të gjitha shërbimet e integruara që ndikojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijëve me aftësi të kufizuara, në përputhje me Objektivin 10 të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, i cili synon reduktimin e pabarazive brenda dhe ndërmjet vendeve. Ky objektiv përfshin pabarazitë në të ardhura, si dhe ato të bazuara në moshë, gjini, paaftësi, racë, përkatësi etnike, origjinë, fe apo status ekonomik apo tjetër brenda një vendi.

Grupi Punues (GP) ka vijuar me të gjithë hapat e përcaktuar në Udhëzuesin për hartimin e dokumenteve strategjike, duke u bazuar në një dakordim të përbashkët midis anëtarëve të

¹ konventa e kombeve të bashkuara për të drejtat e fëmijëve

² https://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf

³ <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=20844>

⁴ <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85111>

⁵ <https://kryeministri.rks-gov.net/ep-content/uploads/2022/05/MANUAL-PER-PLANIFIKIMIN-HARTIMIN-DHE-MONITORIMIN-E-DOKUMENTEVE-STRATEGJIKE-DHE-PLANEVE-TE-TYRE-TE-VEPRIMIT.pdf>

ekipit. Çdo anëtar ka pasur detyra dhe përgjegjësi specifike për të kontribuar në adresimin e të gjeturave dhe rekomandimeve të dala nga hartëzimi social në këtë plan.

Grupi ka qenë aktiv dhe i angazhuar gjatë gjithë periudhës janar–qershor 2025, duke filluar që nga iniciimi e deri në përfundimin e procesit të hartimit të dokumentit strategjik. Gjatë kësaj periudhe, është arritur konsensus për domosdoshmërinë e hartimit të dokumentit dhe për vendosjen e masave, shërbimeve dhe aktiviteteve që janë thelbësore për përmirësimin e statusit socio-ekonomik dhe mirëqenies së fëmijëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Istogut.

Në bazë të gjetjeve nga hartëzimi social, fëmijët me aftësi të kufizuara – qofshin ato fizike apo mendore – përbëjnë një nga grupet më të cënueshme në Komunën e Istogut. Sipas rekomandimeve të dhëna, prioritetet për përfshirjen e tyre sociale përfshijnë një sërë masash që synojnë përmirësimin e qasjes dhe përfshirjes së tyre në të gjitha aspektet e jetës.

Këto prioritetet janë:

- **Krijimi i infrastrukturës së aksesueshme dhe universale**, përfshirë ndërtimin e një Qendre Ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara të të gjitha kategorive;
- **Ndërtimi dhe përshtatja e objekteve mbështetëse dhe të aksesueshme** në institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme;
- **Zhvillimi i ekipeve gjithëpërfshirëse në shkollë**, që përfshijnë profesionistë të specializuar për punë me fëmijët me nevoja të veçanta;
- **Sigurimi i asistentëve edukativë** për fëmijët me aftësi të kufizuara të integruar në shkollat e rregullta;
- **Furnizimi me pajisje ndihmëse dhe modele profesionale të trajnuara** për përkrahje në procesin mësimor;
- **Vlerësimi profesional i fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe licencimi i ofruesve të shërbimeve**;
- **Ofrimi i shërbimeve rehabilituese dhe riintegrimi**, si dhe mbështetje psikosociale për prindërit, kujdestarët dhe përfaqësuesit ligjorë;
- **Zhvillimi i shërbimeve të bazuara në komunitet**, si: jetesa me mbështetje, kujdesi dhe shërbimet sociale në shtëpi, asistencë sociale;
- **Rehabilitimi profesional dhe punësimi i mbështetur** për prindërit dhe kujdestarët;
- **Ofrimi i shërbimeve të ekipeve mobile dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor**;
- **Mbështetja për bashkëjetesë dhe inkurajimi për pjesëmarrje aktive në aktivitete kulturore, sportive dhe rekreative** për fëmijët me aftësi të kufizuara.

Procesi i hartimit ka vazhduar me mbajtjen e takimeve, janë mbajtur së paku 4 takime të këtij grupi dhe ekspertës së angazhuar nga AKK, përmes të cilave janë dakorduar për :

- 1. Qëllimin dhe Përmbajtjen e këtij dokumenti;*
- 2. Vizioni dhe Misioni i komunës së Istogut për adresimin e çështjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara*
- 3. Qëllimi dhe 3 objektivat strategjike dhe specifike për këtë plan strategjik, të cilat do të jenë baza e përpilimit të këtij plani 3 vjeçar;*
- 4. Aktivitetet specifike, institucionet përgjegjëse dhe bashkëpunuese, buxheti, treguesit apo indikatorët dhe buxheti si dhe plani i monitorimit të këtij plani.*

Bazuar në këto prioritete, ekipi hartues ka punuar në përcaktimin e vizionit dhe misionit të komunës së Istogut për përmirësimin e përfshirjes sociale dhe statusit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, për 3 vjetet në vijim.

Objekti kryesor është përmirësimi i mirëqenies së përgjithshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara duke krijuar masa për përmirësimin e infrastrukturës dhe burimeve për pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre, kujdestarëve dhe përfaqësuesve ligjorë në aktivitete arsimore, sociale, shëndetësore, punësimi, banimi, politike, kulturore dhe sportive në baza të barabarta si qytetarët e tjerë në Istog.

Përmes qasjes pjesëmarrëse u përcaktuan objektivat të cilat janë të ndara në baza sektoriale dhe në bazë të tyre janë përcaktuar synimet dhe rezultatet që Komuna e Istogut dëshiron t'i arrijë në 3 vitet e ardhshme (2025-2027), përmes këtij **Plani Strategjik për gjithë përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në komunën e Istogut**, i cili u konsultua dhe u përcaktua bashkërisht me GP dhe akterët e tjerë relevant. Plani përfshinë objektiva dhe aktivitete për përfshirje sociale relevante për përmirësimin e mirëqenies së përgjithshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha aspektet e jetës dhe mundëson pjesëmarrjen aktive të tyre në komunitet (programi arsimor, programi social, programi i kujdesit shëndetësor dhe programi sportiv-rekreativ etj.) dhe në bazë të këtyre objektivave u përcaktua edhe plani buxhetor dhe plani i Veprimit interesit dhe gjithashtu u përcaktuan praktikatat e monitorimit dhe vlerësimit. Në fund ky Plani Strategjik për përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në komunën e Istogut, iu prezantua dhe dorëzua për miratim kryetarit të komunës, për të u dërguar për votim dhe aprovim final në Kuvendin Komunal të Istogut.

II. Qëllimi i Planit Strategjik

Ky plan strategjik synon të shërbejë si bazë për zbatimin e politikave vendore, në nivel lokal, për përfshirjen sociale, i cili përfaqëson prioritetet e mbrojtjes sociale dhe përfshirjes sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre, kujdestarët dhe përfaqësuesit ligjorë dhe listën e veprimeve për zgjidhjen e tyre. Përgatitja e këtij lloji të dokumentit strategjik

promovon zhvillimin e aftësive të profesionistëve në Komunën e Istogut dhe subjekteve të tjera relevante të nivelit lokal të interesuar për mbrojtjen sociale, përfshirjen sociale dhe zhvillimin e komunitetit. Për më tepër, ato promovojnë gjithashtu bashkëpunimin ndërmjet sektorit të shoqërisë civile, publikut, qeverisjes vendore dhe qeverisë qendrore, ofruesve të shërbimeve sociale, biznesit dhe aktorëve të tjerë vendorë (arsim, punësim, kujdes shëndetësor, strehim), duke mbështetur shkëmbimin e lirë të informacionit dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimarrje.

Gjithnjë duke u bazuar në hartëzimin social të vitit 2024 dhe statistikave të fundit të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, në Komunën e Istogut janë 63 familje me fëmijë me nevoja të veçanta të grupmoshës 1-18 vjeç. Numri i plotë i individëve me nevoja të veçanta që janë pjesë e skemës sociale për aftësi të kufizuara është 375 njerëz, sipas llogaritjeve të fundit.

Ky dokument synon të ofrojë një kornizë të qartë 3 vjeçare (2025-2027) për ndërmarrjen e masave konkrete që mundësojnë përfshirjen sociale të grupeve të marginalizuara, fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, në ndërtimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe më të drejtë.

Qëllim kryesor i këtij plani strategjik, i përcjellur nga plani konkret i veprimit është që, duke u bazuar në vizionin dhe misionin e komunës së Istogut për trajtimin e çështjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, të përcaktohen Qëllimet, Objektivat strategjike dhe specifike, në bazë të të cilave me aktivitete konkrete, buxhet dhe koordinim në mes të partnerëve institucional dhe atyre nga rradhët e OJQ-ve të planifikohen shërbimet, ofertat e ndryshme dhe asistencë të ndryshme për fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, që do të kontribuojnë në përmbushjen e të drejtave të tyre për të marrë shërbime dhe për të u realizuar dhe gjithëpërfshier në rrethin dhe shoqërinë ku ata jetojnë. Përmes këtij plani akterët lokal në Istog do të mund të planifikojnë, për së paku 3 vjetët e ardhshme: shërbimet e nevojshme, stafin teknik dhe profesional që janë të nevojshëm, buxhetin dhe hapësirat institucionale, si dhe të organizojnë mekanizmat bashkëpunues dhe koordinues në nivel lokal, me OJQ-të lokale dhe institucionet apo organizatat edhe në nivel kombëtarë.

Ky plan synon një planifikim afat mesëm dhe të strukturuar që parasheh shërbimet profesionale, buxhetin, stafin profesional dhe teknik, mjetet, ndërtesat/objektet dhe të gjitha kushtet dhe mundësitë e tjera që do të mundësojnë përmbushjen e të drejtave të fëmijëve me AK dhe familjeve të tyre për të marrë shërbimet, për të marrë pjesë në proceset vendimarrëse dhe për të kontribuar e për të qenë anëtarë aktiv të komunitetit ku ata jetojnë dhe veprojnë, sipas principit të Objektive Zhvillimore të Qëndrueshme/OZHQ.

III. Hartëzimi Social dhe SWOT analiza

Siç edhe e dimë, një prej premtimeve thelbësore të Agjendës për Zhvillim të Qëndrueshëm të 2030 është të Mos Lënit Askënd Pas (MLAP/LNOB). Në kuadër të kësaj agjende, Kombet e Bashkuara synojnë të japin fund varfërisë dhe të luftojnë diskriminimin dhe pabarazinë. Siç është identifikuar nga Kombet e Bashkuara, njerëzit e lënë pas janë të diskriminuar në aspektin ekonomik, politik dhe nga ambienti. Ky diskriminim është rezultat i faktorëve të ndryshëm të pakontrollueshëm siç janë gjinia, aftësitë e kufizuara, raca apo kombinim i këtyre faktorëve. Për më tepër, njerëzit që u përkasin këtyre grupeve të cenuara nuk u besojnë institucioneve publike si rezultat i mungesës së informacioneve rreth qasjes në shërbime publike. Prandaj, kjo mund të shihet si një cikël i pashmangshëm.

Hartëzimi social është një mjet i zhvilluar nga GIZ për të funksionalizuar kornizën e Mos Lënit Askënd Pas. Ky mjet zakonisht përdoret për identifikimin e personave brenda grupeve të pafavorizuara të cilët rrezikohen nga të lënë pas. Analiza realizohet në linjë me pesë (5) faktorët e rrezikut të kornizës MLAP/LNOB që shërbejnë për vlerësimin e shkaqeve rrënjësore të pabarazisë dhe diskriminimit si dhe format e manifestimit të këtyre shkaqeve. Korniza MLAP/LNOB përfshin këta faktorë rreziku: situatën socio-ekonomike, gjeografinë, qeverisjen, diskriminimin dhe cenueshmërinë ndaj goditjeve. Ky mjet praktik u përdor edhe në Komunën e Istogut me mbështetjet e Asociacionin e Komunave të Kosovës brenda kornizës së projektit “Bashkëpunimi Rajonal për Gjithëpërfshirje më të Mirë Sociale në Nivelin Lokal/Regional Cooperation for Better Social Inclusion at Local Level” realizuar nga AKK, NALAS në bashkëpunim me GIZ dhe financuar nga Qeveria Gjermane. Sipas identifikimit të Komunës së Istogut, fëmijët me aftësi të kufizuara janë mes grupeve më të cenuara në Istog.

Kishte disa faktorë që ndikuan në vendimin komunal për të drejtuar hartëzimin social tek fëmijët me aftësi të kufizuara. Fillimisht, komuna nuk ofronte shërbime të kujdesit (qëndrimin) ditor për fëmijët me aftësi të kufizuara, gjë që rezultonte në izolimin dhe lënien e këtyre familjeve dhe fëmijëve pa mbështetjen e nevojshme, veçanërisht gjatë zhvillimit të hershëm të fëmijëve. Shërbimet e qëndrimit ditor janë thelbësore për përgatitjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin e integritit në shkollë, zhvillimi i aftësive dhe lehtësimi nga përgjegjësitë e përkujdesjes ndaj prindërve. Komuna e Istogut ka vendosur të fokusohet në këtë grup të synuar ngase fëmijët me aftësi të kufizuara janë një prej kategorive më të cenuara që trajtohen nga QPS. Përveç kësaj, Komuna e Istogut ka për qëllim vendosjen dhe funksionalizimin e një Qendre për Qëndrim Ditor (QQD) që do të pajisej specifikisht për të plotësuar nevojat e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Prandaj, procesi i hartëzimit social shërbeu si bazë për dizajnimin e shërbimeve të personalizuara krahas matësve të politikave dhe adresimit të sfidave të identikuara në projektimin afat-gjatë.

Personat dhe fëmijët me aftësi të kufizuara përjetojnë diskriminim të shumëfishtë në komunitetet lokale ku jetojnë. Për më tepër, këtyre grupeve të cenuara zakonisht u mungojnë njohuritë e mjaftueshme mbi të drejtat sociale dhe qasjen ndaj shërbimeve sociale, arsimore dhe shëndetësore. Më tutje, nuk ka politika në nivel lokal që mbështesin këtë grup të cenuar në Komunën e Istogut. Siç u përmend më lartë, ka mungesë të të

dhënave lidhur me numrin e personave me aftësi të kufizuara që ndikon punën e kryer nga Qendra për Punë Sociale (QPS) në komunë. Numrat e saktë do t'i ofronin kësaj Qendre një numër më të saktë sa i përket subvencioneve lehtësuese. Fëmijët me aftësi të kufizuara ballafaqohen me diskriminim të shumëfishtë në arsim si rezultat i qasshmërisë së kufizuar në ndërtesa, mungesës së asistentëve personal për mësimnxënie, etj. Njëkohësisht, prindërit e tyre diskriminohen për shkak se njëri prej prindërve detyrohet të tërhiqet nga puna në mënyrë që të kujdeset për fëmijun. Veçanërisht me rëndësi, duhet theksuar se fillimisht nuk kishte qendër për qëndrim ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara apo transport publik të disponueshëm, mirëpo përmes Projektit të financuar nga qeveria Gjermane, dhe implementuar nga AKK, NALAS dhe GIZ, në nëntor të vitit 2024, për herë të parë Komuna e Istogut hapi Qendrën për fëmijë me aftësi të kufizuara.

Pjesë e këtij procesi ka qenë edhe konsultimi i dokumenteve ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare që udhëzojnë apo përmbajnë praktikën më të mira dhe mësimet e nxjerra për përpilimin e planeve strategjike për përfshirjen sociale të grupeve të ndjeshme (praktikat më të mira të zbatuara nga NALAS, përmes projektit të GIZ për të funksionalizuar kornizën e Mos Lë Askënd Pas, praktika e komunës së Roskovecit në Shqipëri, si dhe zhvillimi i udhëzuesit për përpilimin e planeve strategjike për përfshirjen sociale të grupeve të ndjeshme, në nivel lokal.

Pas këtyre hapave, procesi dhe identifikimit të fëmijëve dhe familjeve me aftësi të kufizuara, **SWOT** analiza e bërë në bashkëpunim me GP të komunës së Istogut ka treguar këto rezultate:

Pikat e forta:

-Komuna e Istogut ofron shërbime shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara përmes subvencionimit të OJQ lokale-HANDIKOS, që është e specializuar për këto shërbime, kurse Objekti për qendrën ditore për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara, është identifikuar, është ekzistues-duhet të përshtatet për qendrën ditore dhe në këtë qendër synohet të vazhdohet me ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara mendore, duke ofruar shërbime psiko-sociale dhe rekreative; Kjo nismë tregon se komuna e Istogut është e gatshme që të bëjë ndryshimet e nevojshme strukturale, të kapaciteteve njerëzore dhe buxhetore për të siguruar barazi dhe përfshirje të të gjitha grupeve të cenueshme;

-Përkushtimi institucional i komunës së Istogut do të vazhdojë për të mbështetur përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara, veçanërisht për të ofruar shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre dhe do të vazhdojë ofrimin e shërbimeve edhe pas përfundimit të mbështetjes nga pilot projekti i GIZ/AKK/NALAS;

-Komuna e Istogut është një ndër komunat e para që ofron 3 shërbime të rëndësishme për fëmijët me AK: logopedike, psikologjike dhe sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara;

-Bashkëpunimi i ngushtë i komunës me përfaqësuesit e grupeve dhe komuniteteve të cenueshme, fëmijëve dhe familjeve me aftësi të kufizuara bëhet edhe duke fuqizuar dhe motivuar këto grupe përmes aktiviteteve të ndryshme të rregullta, si dhe gjatë fushatave të ndryshme për ngritjen e vetëdijesimit në këtë komunë;

-Koordinimi dhe bashkëpunimi në mes të dikastereve të ndryshme në nivel lokal (arsimi, mirëqenia sociale, zyrja për komunitete dhe kthim, zyrja për barazi gjinore, zyrja e financave dhe buxhetit, OJQ lokale, drejtorati për rini, sport, kulturë), është në nivel shumë të kënaqshëm, tashmë edhe përmes GP që është formuar;

-Përkushtimi i kryetarit të komunës dhe asamblesë komunale të Istogut për të përkrahur Drejtorinë e Mirëqenies Sociale dhe nismave e projekteve për ofrimin e shërbimeve sociale për grupet e ndjeshme dhe familjeve të tyre, si komunitet, është shumë i madh dhe i vazhdueshëm.

Mundësitë:

-Bashkëpunimi me bizneset lokale për mbështetje të aktiviteteve të ndryshme për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre (punësimi i prindërve, familjarëve të këtyre fëmijëve), përmes takimeve të rregullta, kampanjave për ndërgjegjësim, etj;

-Bashkëpunimi me OJQ regjionale, nacionale për ofrimin e shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara;

- Bashkëpunimi me zyret për aftësim profesional dhe zyrat për punësim, për mundësinë e ngritjes së kapaciteteve të profesionistëve që ofrojnë shërbime sociale, edukative, rekreative, shëndetësorë për këta fëmijë duke përkrahur po ashtu edhe pavarësimin e tyre dhe të familjeve të tyre, përmes trajnimeve dhe punësimit të tyre tek bizneset lokale;

-Përpilimi i projekteve, në bashkëpunim me AKK, apo edhe partnerë të tjerë, për mundësinë e bashkëpunimit me donator, biznese dhe organizata të ndryshme, që janë aktiv në lëminë e shërbimeve dhe gjithëpërfshirjes sociale.

Pikat e dobëta

-Mungesa e buxhetit të mjaftueshëm për ofrimin e shërbimeve për grupet e cenueshme

-Mos ekzistimi i një buxheti të veçantë për shërbimet sociale për fëmijët me aftësi të kufizuara mungesa e granteve specifike për fëmijët me aftësi të kufizuara, nga niveli qendror;

-Mungesa e transportit publik për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjarët e tyre, sidomos për të mundësuar qarkullimin e rregullt të tyre për të marrë shërbimet e nevojshme;

-Nuk ka analiza të rregullta, të bazuara në indikatorë, që ofrojnë informata se cila është nevoja e grupeve të fëmijëve me aftësi të kufizuara, cilat janë kapacitet dhe buxhetet që mungojnë, në nivel lokal/nivel komunal;

- Mungesa e OJQ-ve për ofrimin e shërbimeve sociale dhe përfshirëse për grupet e ndjeshme, në komunën e Istogut, duke përfshirë këtu edhe qasjen në shkolla, aktivitete kulturore dhe rekreative dhe sportive;
- Mungesa e terapeutëve, në nivel lokal dhe po ashtu edhe mungesa e kapaciteteve tek stafi profesional, në nivel komunal (arsim, punëtorëve social, OJQve që ofrojnë shërbime), për të bërë analiza të vazhdueshme për nevojat, kërkesat, nivelin e aftësisë së kufizuar por edhe për të propozuar shërbime më kreative dhe inovative për familjet me aftësi të kufizuara;
- Ndërgjegjësimi/vetëdijësimi i ulët i popullatës për sfidat, problemet dhe çështjet e grupeve të cënueshme dhe në përgjithësi për çështjet sociale dhe për konceptin e gjithëpërfshirjes sociale;

Rreziqet/Sfidat

- Ri-strukturimi dhe planifikimi i ri i stafit të komunës, paraqet sfidë sepse vendet e punës janë të limituara (stafi administrativ, asambleistët dhe stafi profesional) dhe kjo krijon hendek në punësimin e profesionistëve që ofrojnë shërbime sociale profesionale për grupet e ndjeshme, më saktësisht edhe për fëmijët me aftësi të kufizuara;
- Trajtimi afatgjatë i personave/fëmijëve me AK në komunë (edukim të mëtutjeshëm, ngritje e kapaciteteve, zhvillimi i shkathtësive dhe aftësive të tyre dhe kyçja në tregun e punës);
- Ndryshim-plotësimi i politikave sociale nga niveli qeveritar, në të ardhmen, mund të shkaktojë sfida dhe probleme për nivelin lokal, sepse nuk ka mekanizma që sigurojnë zbatimin e tyre dhe po ashtu nuk ka mbështetje financiare;
- Vështirësitë financiare nga donatorët dhe OJQ-të, që ofrojnë shërbime sociale të profesionalizuara, gjithnjë e më pak ka fonde të donatorëve, për të mbuluar zbrastëirat në sistem të ofrimit të shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara.

IV. Vizioni dhe Misioni i Komunës së Istogut për përfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara

- **Vizioni i Komunës** së Istogut është që të ndërtojë një Komunë të gjithëpërfshirëse, ku të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara, së bashku me familjet e tyre dhe kujdestarët e tyre dhe përfaqësuesit ligjor, pa dallim gjinie, etnie, moshë, aftësie fizike, statusi ekonomik apo social, të kenë mundësi të barabarta për pjesëmarrje dhe qasje në shërbimet publike, mundësitë e barabarta për arsimim, punësim dhe angazhim si dhe shërbime cilësore pa barrierë dhe zhvillimin e plotë të potencialit të tyre të plotë, po ashtu duke kontribuar në shoqërinë ku ata jetojnë dhe veprojnë. Komuna e Istogut është e përkushtuar dhe angazhohet për sigurimin e

infrastrukturës dhe burimeve për pjesëmarrjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre, kujdestarëve dhe përfaqësuesve ligjorë për pjesëmarrje në arsim, mbrojtje sociale, shëndetësi, punësim, aktivitete politike dhe kulturore.

- **Misioni i Komunës** së Istogut për gjithëpërfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara, është fillimisht përkrahja me shërbime adekuate dhe cilësore, për këta fëmijë dhe familjet e tyre, gjithashtu përkrahje morale gjatë këtij procesi dhe udhëzimi i personave të caktuar qofshin ata vendimmarrës ose edhe punëtorë drejtë qëllimit të përbashkët që të rezultojnë në lehtësimin e kushteve ekonomike, arsimore dhe sociale për jetën e këtyre fëmijëve dhe familjeve të tyre.

V. Qëllimi dhe Objektivat e Përfshirjes Sociale Strategjike të komunës së Istogut

Qëllimi: Përmirësimi i mirëqenies së përgjithshme të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre, kujdestarëve dhe përfaqësuesve ligjorë duke krijuar mjedis dhe burime për pjesëmarrjen e tyre në aktivitete arsimore, sociale, shëndetësore, punësimit, strehimit, kulturore dhe politike në baza të barabarta si të tjerët dhe kjo do të bëhet përmes përkrahjes së vazhdueshme nga të gjitha strukturat komunale përkatëse, për tre vitet e ardhshme (2025-2027).

Objektivat strategjike (2025-2027) të Planit Strategjik për gjithëpërfshirjen sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara në Komunën e Istogut, janë:

- 1. Përmirësimi i qasjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre në shërbime cilësore të bazuara në komunitet, të rëndësishme për statusin e tyre social-arsimor dhe të punësimit.**

1.1 Deri në vitin 2027, të sigurohet qasja fizike në të gjitha institucionet publike komunale për fëmijët me aftësi të kufizuara në të paktën 80% të hapësirave komunale.

1.2 Deri në vitin 2027, të ulen për 30% pengesat për qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet ku marrin shërbime sociale, arsimore dhe shëndetësore cilësore në nivel komunal.

1.3 Përkrahja për vazhdimin e punës së Qendrës Ditore për ofrimin e shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuara

2. Integrimi i përfshirjes sociale dhe aftësisë së kufizuar në strukturat institucionale të komunës.

2.1 Deri në vitin 2027, të paktën 70% e punonjësve kanë rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë e tyre për aftësinë e kufizuar dhe specifikat për ofrimin e shërbimeve për këtë kategori të grupeve të cënueshme;

2.2 Të krijohen manuale dhe protokolle pune për menaxhimin e rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara në nivel komunal deri në mesin e vitit 2027, për të gjitha dikasteret e sipërpërmendura, përfshirë edhe OJQ që ofrojnë shërbime, duke angazhuar së paku një punonjës social dhe një psikolog.

3. Zhvillimi i mundësive të barabarta në arsim, edukim joformal, shërbime shëndetësore, shërbime sociale dhe ekonomike e të punësimit dhe pjesëmarrjen e barabartë, në jetën sociale, duke promovuar dhe aplikuar edhe shërbime të koordinuara dhe bashkëpunuese, në nivel komunal, në mes të institucioneve dhe po ashtu edhe institucioneve të tjera apo OJQ-ve.

3.1 Deri në fund të vitit 2026, të krijohen ekipe komunale të koordinuara ndër-institucionale në nivel komunal, për ofrimin e shërbimeve të koordinuara të arsimit, shërbime sociale dhe shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

3.2 Të zhvillohen dhe aplikohen modele bashkëpunimi ndërmjet komunave dhe OJQ-ve për shërbime gjithëpërfshirëse në nivelin e ulët, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë arsimor dhe të shërbimeve shëndetësore dhe kulturore e rekreative për fëmijët me aftësi të kufizuara, deri në fund të vitit 2027.

4. Fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje dhe të marrin pjesë në shërbimet sociale:

4.1 Deri në vitin 2027 do të fuqizohet edhe më tutje qendra ditore për fëmijët me aftësi të kufizuara.

4.2 Deri në vitin 2027, komuna e Istogut të ketë një ofrues të licencuar institucional të shërbimeve sociale, ku do të ketë profesionist të trajnuar për të ofruar shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara.

4.3 Deri në vitin 2027, të paktën 20% e fëmijëve me aftësi të kufizuara do të përmirësojnë aftësitë sociale, njohëse dhe shkathtësitë për jetesë sa më të pavarur.

4.4 Komuna të hartojë dhe zbatojë fushata vjetore ndërgjegjësuere kundër diskriminimit dhe për përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat në nivel komunal (arsim, shëndetësi, shërbime sociale dhe sport e rekreacion).

5. Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë qasje dhe marrin pjesë në shërbimet e kujdesit shëndetësor

- 5.1 Deri në vitin 2027, do të prezantohet shërbimi i lëvizshëm/mobil i kujdesit të përgjithshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe prindërit e tyre.
- 5.2 Deri në vitin 2027 do të koordinohen ekipet për ofrimin e shërbimeve sociale dhe të kujdesit shëndetësor parësor për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre nga zonat rurale dhe urbane.
- 5.3 Deri në vitin 2027 do të zhvillohet ose inicohet procesi i zhvillimit të regjistrimit institucional të koordinuar, të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në komunën e Istogut.

VI. Deklaratë mbi Prioritetet e Përfshirjes Sociale

Përfshirja sociale është një ndër prioritetet kryesore në ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse, ku çdo individ ka mundësi të barabarta për pjesëmarrje aktive në jetën ekonomike, sociale, kulturore dhe politike. Prioriteti i Komunës së Istogut është të siguroj që grupet më të ndjeshme – përfshirë fëmijët, personat me aftësi të kufizuara, komunitetet romë dhe ashkali, të moshuarit dhe të rinjtë – të kenë qasje të plotë në arsim cilësor, shërbime shëndetësore, punësim dinjitoz dhe mbështetje sociale. Zhvillimi i politikave të qëndrueshme dhe ndërhyrjeve të drejtuara është thelbësor për të eliminuar diskriminimin dhe për të forcuar barazinë në mundësi.

Në këtë drejtim, synojmë të ndërtojmë struktura dhe mekanizma funksionalë që përkrahin integrimin social përmes bashkëpunimit ndërinstitutional dhe përfshirjes aktive të shoqërisë civile. Promovimi i barazisë gjinore, mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe fuqizimi i komuniteteve në nevojë janë pjesë përbërëse e këtij angazhimi. Vetëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme mund të arrijmë një shoqëri më të barabartë, ku secili qytetar ndihet i respektuar, i përfshirë dhe i fuqizuar për të kontribuar në zhvillimin e vendit.

Në vazhden e aktiviteteve dhe zhvillimit të programeve që përkrijnë me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm OZHQ-të, specifiku për Objektivin e 10-të i cili synon **uljen e pabarazive brenda dhe ndërmjet vendeve**, objektivi ky i cili fokusohet në krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë, pavarësisht moshës, gjinisë, përkatësisë etnike, prejardhjes, religjionit apo statusit ekonomik, që përfshin masa për të siguruar përfshirje sociale, ekonomike dhe politike për grupet e marginalizuara dhe të pafavorizuara dhe po ashtu, thekson rëndësinë e legjislacionit dhe politikave që mbrojnë të drejtat e njerëzve dhe promovojnë drejtësinë shoqërore.

Në thelb, siç edhe ceket në Objektivin 10 të OZHQ-ve, kjo duhet të jetë një thirrje për drejtësi dhe barazi në një botë ku shpërndarja e pasurisë, mundësive dhe përfaqësimit

shpesh është e padrejtë. Realizimi i këtij objekti është i domosdoshëm për një zhvillim më të drejtë dhe të qëndrueshëm me theks të veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre, që është edhe principi kryesor në të cilin është bazuar edhe ky plan strategjik i komunës së Istogut dhe do të shërbejë si një nga principet kryesore për zbatimin e tij në 3 vjetët e ardhshme.

VII. Plani i Veprimit									
Objektivi Strategjik	Objektiva Specifike	Rezultatet e Pritshme	Aktivitetet Kryesore	Treguesit (Indikato rët)	Afati Kohor	Përgjegjësit	Reziqet dhe Supozimet	Burimet e Financimit	Kostot e përafërta buxhetore (€) për 3 vjet
1.Përmirësi mi qasjes dhe pjesëmarrjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe prindërve të tyre në shërbime cilësore të bazuara në komunitet, të rëndësishme për statusin e tyre social-arsimor	1.1 Deri në vitin 2027, të sigurohet qasja fizike në të gjitha institucione t publike komunale për fëmijët me aftësi të kufizuara në të paktën 80% të hapësirave komunale.	Institucione t për shërbime sociale janë të aksesuesh me ,të paktën 80% e tyre dhe ofrojnë shërbime sociale cilësore për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara	Hartimi i planit të përshtatjes; Implementimi i përshtatjeve infrastrukturore dhe ofrimit të shërbimeve	Rritje për 80% e përfshirjes e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet shkollore sipas nevojës dhe nivelit të duhur	2025–2027	Komuna, DMS, MASHTI, MFPT, HANDIKOS	Mbështetje politike dhe financiare nga niveli lokal; Mungesa e buxhetit në nivel komunal; zgjedhjet komunale ne fund te vitit 2025	Buxhet komunal, donatorë të mundshëm;	30,000

dhe të punësimit									
	1.2 Deri në vitin 2027, të ulen për 30% pengesat për qasjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucione t ku marrin shërbime sociale, arsimore dhe shëndetësore cilësore me deri në, në nivel komunal	Më shumë fëmijë me aftësi të kufizuara të kenë mundësi të qasen dhe të përfitojnë shërbime sociale	Kontaktet dhe puna e përditshme e profesionistëve me fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre, në nivel komunal-Ofrimi i shërbimeve me bazë në komunitet	Numri i fëmijëve me aftësi të kufizura të përfshirë të rritet me 80%; Numri i shërbimeve të ofruara, të rriten me 80%	2025–2027	QPS, DKA, OJQ	Bashkëpunimi i institucioneve dhe komunitetit /OJQ-ve; zgjedhjet komunale në fund të vitit 2025	Buxheti komunal dhe ai shtetëror, OJQ partnere, donatorët e mundësime;	25,000
	1.3Përkrahja për vazhdimin	Ofrimi i hapësirës dhe	Mbajtja e aktiviteteve të rregullta, sic janë paraparë me plan për	Rritja e nr. të fëmijëve	2025-2027	DMS, DKA, QPS dhe OJQ	Mungesa e buxhetit dhe	Komuna, OJQ lokale dhe	80,000

	e punës së Qendrës Ditore për ofrimin e shërbimeve për fëmijë me aftësi të kufizuara	buxhetit adekuat nga ana e komunës, dhe pagesa e profesionistëve që të ofrojnë shërbimet përkatëse të duhura kufizuara për fëmijët me aftësi të dhe familjet e tyre dhe për të koordinuar edhe me shërbimet e tjera në nivel lokal, edhe me OJQ-të përkatëse	këtë Qendër Ditore; Takimet e rregullta me shërbimet e tjera (Arsim, shëndetësi, OJQ, QAP dhe ZP), dhe me prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar	në këtë Qendër për të paktën 40% deri në vitin 2027			përkushtimi të të gjitha dikastereve në nivel komunal, zgjedhjet komunale në fund të vitit 2025; zgjedhjet komunale në fund të vitit 2025	bizneset lokale	
2.Integrimi i përfshirjess	2.1 Deri në vitin 2027, të paktën	Nr. i Punonjëssve,	Zhvillimi i moduleve trajnuese; identifikimi i profesionistëve për të	Numri i punonjësve të	2025-2027	Komuna, MAPL, MASHTI,	Pjesëmarrje aktive e dhe	Komuna, MAPL, MASHTI,	30,000

ociale dhe aftësisë së kufizuar në strukturat institucionale të komunës.	70% e punonjësve kanë rritur ndërgjegjësimin dhe njohuritë e tyre për aftësinë e kufizuar dhe specifikat për ofrimin e shërbimeve për këtë kategori të grupeve të cenueshme	profesionistëve të trajnuar dhe akreditimet dhe titujt/shkathtësitë e marra	u trajnuar, identifikimi i temave dhe shkathtësive që aftësive që do të zhvillohen	trajnuar me 80% , në nivel komunal		MFPT, OJQ, donatorët/organizatat ndërkombëtare	përkushtimi i tyre; Disponueshmëria e trajnimeve të duhura, të akredituara dhe trajnerët dhe organizatat e akredituara ; zgjedhjet komunale në fund të vitit 2025	projekte të donatorëve	
	2.2 Të krijohen manuale dhe protokolle pune për menaxhimin e rasteve të fëmijëve me aftësi të kufizuara	Manuale ose doracak praktike për përdorim	Identifikimi i temave për të u zhvilluar dhe për të u zbatuar; Draftimi dhe miratimi i manualeve/protokolleve/doracakëve	Numri i manualeve dhe doracakëve të miratuar a; Institucione që i zbatojnë	2025–2026	Komuna, MASHTI, MAPL, MFPT	Miratimi i dokumenteve, jetësimi i tyre dhe fillimi i zbatimit	MASHTI, MAPL. MFPT komunat, projekte	3,000

	në nivel komunal deri në mesin e vitit 2027, për të gjitha dikasteret e sipërpërme ndura, përfshirë edhe OJQ që ofrojnë shërbime, duke angazhuar së paku një punonjës social dhe një psikolog.								
3. Zhvillimi i mundësive të barabarta në arsim, edukim joformal,	3.1 Deri në fund të vitit 2027 të krijohen ekipe komunale të koordinuar	Formimi i të paktën nja grupi funksional komunal për koordinimin e të gjitha	Krijimi i ekipeve lokale dhe funksionalizimi i tyre, duke i përpiluar Termat e Referencës, përcaktimi i roleve dhe përgjegjësi dhe mbajtja e takimeve të rregullta periodike me	Grupi i formuar dhe funksional, deri në fund të vitit 2025;	2025–2027	Komuna, DMS QPS, DKA, NJësi për të drejta të njëriut, drejtorati për buxhet dhe financa	Funksionimi i ekipit dhe koordinimi efektiv; zgjedhjet komunale në fund të vitit 2025	Komunat, donatorët lokal	1,000

shërbime shëndetësore, shërbime sociale dhe ekonomike e të punësimit dhe pjesëmarrjen e barabartë, ne jetën sociale, duke promovuar dhe aplikuar edhe shërbime të koordinuar dhe bashkëpunuese, në nivel komunal, në mes të institucion	a ndër-institucionale në nivel komunal, për ofrimin e shërbimeve të koordinuar të arsimit, shërbime sociale dhe shëndetësore për fëmijët me aftësi të kufizuara	çështjeve që lidhen me fëmijët me aftësi të kufizuar dhe familjet e tyre, për shërbime të tjera relevante	agjendë, qëllim dhe fokus të veçantë	Numri i mbledhjesh dhe takimeve, të paktën 3 për vit dhe vendimet e marra dhe shërbimet e koordinuara dhe të ofruara						
--	---	---	--------------------------------------	--	--	--	--	--	--	--

eve dhe po ashtu edhe institucion eve të tjera apo OJQ-ve.									
	3.2 Të zhvillohen dhe aplikohen modele bashkëpunimi ndërmjet komunave dhe OJQ-ve për shërbime gjithëpërfshirëse në nivelin e ulët, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë arsimor dhe të	Të paktën një model i zhvilluar që zbatohet dhe mbanë vizita dhe takime të rregullta	Formimi këtij ekipi dhe përpilimi i një dokumenti bazë për koordinim dhe ofrim të shërbimeve në terren	Nr.i vizitave dhe takimeve të rregullta, të paktën nga 3 në vit; nr i fëmijëve më aftësi të kufizuara që kanë marrë shërbime dhe cilat shërbime dhe si	2025–2027	Komuna, DMS, OJQ, Njësiti për të drejta të njeriut, drejtorati për buxhet dhe financa, drejtorati i shëndetësisë, DKA	Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe OJQ-ve të gatshme për bashkëpunim; zgjedhjet komunale në fund të vitit 2025	Donatorë ndërkombëtarë, bashkëfinancim komunal, biznese lokale, etj	1,000

	shërbimeve shëndetësore dhe kulturore e rekreative për fëmijët me aftësi të kufizuara, deri në fund të vitit 2027.								
4. Fëmijët me aftësi të kufizuara të kenë qasje dhe marrin pjesë në shërbimet sociale	4.1 Deri në vitin 2027 do të fuqizohet edhe më tutje qendër njëditore për fëmijët me aftësi të kufizuara.	Qendra ditore të jetë strukturalisht dhe përmbajtësisht funksionale dhe të ofroj shërbime të integruara për fëmijët me aftësi të kufizuara	-Takime të rregullta të qendrës me DMS dhe institucionet tjera relevante për të raportuar për punën e qendrës; -DMS dhe komuna do të ndajnë buxhet në baza vjetore për qendrën; -Analiza për nevojat e qendrës dhe -Aktivitete për ngritjen e kapaciteteve të profesionistëve të qendrës;	Nr. i fëmijëve me aftësi të kufizuara që kanë qasje në secilën shërbim, krahasim i me numrat e mëhershëm; cfarë	2026-2027	DMS, Komuna, Qendra Ditore; Drejtorati për buxhet dhe financa,	Zgjedhjet e reja komunale në 2025 dhe mundësitë e limituara buxhetore	Komuna, DMS	10,000

			-Angazhimi i një punëtori social dhe psikologut shtesë, sipas nevojës së qendrës; -Promovimi i qendrës ditore në komunitet, në baza të rregullta	shërbime sh kanë kërkuar dhe koha brenda së cilës i kanë marrë ato					
	4.2 Deri në vitin 2027, komuna e Istogut të ketë një ofrues të licencuar institucionale të shërbimeve sociale, ku do të ketë profesionist të trajnuar për të ofruar shërbime për fëmijët me aftësi të kufizuara	Qendra Ditore të licencohet sipas standardeve, nga Ministria e Drejtësisë	Promovimi i qendrës ditore në nivel lokal dhe qëndror dhe shërbimet që ofrohen aty	Nr. i atyre që kanë më shumë informata për qendrën dhe nr i rritur i atyre që vizitojnë dhe marrin shërbime në këtë qendër	2025–2027	Komuna, DMS, drejtorati për buxhet dhe financa, MD	Mundësitë e limituara buxhetore për vazhdimësi në e kësaj qendre si dhe zgjedhjet lokale	Komuna, DMS	2,000

	4.3 Deri në vitin 2027, të paktën 20% e fëmijëve me aftësi të kufizuara do të përmirësoj në aftësitë sociale, njohëse dhe shkathtësit ë për jetesë më të pavarur.								
	4.4 Komuna të hartoj dhe zbatoj fushata vjetore ndërgjegjësuese kundër diskriminimit dhe për	Fushatat ndërgjegjësuese për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe pjesëmarrje	Të përzgjidhen mesazhet dhe motot e fushatës; Hapja e thirrjes për kompanitë; Krijimi i grupeve për ndërgjegjësim, në bashkëpunim edhe me OJQ ofruese të	Takimet e rregullta me të gjithë akterët relevant; Përzgjedhja e qasjes	2025-2027	DMS, Njësi për të drejtat e njeriut, shoqëria civile, kompania përkatëse	Mungesa e buxhetit për fushatën më afatgjatë.		3,000

	përfshirje të fëmijëve me aftësi të kufizuara në të gjitha fushat në nivel komunal (arsim, shëndetësi, shërbime sociale dhe sport e rekreacion).	n e tyre në shoqëri	shërbimeve për fëmijët me aftësi të kufizuara	për fushatë; Nr. i personave të arritur në fushatë					
5. Fëmijët me aftësi të kufizuara kanë casje dhe marrin pjesë në shërbimet e kujdesit shëndetësore	5.1 Deri në vitin 2027, do të prezantohe t shërbimi i lëvizshëm/ mobil i kujdesit të përgjithshëm për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe	Krijimi i ekipit mobil për vizita në familjet me fëmijë me aftësi të kufizuara	-Takimet në terren dhe në vendet rurale për përpilimin e listave; -Përcaktimi i anëtarëve të ekipit mobil dhe përgjegjësitë e tyre dhe detyrat; Raportet e përpiluara të ekipit dhe analizat e tyre	Nr. i fëmijëve që kanë marrë shërbime ; Nr. i fëmijëve që marrin shërbime shëndetësore	2026-2027	DSH, DMS, QPS, Qendra Ditore, Njësiti për të drejta të njeriut, OJQ lokale	Mungesa e stafit për të shkuar në terren dhe mungesa e mjeteve/ve turave dhe buxhetit	DSH, QPS, Komuna , DMS, OJQ lokale	0

	prindërit e tyre.								
	5.2 Deri në vitin 2027 do të koordinohet ekipet për ofrimin e shërbimeve sociale dhe të kujdesit shëndetësor parësor për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre nga zonat rurale dhe urbane	Formimi dhe funksionalizimi i të paktën një ekipi multi-sektorial	Raportet e përpiluara të ekipit dhe analizat e tyre	Nr. i fëmijëve që kanë marrë shërbime ; Nr. i fëmijëve që marrin shërbime shëndetësore	2027	DSH, DMS, QPS, Qendra Ditore, Njësiti për të drejta të njeriut, OJQ lokale, DKA	Mungesa e stafit për të shkuar në terren dhe mungesa e mjeteve/ve turave dhe buxhetit	DSH, QPS, Komuna , DMS, OJQ lokale, DKA	0
	5.3 Deri në vitin 2027 do të zhvillohet ose inicohet procesi i	Përpilimi i regjistrit/lishtës zyrtare për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe llojin e	Përpilimi i principit të listës, qëllimit dhe mënyra e grumbullimit të të dhënave; ndarja e përgjegjësisë;	Nr. i fëmijëve me aftësi të kufizuara , lloji i aftësisë	2027	DSH, DMS, QPS, Qendra Ditore, Njësiti për të drejta të njeriut, OJQ lokale, DKA	Mungesa e stafit për të shkuar në terren dhe mungesa e mjeteve/ve	DSH, QPS, Komuna , DMS, OJQ lokale, DKA	3,000 Euro

	zhvillimit të regjistrit instituciona l të koordinuar, të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në komunën e Istogut.	aftësisë së kufizuar në komunën e Istogut	Grumbullimi i të dhënave nga QPS , OJQ lokale, DSH, DKA	së kufizuar, vendbani mi, mosha gjinia, nevojat për shërbime , etj			turave dhe buxhetit		
TOTALI									188,000 Euro

VIII. Treguesit e Performancës (Indikatorët)

- Rritje për të paktën 30% e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara nga në sistemimin e rregullte arsimore, qasje në shërbime sociale, shëndetësore dhe të tjera;
- Me shumë se 80% e objekteve publike dhe shërbimeve sociale e të tjera, të përshtatura për personat me aftësi të kufizuara deri në vitin 2027.
- 80% e stafit komunal të trajnuar për çështje të gjithë përfshirjes deri në fund të vitit 2027
- Rritje e pjesëmarrjes qytetare në proceset vendimmarrëse komunale përmes platformës online dhe konsultimeve publike me theks në fushën e aftësisë së kufizuar dhe sferat që prekin interesat e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe të situatës sociale të tyre dhe të familjeve të tyre,
- 20% Ulje e rasteve të raportuara për diskriminim përmes sistemit të mbikëqyrjes dhe mekanizmave të reagimit,
- 30% Rritje në identifikimin e fëmijëve me aftësi të kufizuara , nevojave të tyre dhe të familjeve të tyre dhe referimi i tyre në shërbime adekuate në nivel të komunës, ose tek OJQ-të;
- Përpilimi i regjistrit institucional për numrin dhe llojin e aftësisë së kufizuar për Komunën e Istogut.
- Rritja e vetëdijes së profesionistëve në nivel lokal dhe popullatës në përgjithësi për aspektin e të drejtave të njeriut, mos-diskriminimit, qasjes në shërbime dhe përfshirjes sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre;
- Zhvillimi i mekanizmave lokale koordinuese, të paktën 2 në mes të institucioneve dhe OJQ dhe bizneseve lokale, me qëllim të ofrimit të shërbimeve sa më cilësorë dhe gjithëpërfshirëse për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre;
Kufizim në aktivitetin e klasifikimit të lëndës arkivore po na paraqet mungesa e kutive arkivore dhe materialit tjetër arkivor për klasifikimin e lëndës arkivore. Për klasifikimin e këtij materiali arkivorë na nevojiten mbi 500 kuti arkivore dhe materialit tjetër të domosdoshëm që do të specifikohet në kërkesë.

Me ndryshimin e infrastrukturës ligjore dhe akteve të tjera nënligjore është paraqitur si nevojë edhe konsultimi me komisionin përkatës të Arkivit të Kosovës, për mënyrën e asgjësimit të materialit të pavlefshëm dhe atij që i ka kaluar afati i ruajtjes.

Marrë në tërësi edhe përkundër vërejtjeve, propozimeve dhe sugjerimeve të paraqitura mbi rezultatet e arritura në punë për periudhën raportuese jemi të kënaqura.

Vërejtjet dhe sugjerimet eventuale që mund të paraqiten janë të mirëseardhura me kusht që në të ardhmen puna të perfeksionohet kurse ndonjë lëshim eventual të korrigjohet.

v. Qendra për shërbim të qytetarëve.

Përmes kësaj zyre qytetarët më lehtë mund t'i adresojnë kërkesa e tyre dhe të marrin përgjigje. Në këtë kuptim të gjitha kërkesat për të gjitha organet komunale kalojnë përmes këtij shërbimi. Gjithashtu nga kjo zyre udhëzohen të gjithë qytetarët për realizimin e të drejtave të tyre në pushtetin lokal dhe për procedurat e realizimit të këtyre të drejtave. Gjatë periudhës Janar-Qershor 2025, në këtë shërbim janë pranuar një numër i madh i kërkesave të cilat gjenden në tabelën e mëposhtme të drejtuar të gjitha drejtoritë, kryetarit dhe kuvendit.

Numri i kërkesave sipas Drejtorive, gjashtëmuor: 03.01-16.06-2025

Drejtoria	Pranu ar	Ne Proc es	Miratu ar	Refuzu ar	Hedh ur Posht ë	Pezullu ar	Cedu ar	Anulu ar	Përfundu ar	Total i
-----------	-------------	------------------	--------------	--------------	--------------------------	---------------	------------	-------------	----------------	------------

Drejtoria për Administratë dhe Personel	3	286	844	4	0	0	0	9	11,194	11,340
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	0	3	9	17	0	0	0	2	0	31
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	0	52	0	0	0	0	0	1	0	55
Drejtoria për Arsimit	0	294	1,555	73	0	0	0	39	0	1,961
Drejtoria për Punë të Inspeksionit	0	28	29	0	1	0	0	1	0	59
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	4	363	377	0	0	0	0	2	0	746
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	0	203	200	20	0	0	0	7	0	430
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	3	94	2,786	5	0	0	0	10	0	2,898
Kryetari i Komunës	0	130	35	5	0	0	1	3	0	174
Zyra Lokale e Komuniteteve	0	14	0	0	0	0	0	0	0	14

Kuvendi Komunal	0	2	0	0	0	0	0	0	0	2
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis	0	51	245	16	0	13	0	2	0	327
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	0	26	17	5	0	0	0	9	0	57
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	0	26	127	0	0	0	0	2	0	155
	10	1,572	7,309	145	1	13	1	87	11,194	19,247

Departamenti	Numri i lëndëve të arkivuara	Numri i lëndëve të asgjësuar	Numri i dokumenteve
Drejtoria për Administratë dhe Personel	12	0	14
Drejtoria për Arsim	3	0	3
Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural	144	0	272
Drejtoria për Buxhet dhe Financa	7	0	7
Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim	151	0	243
Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë	1117	0	1603
Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport	0	0	0
Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis	28	0	57
Drejtoria për Punë të Inspeksionit	3	0	7
Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale	206	0	453
Drejtoria për Shërbime Publike dhe Siguri	414	0	416
Kryetari i Komunës	323	0	397

Kuvendi Komunal	0	0	0
Zyra Lokale e Komuniteteve	0	0	0
Totali:	2408	0	3472

vi. Zyra e Prokurimit

Ju prezantojmë aktivitetet e zhvilluara të cilat janë të procesuara nga zyra e prokurimit për periudhën 01.01.2025 deri më 30.06.2025: publikimi i njoftimit për kontratë dhe njoftim për nënshkrim të kontratës, kërkesat për rishqyrtim në AK dhe ankesat në OSHP.

Zyra e Prokurimit në Komunën e Istogut ka vazhduar të operojë në përputhje me ligjet dhe rregulloret vendore për administratën publike.

Përgjegjshmëria kryesore ka përfshirë:

Prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve sipas nevojave nga njësitë - drejtoritë e ndryshme të komunës bazuar në Planifikimin e prokurimit për vitin 2025.

Lloji i njoftimit të publikuar	Numri i publikimeve
Njoftim për kontratë	32
Njoftim për dhënie të kontratës	23
Njoftim për nënshkrim të kontratës	23
Kërkesa për rishqyrtim në AK	6
Ankesa në OSHP	4

Nga 32 Njoftimet për kontratë (aktivitetet) e publikuara, 31 Njoftime për kontratë janë të publikuara me pjese (lote), pra 32 Njoftime për kontratë përmbajnë 61 aktivitete të prokurimit e që në total janë të publikuara 61 aktivitete të prokurimit të cilat janë furnizime, shërbime dhe punë të ndryshme, në vlera të mëdha, të vogla dhe minimale.

Ky raport përfshinë një pasqyrë të qartë dhe të përgjegjshme të performancës së Zyrës së Prokurimit në Komunën e Istogut gjatë periudhës 6-mujore. Të gjitha proceset e prokurimit janë kryer duke përmbushur ligjet dhe rregulloret vendore dhe qendrore të prokurimit publik, duke siguruar transparencë dhe drejtësi në zgjedhjen e furnizuesve. Zyra e Prokurimit angazhohet për vazhdimin e përmirësimit të proceseve dhe për të përmbushur nevojat e përdoruesve të tij brenda standardeve të larta të qeverisjes dhe përgjegjshmërisë administrative.

vii. Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është mekanizëm monitorues për respektimin e të drejtave të njeriut në relacionin komunë-qytetarë, funksion si sektor/njësi e veçantë në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale.

Misioni i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është vëzhgimi i respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe reagimi për vënien e tyre në vend, sensibilizimi i qytetarëve për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të tyre, përmirësimi i akteve nënligjore komunale, praktikës për zbatimin e këtyre akteve, barazia gjinore, të drejtat e fëmijëve, mundësi të barabarta dhe mos diskriminim, të drejtat e komuniteteve, përdorimi i gjuhëve, kundër trafikimit me qenie njerëzore, personat me aftësi të kufizuara.

Struktura e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete :

1. Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete;
2. Zyrtarja për Barazi Gjinore e caktuar edhe në detyrat: Zyrtare për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe
3. Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Rintegrim.

Buxheti i Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete për vitin 2025 ka qenë i planifikuar gjithsej 6000 euro në kategorinë subvencione dhe transfere.

Në pajtim me procedurat e përcaktuara në Rregulloren e Ministrisë së Financave, Nr.04/2017 mbi Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik, janë përkrahur disa OJQ, lidhur me tryeza/aktivitete për të drejtat e njeriut.

Pasi një nder përgjegjës të këtij sektori është edhe vetëdijësimi dhe sensibilizimi i qytetarëve lidhur me të drejtat e tyre, kemi organizuar tryeza/aktivitete dhe shënuar data, të cilat kanë të bëjnë me avokimin dhe sensibilizimin e qytetarëve për të drejtat në përgjithësi e në veçanti për të drejtat e grave, fëmijëve, personave me aftësi të kufizuara, të komuniteteve dhe mos diskriminim.

Në periudhën Janar-Qershor 2025 janë mbajtur këto tryeza/aktivitete të parapara me planin e punës së SDNJK:

Shënimi i 8 Marsit “Dita Ndërkombëtare e Gruas”

Tryezë diskutimit në bashkëpunim me OJQ “Qendrën për Mirëqenien e Gruas”, më rastin e shënimit të 8 Marsit “Dita Ndërkombëtare e Gruas”. Tema kryesore e kësaj tryeze ishte “Sfidat, vështirësitë dhe të arriturat e grave”. Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi lidhur me sfidat që kanë gratë, diskriminimi gjinor, mungesa e përfaqësimit si dhe fuqizimi i rolit të gruas në të ardhmen.

Pjesë e kësaj tryeze ishin: asamblistët e kuvendit të komunës, drejtoreshat e drejtorive përkatëse, udhëheqëset e sektorëve, përfaqësues të OJQ-ve dhe zyrtare komunale. Në fund të takimit u dhuruan lule për nder të festës së 8 Marsit.

Në tryezën e diskutimit ishin prezentë 16 pjesëmarrës/pjesëmarrëse prej tyre 15 femra dhe 1 mashkull.

21 Marsi “Dita Ndërkombëtare e Sindromës Down”

Në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Sindromës Down, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete – Drejtoria për Administratë Komunale, në bashkëpunim me OJQ “Handikos” në Istog dhe iniciuasin e këtij aktiviteti, Fatbardha Hakaj Demaj, kryetare e Këshillit të Prindërve të Kopshtit “Gëzimi Ynë”, ka organizuar një aktivitet të veçantë në “Parkun e Qytetit” në Istog.

Ky aktivitet mbledhi së bashku prindër dhe fëmijë/persona me Sindromën Down, me qëllim gjithëpërfshirës dhe mbështetjes për këtë komunitet. Gjatë aktivitetit u diskutua mbi sfidat dhe arritjet e personave me Sindromën Down, si dhe u promovua mesazhi për një shoqëri më të barabartë dhe më të ndjeshme ndaj diversitetit.

Organizatorët theksuan se përmes përkushtimit dhe bashkëpunimit mund të krijohen mundësi më të mira për përfshirjen e plotë të personave me Sindromën Down në jetën sociale dhe edukative. Kjo ngjarje është pjesë e përpjekjeve të vazhdueshme për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ndërtuar një shoqëri që i pranon dhe i mbështet të gjithë pa dallim.

8 Prilli “Dita Ndërkombëtare e Romëve”

Në bashkëpunim me Nënkyetarin për Komunitete z.Valmir Rama, Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim dhe me mbështetjen e OSBE organizoj tryezë për manifestimin dhe shënimin e 8 Prillit “Dita Ndërkombëtare e Romëve”.

U diskutua për çështjet dhe problemet me të cilat ballafaqohet komuniteti rom, prezantim lidhur me historikun, traditat dhe kulturën romë si dhe gjendjen aktuale të tyre në shoqëri. U kërkua angazhim ma i madh të të gjithë akterve dhe vëmendje shtesë ndaj këtij komuniteti me qëllim të përmirësimit të pozitës së tyre në shoqëri, integritit në rrjedha sociale dhe rritjen e tolerancës ndaj tyre, krijimin e kushteve që të ju lehtësohen problemet me të cilat ballafaqohen.

Në tryezën e diskutimit ishin prezentë 32 pjesëmarrës/pjesëmarrëse prej tyre 21 femra dhe 11 mashkull.

12 Prill “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë Rruge”

Me rastin e shënimit të 12 – Prillit, “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve në Situatë Rruge” nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim, Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale në SHIFMU “Martin Camaj” në Gurakoc, është mbajtur një ligjëratë informuese më nxënës të klasave VI dhe Qëllimi i ligjëratës ishte informimi i nxënësve për parandalimin e dukurisë negative të kërkim-lëmshës nga fëmijët si dhe shkaqet dhe pasojat që krijon dhënia e lëmshës, me theks të veçantë tek fëmijët në situatë rruge. Në ligjëratë informuese ishin prezentë 28 nxënës/e prej tyre 16 M dhe 12 F.

Rekomandime të dalta nga ligjëratat informuese me nxënës:

- Vetëdijësimi më i madh i fëmijëve dhe qytetarëve në përgjithësi për dukurinë negative të kërkim-lëmshës, e cila po stimulon edhe me shumë që fëmijët të vazhdojnë të dëmtojnë të ardhmen dhe të mos i gëzojnë të drejtat e tyre ashtu si gjithë fëmijët tjerë;
- Raportimi i rasteve të fëmijëve në situatë rrugë në institucionin e Qendrës për Punë Sociale dhe Polici;

Fushatë vetëdijësuese lidhur me temën ” E drejta në pronë dhe trashëgimi” dhe legalizimi i pronës.

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale bazuar në Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjimore 2025-2027, në bashkëpunim me OSBE organizoi dhe mbajti dy takime me qëllim të diskutimit, informimit dhe vetëdijësimit të qytetarëve veçantë grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë, regjistrimin dhe legalizimin e pronës.

Këto takime u mbajtën në SH.F.M.U “Ismajl Qemajli” në Staradran, me datë 15.04.2025 (e Martë) dhe në SH.F.M.U “Ndre Mjeda” në Rakosh, me datë 16.04.2025 (e Mërkurë).

Qëllimi i takimeve ishte informimi, vetëdijësimi i grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë si dhe legalizimi i pronës.

z.Ylber Veseli- Përfaqësues nga OSBE - Qasja në pronësi dhe trashëgimia, prezantoi materialin e përgatitur lidhur me temën “E drejta në trashëgimi dhe pronë”.

Si ekspert i kësaj fushe ju përgjigj pjesëmarrësve lidhur me pyetjet që kishin të bëjnë më të drejtën në trashëgimi dhe pronë. Gjithashtu i njoftoj edhe për çështjen dhe rëndësinë e legalizimit të pronës. U shpërndanë fletushka me të dhëna për të drejtën në trashëgimi dhe pronë po ashtu edhe për legalizimin e pronës.

Diskutime dhe pyetje lidhur më temën pati nga shumica e grave që ishin prezentë. Në këto dy takime ishin gjithsej 46 pjesëmarrës/pjesëmarrëse, prej tyre 28 F dhe 18 M.

Rekomandime

Të organizohen sa më shumë takime në vende të ndryshme të komunës sonë me qëllim të diskutimit, informimit dhe vetëdijesimit të grave për të drejtën në trashëgimi dhe pronë si dhe legalizimin e pronës.

Sesion informues për mbrojtjen nga Diskriminimi

Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në bashkëpunim me **Organizatën Joqeveritare “Advancing Together”** dhe në bashkëpunim me Zyrën për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit, organizuan sesion informues për mbrojtjen nga diskriminimi me pjesëmarrjen e zyrtareve nga komuna e Istogut. Ky aktivitet u mbështet në kuadër të projektit të UNMIK-ut **“Bëhu Partner për Mirëqenien dhe Adresimin e Diskriminimit”**.

Qëllimi i këtyre takimeve ishte ngritja e vetëdijes lidhur me çështjen e diskriminimit dhe formave të diskriminimit, mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi dhe praktikrat e Gjykatës Evropiane dhe Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës lidhur me lëndët që kanë pas objekt shqyrtimi diskriminimin.

Në këto takime ishin gjithsej 20 pjesëmarrës, prej tyre 12 M dhe 8 F: drejtorë të drejtorive përkatëse dhe zyrtarë nga fusha të ndryshme sektoriale të komunës sonë.

15 Maji “Dita Ndërkombëtare e Familjes”

Me rastin e shënimit të 15 Majit “Dita Ndërkombëtare e Familjes” Sektori për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete në kuadër të Drejtorisë për Administratë Komunale ka organizuar një tryezë me familjet strehuese në Istog, më qëllim të diskutimit për përvojat e tyre, nevojat dhe sfidat që i hasin si familje strehuese gjatë strehimit të fëmijëve pa përkujdesje prindërore, të braktisur nga lindja, keqtrajtuar e të neglizhuar nga familja e tyre biologjike.

Tryeza e mbajtur ishte një mundësi që familjet strehuese të diskutojnë hapur mbi vështirësitë që hasin gjatë strehimit të fëmijëve dhe një mundësi për të dëgjuar njëri - tjetrin, për të mësuar për përvojat e ndryshme dhe për të gjetur zgjidhje të përbashkëta që e lehtësojnë këtë rrugëtim.

Shënimi i 1 Qershorit “Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve”

Takimi i dytë i Ekipit për të Drejtat e Fëmijës është mbajtur me datë 02.06.2025, i cili ishte takimi i përbashkët ndërmjet përfaqësuesve të Asamblesë Komunale të Fëmijëve në Istog dhe anëtarëve të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës, me rastin e shënimit të 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Qëllimi i këtij takimi të përbashkët ishte krijimi i mundësisë së tyre që si përfaqësues të Asamblesë Komunale të Fëmijëve të ngritin çështje të rëndësishme që prekin të drejtat dhe mirëqenien e të gjithë fëmijëve, duke përfaqësuar në këtë mënyrë me dinjitet shkollat komunitetin që përfaqësojnë.

Në takim ishin gjithsej 19 përfaqësues/e nga Asambleja prej tyre 6 M dhe 13 F.

12 Qershori “Dita Ndërkombëtare kundër Punës së Rëndë të Fëmijëve”

Në kuadër të Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete - Drejtoria për Administratë Komunale me rastin e shënimit të 12 Qershorit “Dita Ndërkombëtare kundër Punës së Rëndë të Fëmijëve” në FSHMU “Trepça” në Banjë, nga zyrtarja për Mbrojtje të Fëmijëve dhe Riintegrim janë mbajtur dy takime me nxënës dhe prindër me temën “Ndërgjegjësimi i prindërve dhe nxënësve për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda dhe shfrytëzimi”.

Takimet kishin si qëllim ndërgjegjësimin e prindërve, fëmijëve, institucioneve dhe qytetarëve në përgjithësi për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda, kuptimin e punës së lejuar dhe jo të lejuar të punës së fëmijëve, format më të rënda të punës së fëmijëve, shkaqet dhe pasojat e punës së fëmijëve, korniza ligjore dhe institucionale në Kosovë, të autorizuar për të vepruar dhe bashkëpunuar në identifikimin, tërheqjen, rehabilitimin dhe ri integrimin e fëmijëve të angazhuar, procesi i menaxhimit të rasteve dhe raportimi i rasteve të fëmijëve të cilët janë të përfshirë në punë të rënda.

Në këto takime ishin prezentë 38 nxënës/e prej tyre 9 M dhe 29 F, ndërsa prindër ishin prezentë 18 prej tyre 4 M dhe 14 F.

Rekomandime të dala nga prindërit dhe nxënësit :

- Parandalimi dhe raportimi i rasteve të fëmijëve të përfshirë në punë, tek institucionet përkatëse;
- Takime të vazhdueshme me prindër dhe fëmijë për ndërgjegjësimin e tyre për mbrojtjen e fëmijëve nga punët e rënda dhe shfrytëzimi i tyre si dhe pasojat negative të punës së fëmijëve;
- Marrja e masave të nevojshme nga institucionet përkatëse për rastet e fëmijëve të përfshirë në punë të rënda;

Udhëheqësja e Sektorit për të Drejtat e Njeriut dhe Komunitete është caktuar anëtare e Komitetit për Barazi Gjinore dhe zyrtare raportuese për performancë për fushën e barazisë gjinore. Po ashtu sipas autorizimit të drejtorit ushtron detyrat e zyrtares administrative për shpenzim të buxhetit, të programit buxhetor të administratës.

Zyrtarja për Barazi Gjinore është anëtare e KKSB-së dhe Koordinatore e Mekanizmit Koordinues Kundër Dhunës në Familje.

Mekanizmi Komunal Koordinues Kundër Dhunës në Familje për periudhën Janar-Qershor 2024 ka mbajtur një takim.

Ndërsa Zyrtarja për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Riintegrim është anëtare e Ekipit për të Drejtat e Fëmijës dhe në kuadër të këtij ekipi kryen punët tekniko-administrative.

Ekipi për të Drejtat e Fëmijës për periudhën Janar-Qershor ka mbajtur dy takime.

Ndërsa Asamblesë Komunale e Fëmijëve në Istog po ashtu ka mbajtur dy takime për periudhën Janar-Qershor 2025.

Janë monitoruar mbledhjet e Kuvendit Komunal dhe trupave të KK-së, dëgjimeve me qytetarë, takime tjera në kuadër të komunës dhe pjesëmarrje në trajnime, tryeza të ndryshme nga fusha e të drejtave të njeriut.

DREJTORIA PËR INSPEKSION
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Në përputhje me Planin e Punës për periudhën raportuese Janar – Qershor 2025, të Drejtorisë për Inspeksion, në kuadër të sektorëve përkatës, janë realizuar aktivitete inspektuese në terren si dhe veprime administrative në zyrë, me qëllim të mbikçyrjes së zbatimit të ligjshmërisë dhe rregulloreve përkatëse komunale.

Sikurse edhe gjatë vitit paraprak, përmes strukturës së Drejtorisë për Inspeksion janë mbuluar këta sektorë, duke përfshirë sektorin e ndërtimit (me 1 pozitë inspektoriale), sektorin e tregut (1 pozitë), sektorin e mjedisit – ambientit (1 pozitë), sektorin e veterinarisë (1 pozitë) dhe sektorin e komunikacionit (1 pozitë).

Gjatë periudhës raportuese janë :

Janë hartuar 118 procesverbale

Janë lëshuar 17 aktvendime

Janë shqiptuar 4 gjopa mandatare

Janë kryer 35 inspektime dhe 40 ri-inspektime (pa procesverbal)

Kemi 2 inicime për leje mjedisore

6 asistime te Policisë së Kosovës (Stacioni Policor Istog), asistime gjatë inspektimeve të jashtzakonshme dhe asistime në ekzekutimin e vendimeve.

Aktivitetet lidhur me therjen, shitjen dhe qarkullimin e mishit; me ç'rast janë lëshuar 595 çertifikata të therjes dhe vulosjes së mishit në thertoret e licencuara.

Krahas punëve dhe obligimeve të planifikuara, në periudhën Janar – Qershor 2025, kësaj Drejtorie i janë parashtruar 61 këkese nga ana e qytetarëve dhe biznesëve si dhe kërkesa tjera për realizimin e aktiviteteve të ndryshme inspektuese në teren nga të cilat 42 janë miratuar, 17 janë proces, 1 është hedhur poshtë dhe 1 është pezulluar .

*Raporti është i përkohshëm , pasi që është hartuar më datën 19.06/2025 , ky raport mund të ndryshoj deri me datën 30.06/2025

DREJTORIA PER BUXHET DHE FINANCA
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

RAPORTI I PUNËS PËR 6 MUJORIN E PARË 2025

SEKTORI PËR BUXHET DHE THESAR

1. Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) 2026-2028

- Korniza Afatmesme Buxhetore (KAB) për vitet 2026-2028 është dorëzuar në fund të Qershorit 2025 në Thesarin Qendror-MEF.
- Plani i të hyrave dhe shpenzimeve të Komunës për vitet 2026-2028 është përgatitur dhe përcaktuar në përputhje me parimet dhe udhëzimet e përcaktuara.

2. Të Hyrat Vetanake Komunale

- Përpunimi dhe regjistrimi i të hyrave vetanake në sistemin FreeBalance-SIMFK ka përfshirë:
 - Përpunimin dhe ndarjen e të hyrave sipas Kodeve Ekonomike.
 - Regjistrimin e të hyrave vetanake në sistemin FreeBalance dhe përcjelljen e arkëtimit të këtyre hyrave.
 - Kërkesat për alokimin e të hyrave vetanake në Thesarin Qendror.
 - Barazimi i të hyrave me Thesarin Qendror dhe raportimi i të hyrave komunale në intervale mujore, tremujore dhe gjashtëmujore.
- Te hyrat vetanake Komunale planifikimi vjetor për vitin 2025 është 1,496,508.70 € për vitin 2025.

Përshkrim	Kredi
10 - BUXHETI	731.60
633 - ISTOG	731.60
93480 - ARSIMI FILLOR - ISTOG	731.60
61000 - TË HYRAT NGA VITI I KALUAR	731.60
21 - TË HYRAT VETANAKE	730,427.45
633 - ISTOG	730,427.45
16317 - ADMINISTRATA - ISTOG	24,981.00

50013 - TAKSA PËR CERTIFIKATË TË LINDJES	2,323.00
50014 - TAKSA PËR CERTIFIKATË TË KURORËZIMIT	284.00
50015 - TAKSA PËR CERTIFIKATË TË VDEKJES	2,853.00
50016 - TAKSA PËR CERTIFIKATA TË TJERA	19,462.00
50017 - TAKSA PËR VERIFIKIMIN E DOKUMENTEVE TË NDRYSHME	59.00
16633 - INSPEKSIONI - ISTOG	3,725.00
50104 - GJOBAT NGA INSPEKTORATI	1,100.00
50205 - LICENCA PËR PRANIM TEKNIK TË LOKALEVE	2,625.00
17517 - BUXHETI - ISTOG	456,104.72
40110 - TATIMI NË PRONË	399,068.72
50001 - TAKSA PËR REGJISTRIM TË AUTOMJETEVE	57,000.00
50019 - TAKSA TË TJERA ADMINISTRATIVE	36.00
18017 - SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - ISTOG	161.00
50019 - TAKSA TË TJERA ADMINISTRATIVE	161.00
47017 - BUJQËSIA - ISTOG	2,004.00
50019 - TAKSA TË TJERA ADMINISTRATIVE	2,004.00
65085 - SHËRBIMET KADASTRALE - ISTOG	48,217.00
50032 - TAKSA PËR CERTIFIKATË TË PRONËSISË DHE KOPJE PLANI	7,798.00
50405 - SHFRYTËZIMI I PRONËS PUBLIKE	4,610.00
50504 - MATJA E TOKËS NË TERREN	35,809.00
66090 - PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RREGULLATIV - ISTOG	107,535.22
50009 - TAKSA PËR LEJE NDËRTIMI	74,410.79
50012 - TAKSA PËR NDËRRIM TË DESTINIMIT TË PRONËS	16,710.75
50026 - TAKSA PËR LEGALIZIMIN E OBJEKTEVE	8,150.84
50045 - TAKSA PËR LEJE MJEDISORE	8,262.84
74000 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - ISTOG	29,131.80
50409 - PARTICIPIMET	29,131.80
85017 - SHËRBIMET KULTURORE - ISTOG	224.00

50409 - PARTICIPIMET	224.00
92531 - ARSIMI PARAFILLOR - GËZIMI YNË - ISTOG	21,958.21
50409 - PARTICIPIMET	21,958.21
92532 - ARSIMI PARAFILLOR - LULET E JETËS - VRELLE	5,338.00
50409 - PARTICIPIMET	5,338.00
92533 - ARSIMI PARAFILLOR - SHPRESA E JONE - BANJË	7,741.00
50409 - PARTICIPIMET	7,741.00
92534 - ARSIMI PARAFILLOR - ARDHMËRIE JONE- GURRAKOC	4,667.50
50409 - PARTICIPIMET	4,667.50
94682 - SHKOLLA E MESME - MITHAT FRASHERI - GURRAKOC	18,639.00
50409 - PARTICIPIMET	18,639.00
Bilanci i përgjithshëm	731,159.05

3. Zotimet dhe Buxheti

- Gjatë periudhës, janë regjistruar 2,010 lëndë OUP dhe KZB në sistemin FreeBalance.
- Puna ka përfshirë regjistrimin e zotimeve për programet buxhetore të Komunës, raportimin e pozitës financiare të Komunës dhe sigurinë e kontrollit të nënshkrimeve për kërkesat e blerjeve.

4. Shpenzimet

- Gjatë periudhës janë procesuar dhe regjistruar 1,736 lëndë në sistemin SIMFK për shpenzimet komunale.
- Janë skanuar dhe bashkangjitur lëndët në procesin e shpenzimeve, përfshirë regjistrimin e kuponave të shpenzimeve pa urdhër blerje dhe me urdhër blerje (në lidhje me procesin e prokurimit).
- Janë menaxhuar avanset për udhëtime zyrtare dhe procesuar mbylljen e këtyre avanseve në përputhje me procedurat e Thesarit dhe SIMFK.

Përshkrim	Shpenzimi Janar - qershor
633 - ISTOG	7,206,942.66
16017 - ZYRA E KRYETARIT - ISTOG	120,356.76
111 - PAGA DHE SHTESA	62,181.75
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	25,845.01
200 - SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	32,330.00
16097 - AUDITIMI I BRENDSHËM - ISTOG	3,154.44
111 - PAGA DHE SHTESA	3,154.44
16317 - ADMINISTRATA - ISTOG	200,437.45
111 - PAGA DHE SHTESA	156,879.40
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	21,951.71
132 - SHPENZIME KOMUNALE	21,606.34
16517 - ÇËSHTJE GJINORE - ISTOG	16,476.71
111 - PAGA DHE SHTESA	13,376.71
200 - SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	3,100.00
16633 - INSPEKSIONI - ISTOG	66,381.85
111 - PAGA DHE SHTESA	37,600.55
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	28,781.30
16785 - PROKURIMI - ISTOG	19,059.54
111 - PAGA DHE SHTESA	19,059.54
16917 - ZYRA E KUVENDIT KOMUNAL - ISTOG	141,103.80
111 - PAGA DHE SHTESA	129,897.71
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	11,206.09
17517 - BUXHETI - ISTOG	404,481.17
111 - PAGA DHE SHTESA	86,491.44
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	19,228.73
300 - PASURITË JOFINANCIARE	298,761.00
50240 - PROJEKTI ME PARTICIPIM TE KOMUNITETETIT ,MINISTRIVE TE LINJE	161,691.00
55205 - NDERTIMI I RRETHOJES SE VARREZAVE KATOLIKE NE GURRAKOC	40,640.00

55206 - NDERTIMI I RRETHOJES SE SHTEPISE SE KOMUNITETIT TE FSHATIT S	6,430.00
55207 - NDERTIMI I SHTEPISE SE KULTURES NE FSHATIN KOVRAGE	20,000.00
55208 - NDERTIMI I SHTEPISE SE KULTURES NE FSHATIN PRIGODE	25,000.00
55209 - NDERTIMI I SHTEPISE SE KULTURES NE FSHATIN TRUBUHOC	45,000.00
18017 - SHËRBIME PUBLIKE - INFRASTRUKTURA RRUGORE - ISTOG	785,286.58
111 - PAGA DHE SHTESA	109,557.40
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	276,040.27
132 - SHPENZIME KOMUNALE	60,605.64
200 - SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	12,800.00
300 - PASURITË JOFINANCIARE	326,283.27
50361 - NDERTIMI I KANALIZIMIT KALIQAN-ORROBERRDË-STUDENICË-KALIQAN,	20,000.00
50894 - NDËRTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE ISTOG	15,000.00
50896 - NDËRTIMI I NDRIÇIMIT PUBLIK NE TOMOC	15,000.00
53400 - NDERTIMI I KANALIZIMIT NE LUBOZHDË SHALA E KODRES	2,673.00
53404 - NDERTIMI I KANALIZIMIT NË FSHATIN DREJË	15,000.00
54918 - NDERTIMI I INFRASTRUKTURES NË LUMIN QAUSH	50,000.00
54965 - NDERTIMI I MURIT MBROJTES TË MULLIRI NË VRELLË	19,519.27
55950 - Ndertimi i trotuareve në Shushicë të Eperme dhe Shushicë të	64,099.00
55974 - Ndertimi i infrastruktures se varrezave ne fshatin Vrellë (M	15,000.00
55977 - Ndërtimi i kanalizimit në Sinajë	20,000.00
55997 - Ndertimi i kanalizimit në Lluga te Saradranit	19,992.00
56002 - Ndërtimi i kanalizimit në Zabllaq	15,000.00
56122 - Ndërtimi i ndriçimit publik në Kamenicë lagja Metaj dhe Lip	10,000.00
56125 - Ndërtimi i ndriçimit publik në Banjë - Lubovë	30,000.00
56168 - Ndërtimi i kanalizimit në Tomoc bajpasi fi 400	15,000.00
19585 - ZYRA LOKALE E KOMUNITETEVE - ISTOG	301,522.66
111 - PAGA DHE SHTESA	25,408.44

130 - MALLRA DHE SHËRBIME	71,686.72
200 - SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	300.00
300 - PASURITË JOFINANCIARE	204,127.50
54850 - ASFALTIMI I RRUGËS "SARAJEVA DHE ISUF VISOQI" NË DOBRUSHË	164,127.50
55943 - Asfaltimi i rrugës "Bjelopoljska" në Dobrushë	40,000.00
47017 - BUJQËSIA - ISTOG	111,409.06
111 - PAGA DHE SHTESA	23,676.53
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	42,392.53
200 - SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	300.00
300 - PASURITË JOFINANCIARE	45,040.00
54886 - BETONIMI I KANALIT TË UJITJES VIJA E "AHMET AGËS" NË VRELLË	5,040.00
55761 - Ndertimi i rruges malore Uçë-Srope	20,000.00
56136 - Ndertimi i Kanalit te Kuqishtes ne Tomoc	20,000.00
48017 - PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - ISTOG	333,518.69
111 - PAGA DHE SHTESA	25,766.89
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	119,030.90
300 - PASURITË JOFINANCIARE	188,720.90
54923 - NDËRTIMI I RRUGËVE NE GURRAKOC LAGJA "GEGAJ".LAGJA "KABASHI"	37,706.00
54928 - NDËRTIMI I RRUËGVE NË ORROBERDË LAGJA MIRANAJ, MAKSUTAJ, RAB	26,676.00
54943 - NDËRTIMI I RRUGËVE NË ZABLLAQ LAGJAET " DERVISHAJ, MEHMETAJ	89,338.90
55773 - Ndërtimi i rrugëve në Tomoc	20,000.00
55779 - Ndërtimi i rrugës në Llukafë lagja e Kadrive	15,000.00
65085 - SHËRBIMET KADASTRALE - ISTOG	44,945.73
111 - PAGA DHE SHTESA	39,438.12
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	5,507.61
66090 - PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE RREGULLATIV - ISTOG	75,720.02
111 - PAGA DHE SHTESA	20,874.18
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	5,090.80
300 - PASURITË JOFINANCIARE	49,755.04

52308 - DIGJITALIZIMI I ELABORATIT KADASTRAL	29,999.90
54980 - RREGULLIMI I TROTUAREVE NE ZONAT URBANE BANJE, VRELLË, GURRA	407.14
55755 - Ndërtimi i parkut pushues dhe rekreativ në Banjë	19,348.00
73026 - ADMINISTRATA - ISTOG	161,435.63
111 - PAGA DHE SHTESA	12,548.30
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	145,237.33
200 - SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	3,650.00
74000 - SHËRBIMET E KUJDESIT PRIMAR SHËNDETËSOR - ISTOG	834,192.07
111 - PAGA DHE SHTESA	655,841.88
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	94,741.33
132 - SHPENZIME KOMUNALE	18,608.86
300 - PASURITË JOFINANCIARE	65,000.00
55750 - Blerja e automjetit në QKMF - Për vizita shtëpiake	35,000.00
88229 - Paisje Mjeksores	30,000.00
75581 - SHËRBIMET SOCIALE - ISTOG	61,442.26
111 - PAGA DHE SHTESA	49,951.27
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	1,856.19
132 - SHPENZIME KOMUNALE	2,541.30
200 - SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	7,093.50
75582 - SHËRBIMET REZIDENCIALE - ISTOG	113,432.89
111 - PAGA DHE SHTESA	58,233.50
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	36,459.46
132 - SHPENZIME KOMUNALE	3,739.93
300 - PASURITË JOFINANCIARE	15,000.00
56210 - Instalimi i pompave termike për nevojat e Shtëpisë së Komuni	15,000.00
85017 - SHËRBIMET KULTURORE - ISTOG	240,250.76
111 - PAGA DHE SHTESA	42,189.74
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	23,061.02
300 - PASURITË JOFINANCIARE	175,000.00

54784 - NDËRTIMI I SALLËS SE SPORTEVE NË VRELLË - VAZHDIM	135,000.00
54790 - NDËRTIMI I STADIUMIT TË QYTETIT "DEMUSH MAVRAJ" FAZA E IV	40,000.00
92085 - ADMINISTRATA - ISTOG	265,854.86
111 - PAGA DHE SHTESA	38,219.72
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	225,335.14
200 - SUBVENCIONET DHE TRANSFERET	2,300.00
92530 - ARSIMI PARAFILLOR ÇERDHET - ISTOG	13,950.10
111 - PAGA DHE SHTESA	3,950.10
300 - PASURITË JOFINANCIARE	10,000.00
55745 - Punimi i depos në IP "Lulet e Jetës"-Vrellë	10,000.00
92531 - ARSIMI PARAFILLOR - GËZIMI YNË - ISTOG	79,979.98
111 - PAGA DHE SHTESA	69,744.27
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	7,850.19
132 - SHPENZIME KOMUNALE	2,385.52
92532 - ARSIMI PARAFILLOR - LULET E JETËS - VRELLE	42,998.81
111 - PAGA DHE SHTESA	37,446.62
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	3,353.60
132 - SHPENZIME KOMUNALE	2,198.59
92533 - ARSIMI PARAFILLOR - SHPRESA E JONE - BANJË	48,240.64
111 - PAGA DHE SHTESA	44,019.73
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	2,763.51
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,457.40
92534 - ARSIMI PARAFILLOR - ARDHMËRIE JONE-GURRAKOC	24,368.54
111 - PAGA DHE SHTESA	21,189.29
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	2,206.57
132 - SHPENZIME KOMUNALE	972.68
92535 - ARSIMI PARAFILLOR PËLLUMBAT E ARDHMËRISË - RAKOSH	15,235.83
111 - PAGA DHE SHTESA	13,450.71
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	1,108.63

132 - SHPENZIME KOMUNALE	676.49
93480 - ARSIMI FILLOR - ISTOG	110,212.30
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	57,212.30
300 - PASURITË JOFINANCIARE	53,000.00
55718 - Ndërtimi i rrethojës së Poligonit Sportiv në Shushicë	7,000.00
55720 - Ndërtimi i mbulojës së druve në Shfmu "Mehmet Akif"- Shushicë	6,000.00
55731 - Renovimi fasades në shfmu: Bajram Curri:-Istog	40,000.00
93481 - SHKOLLA FILLORE - BAJRAM CURRI - ISTOG	468,711.87
111 - PAGA DHE SHTESA	461,387.43
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	4,344.59
132 - SHPENZIME KOMUNALE	2,979.85
93482 - SHKOLLA FILLORE - HYSNI ZAJMI - ISTOG	270,803.88
111 - PAGA DHE SHTESA	267,845.93
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	1,102.32
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,855.63
93483 - SHKOLLA FILLORE - MARTIN CAMAJ - GURRAKOC - ISTOG	218,104.44
111 - PAGA DHE SHTESA	212,773.69
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	3,666.56
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,664.19
93484 - SHKOLLA FILLORE - TREPCA - BANJE - ISTOG	219,856.51
111 - PAGA DHE SHTESA	215,613.68
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	2,624.18
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,618.65
93485 - SHKOLLA FILLORE - ISMAIL QEMALI-SARADRAN - ISTOG	163,604.87
111 - PAGA DHE SHTESA	160,392.99
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	1,416.20
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,795.68
93486 - SHKOLLA FILLORE - AVNI RRUSTEMI - ZALLC - ISTOG	85,564.12
111 - PAGA DHE SHTESA	83,877.79

130 - MALLRA DHE SHËRBIME	649.00
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,037.33
93487 - SHKOLLA FILLORE - NDER MJEDA - RAKOSH - ISTOG	129,735.60
111 - PAGA DHE SHITESA	125,386.45
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	2,964.00
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,385.15
93488 - SHKOLLA FILLORE - 3 DESHMORET E SHK.SHQIPE-UCE -ISTOG	120,185.65
111 - PAGA DHE SHITESA	118,646.62
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	65.00
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,474.03
93489 - SHKOLLA FILLORE - FAN NOLI-LLUKAVCI BEGUT -ISTOG	134,816.58
111 - PAGA DHE SHITESA	132,818.12
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	853.35
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,145.11
93490 - SHKOLLA FILLORE - ZYMER ZEKA - KALIQAN - ISTOG	74,929.84
111 - PAGA DHE SHITESA	72,334.60
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	1,324.70
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,270.54
93491 - SHKOLLA FILLORE - MEHMET AKIF - SHUSHICE - ISTOG	82,655.33
111 - PAGA DHE SHITESA	80,255.75
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	1,228.31
132 - SHPENZIME KOMUNALE	1,171.27
94680 - ARSIMI I MESEM - ISTOG	40,000.00
300 - PASURITË JOFINANCIARE	40,000.00
55190 - "FASADIMI I OBJEKTIT TË SHKOLLËS MITHAT FRASHËRI" NË GURAKOC	40,000.00
94681 - GJIMNAZI - HAXHI ZEKA - ISTOG	288,607.87
111 - PAGA DHE SHITESA	276,570.79
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	9,025.23

132 - SHPENZIME KOMUNALE	3,011.85
94682 - SHKOLLA E MESME - MITHAT FRASHERI - GURRAKOC	273,916.97
111 - PAGA DIIE SHTESA	269,254.92
130 - MALLRA DHE SHËRBIME	2,029.82
132 - SHPENZIME KOMUNALE	2,632.23
Bilanci i përgjithshëm	7,206,942.66

5. Pasuritë dhe Regjistrimi i Pasurisë

Gjatë periudhës 01.01.2025 deri 30.06.2025 janë kryer këto punë dhe detyra të punës ,të gjitha lëndet të cilat kanë përfunduar Procesimin e pagesave në shumat totale me situacione prej 1,2,3,4,5 dhe 6 situacione janë procesuar. Janë verifikuar dhe janë Procesuar lëndet sipas kodeve ekonomike të shpenzimeve kapitale në SIMFK-FreeBalance deri 30.06.2025.Janë Procesuar lëndet e Projekteve Kapitale që kanë përfunduar dhe kanë qenë për procesim nga Ministrit e linjës për vitin 2025.

Përfundime dhe Sugjerime:

Procesi i menaxhimit të buxhetit dhe shpenzimeve ka funksionuar në përputhje me procedurat dhe kërkesat e parashikuara. Vazhdojnë përpjekjet për rritjen e transparencës dhe efikasitetit në menaxhimin e financave të Komunës, duke siguruar që të hyrat dhe shpenzimet të jenë të balancuara dhe të menaxhuara në mënyrë të përgjegjshme.

Sektori i Financave

Sektori i Financave ka realizuar punët e planifikuara për periudhën 2025, si dhe ka përmbushur detyrat e caktuara nga eprori. Këto përfshijnë trajtimin dhe procesimin e lëndëve financiare, përpunimin e pagave, dhe ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

1. Përpunimi i Lëndëve të Shpenzimeve

- Gjatë vitit 2025 janë pranuar gjithsej **1742 lëndë** për shpenzime nga zyrtarët përkatës. Këto lëndë janë kontrolluar, çertifikuar dhe aprovuar përmes sistemit **FreeBalance**.

- Krahasuar me vitin 2024, ka pasur një ulje të numrit të lëndëve për **44 lëndë** gjatë të njëjtës periudhë.
- Gjatë kontrollës, janë kthyer për kompletim **102 lëndë**, të cilat pas plotësimit janë certifikuar, aprovuar dhe arkivuar.

2. Regjistrimi dhe Arkivimi i Lëndëve

- Të gjitha lëndët janë regjistruar në një program Excel për evidencë dhe janë dorëzuar për arkivim.
- Në protokollin e Drejtoratit janë evidentuar gjithsej **102 shkresa të ndryshme** gjatë vitit 2025.
- Po ashtu, janë lëshuar **23 certifikata të gjendjes ekonomike** për qëllime të ndryshme, përfshirë për nevoja personale, ndihma sociale, dhe dokumenta për jashtë vendit.
- **31 fatura** për taksa komunale janë lëshuar për regjistrimin e automjeteve, ndërsa faturat për taksa të tjera janë lëshuar nga autoritetet e Kosovës.

3. Paga dhe Përpunimi i Listave të Pagave

- Të gjitha ndryshimet për pagat e periudhës **janar-qershor 2025** janë dorëzuar në Ministrinë përkatëse.
- **Listat e pagave** për muajt janar-qershor 2025 janë nënshkruar dhe dorëzuar në Ministri, përfshirë pagat dhe meditjet e këshilltarëve të Asamblesë Komunale.
- Janë kalkuluar dhe dorëzuar gjithashtu pagat për punëtorët e shërbimeve të veçanta.

4. Të Hyrat nga Taksa dhe Ngarkesa Komunale

Të hyrat nga taksat dhe ngarkesat komunale, të inkasuara përmes Arkatës Komunale (pagesat deri në 10 €), janë **37,986.00 €**.

5. Arkivimi dhe Procesimi i Lëndëve të Thesarit

- Zyrtarja për arkivimin e lëndëve të Thesarit ka arkivuar të gjitha lëndët origjinale që janë aprovuar si pagesa, gjithsej **1712 lëndë**.

6. Pranimi dhe Portokollimi i Fakturave

- Zyrtari për pranimin dhe portokollimin e fakturave ka regjistruar gjithsej **1479 fatura**.

7. Avanset dhe Udhëtimet Zyrtare

- Janë hapur dhe mbyllur 3 **avanse petty cash**, me vlerë totale prej **1200 €**.
- Po ashtu, janë hapur dhe mbyllur **41 avanse** për udhëtime zyrtare, me një vlerë totale prej **16,008.00 €**.

RAPORTI I PUNËS PËR 6 MUJORIN E PARË 2025
DREJTORIA PËR EKONOMI, ZHVILLIM DHE BUXHET E FINANCA

8. Raproti i kontrollit buxhetor Tm 2

RAPORTI I KONTROLLIT BUXHETOR PËR TM-2 2025											
Buxheti sipas Kategorive Ekonomike TM2-2025											
Kategorite Ekonomike	Sum of Buxheti Aktual	Sum of Allocated	Sum of Epaalokuar	Sum of Aktual	Sum of Zoti m /Obli gime t në pritj e	Sum of Buxheti Frec Balance	Sum of Suficiti nga Aloki met	% e suficiti nga Aloki met	Ndarjet Buxh etore sipas ligjit 2025	Diferenca në mes të ndarjeve buxhetore ligji 2025 dhe në fund te TM1 2025	% e shpenzimit në raport me aloki me t
	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	B-C	C/ B			
11 PAGA DHE SHTESA	8,616,414.29	4,322,148.37	4,294,265.92	4,277,306.99	-	4,339,107.30	44,841.38	1.04	8,252,494.00	363,920.29	98.96
13 MALIRA DHE SHËRBIME	2,707,359.05	2,629,844.14	77,514.91	1,259,240.20	359,352.83	1,088,766.02	1,370,603.94	52.12	2,684,763.00	22,596.05	47.88
14 SHPENZIME KOMUNALE	310,966.53	310,966.53	-	137,834.26	12,139.32	160,992.95	173,132.27	55.68	310,000.00	966.53	44.32
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	487,274.96	220,889.60	266,385.36	61,873.50	56,743.00	368,658.46	159,016.10	71.99	453,000.00	34,274.96	28.01
30 PASURITË JOFINANCIARE	5,148,666.56	4,723,905.88	424,760.68	1,470,687.71	2,449,943.39	1,228,035.46	3,253,218.17	68.87	4,237,000.00	911,666.56	31.13

TOTALI	17,270,681.39	12,207,754.52	5,062,926.87	7,206,942.66	2,878,178.54	7,185,560.19	5,000,811.86	40.96	15,937,257.00	1,333,424.39	59.04
---------------	----------------------	----------------------	---------------------	---------------------	---------------------	---------------------	---------------------	--------------	----------------------	---------------------	--------------

Buxheti sipas Burimeve të Financimit TM2 - 2025

Burimet e Financimit	Sum of Buxheti Aktual	Sum of Allocated	Sum of E paalokuar	Sum of Aktual	Sum of Zoti m /Obligimet në pritje	Sum of Buxheti Free Balance	Sum of Suficiti nga Alokimet	% e suficit nga Alokimet	Ndarjet Buxhetore sipas ligjit 2025	Diferenca në mes të ndarjeve buxhetore ligji 2025 dhe në fund të TM1 2025	% e shpenzimit në raport me alokimet
	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	B-C	C/B			
10 BUXHETI	14,804,668.69	10,540,402.77	4,264,265.92	6,690,062.51	2,119,268.34	5,995,337.84	3,850,340.26	36.53	14,440,748.40	363,920.29	63.47
21 TË HYRAT VETANAKE	1,496,508.70	697,847.75	798,660.95	387,162.25	68,687.14	1,040,659.31	310,685.50	44.52	1,496,508.70	-	55.48
22 TË HYRAT VETANAKE NGA VITI I KALUAR	950,352.50	950,352.50	-	129,717.90	675,255.56	145,379.04	820,634.60	86.35		950,352.50	13.65
31 GRANTI I DONACIONEVE TË BREND SHME	19,148.32	19,148.32	-	-	14,967.50	4,180.82	19,148.32	100.00		19,148.32	0.00
73 USAID	3.18	3.18	-	-	-	3.18	3.18	100.00		3.18	0.00

TOTALI	17,270,681.39	12,207,754.52	5,062,926.87	7,206,942.66	2,878,178.54	7,185,560.19	5,000,811.86	40.96	15,937,257.10	1,333,424.29	59.04
---------------	----------------------	----------------------	---------------------	---------------------	---------------------	---------------------	---------------------	--------------	----------------------	---------------------	--------------

Buxheti nga Fondi Burimor -10 Grandi Qeveritar TM2 - 2025

	Sum of Buxheti Aktual	Sum of Allocated	Sum of Epaalokuar	Sum of Aktual	Sum of Zoti m /Obli gime t në pritj e	Sum of Buxheti Free Balance	Sum of Suficiti nga Aloki met	% e suficiti nga Aloki met	Ndarjet Buxhetore sipas ligjit 2025	Diferenca në mes të ndarjeve buxhetore ligji 2025 dhe në fund te TM1 2025	% e shpenzimit në raport me alokimet
Kategorite Rkonomike	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	B-C	C/ B			
11 PAGA DHE SHITESA	8,571,414.29	4,307,148.37	4,264,265.92	4,277,306.99	-	4,294,107.30	29,841.38	0.69	8,207,494.00	363,920.29	99.31
13 MALLRA DHE SHËRBIME	2,576,763.00	2,576,763.00	-	1,253,111.59	343,407.69	980,243.72	1,323,651.41	51.37	2,576,763.00	-	48.63
14 SHPENZIME KOMUNALE	310,000.00	310,000.00	-	137,834.26	12,139.32	160,026.42	172,165.74	55.54	310,000.00	-	44.46
30 PASURITË JOFINANCIARE	3,346,491.40	3,346,491.40	-	1,021,809.67	1,763,721.33	560,960.40	2,324,681.73	69.47	3,346,491.40	-	30.53
Totali BF-10 Grati Qeveritar 2023	14,804,668.69	10,540,402.77	4,264,265.92	6,690,062.51	2,119,268.34	5,995,337.84	3,850,340.26	36.53	14,440,748.40	363,920.29	63.47

Buxheti nga Fondi Burimor 21-THV TM2 - 2025											
3	Sum of Buxheti Aktual	Sum of Allocated	Sum of Epaalokuar	Sum of Aktuali	Sum of Zoti m /Obli gime t në pritje	Sum of Buxheti Free Balance	Sum of Suficiti nga Aloki met	% e suficit ng a Al ok im et	Ndarjet Buxhetore sipas ligjit 2025	Diferenca në mes të ndarjeve buxhetore ligji 2025 dhe në fund te TM1 2025	% e shpenzimit në raport me alokimet
Kategorite Rkonomike	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	B-C	C/ B			
11 PAGA DHE SHITESA	45,000.00	15,000.00	30,000.00	-	-	45,000.00	15,000.00	100.00	45,000.00	-	0.00
13 MALLRA DHE SHËRBIME	108,000.00	30,485.09	77,514.91	6,128.61	945.14	100,926.25	24,356.48	79.90	108,000.00	-	20.10
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	453,000.00	186,614.64	266,385.36	61,873.50	46,743.00	344,383.50	124,741.14	66.84	453,000.00	-	33.16
30 PASURITË JOFINANCIARE	890,508.70	465,748.02	424,760.68	319,160.14	20,999.00	550,349.56	146,587.88	31.47	890,508.70	-	68.53
Totali BF 21-THV 2023	1,496,508.70	697,847.75	798,660.95	387,162.25	68,687.14	1,040,659.31	310,685.50	44.52	1,496,508.70	-	55.48

Buxheti nga Fondi Burimor 22 - Bartja e THV - TM2 - 2025

3	Sum of Buxheti Aktual	Sum of Allocated	Sum of E paal oku ar	Sum of Aktuali	Sum of Zoti m /Obli gime t në pritj e	Sum of Buxheti Free Bala nce	Sum of Sufic iti nga Aloki met	% e suf ici tit ng a Al ok im et	% e shpe nzim it në rapo rt me aloki met
Kategorite Rkonomie	A	B	A - B	C	D	A - (C + D)	B-C	C/ B	
13 MALLRA DHE SHËRBIME	22,596.05	22,596.05	-	-	15,000.00	7,596.05	22,596.05	100.00	0.00
14 SHPENZIME KOMUNALE	966.53	966.53	-	-	-	966.53	966.53	100.00	0.00
20 SUBVENCIONE DHE TRANSFERE	34,050.96	34,050.96	-	-	10,000.00	24,050.96	34,050.96	100.00	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	892,738.96	892,738.96	-	129,717.90	650,255.56	112,765.50	763,021.06	85.47	14.53
Totali BF 21-THV 2023	950,352.50	950,352.50	-	129,717.90	675,255.56	145,379.04	820,634.60	86.35	13.65

Buxheti nga Fondi Burimor 31 GRANT I DONAT.TË MBRENDSHËM TM2 -2025									
Përshkrimi	Sum of Buxheti Aktual	Sum of Allocated	Sum of E paal oku ar	Sum of Aktuali	Sum of Zoti m /Obli gime t në pritj e	Sum of Buxheti Free Bala nce	Sum of Sufic iti nga Aloki met	% e suf ici tit ng a Al ok im et	% e shpe nzim it në rapo rt me aloki met

20 SUBVENCIONE	224.0 0	224.0 0	-	-	-	224.0 0	224.0 0	10 0.0 0	0.00
30 PASURITË JOFINANCIARE	18,92 4.32	18,92 4.32	-	-	14,9 67.5 0	3,956 .82	18,92 4.32	10 0.0 0	0.00
Totali BF 31	19,14 8.32	19,14 8.32	-	-	14,9 67.5 0	4,180 .82	19,14 8.32	10 0.0 0	0.00

Buxheti nga Fondi Burimor 73 USAID TM2-2025									
Përshkrimi	Sum of Buxh eti Aktu al	Sum of Alloc ated	Sum of E paal oku ar	Sum of Aktu ali	Sum of Zoti m /Obli gime t në pritj e	Sum of Buxh eti Free Bala nce	Sum of Sufic iti nga Aloki met	% e suf ici tit ng a Al oki met	% e shpe nzim it në rapo rt me aloki met
30 PASURITË JOFINANCIARE	3.18	3.18	0.00	0.00	0.00	3.18	3.18	10 0.0 0	0.00
Totali BF 32	3.18	3.18	0.00	0.00	0.00	3.18	3.18	10 0.0 0	0.00

Përfundime dhe Sugjerime:

Sektori i Financave ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë e tij për vitin 2025 në përputhje me planet e punës dhe kërkesat e përcaktuara. Procesi i përpunimit të lëndëve dhe pagave ka funksionuar me efikasitet dhe transparencë, dhe është treguar një përmirësim në menaxhimin e dokumenteve dhe arkivave. Vazhdohet puna për optimizimin e procesit të inkasimit të të hyrave dhe ofrimit të shërbimeve për qytetarët.

DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

DREJTORATI PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM (DEZH)

1.Hyrje

Ky raport pasqyron aktivitetet, angazhimet dhe punët e kryera nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim (DEZH) gjatë periudhës Janar – Qershor 2025. Objektivi kryesor i DEZH për vitin 2025 ishte ngritja e ndikimit të tij në realizimin e projekteve të filluara dhe planifikimin e investimeve në projekte të reja, si dhe kryerja e punëve të tjera varësisht nga detyrat dhe obligimet e stafit të kësaj Drejtorie. Raporti përmbledh aktivitetet për secilin sektor dhe zyrë që vepron në kuadër të DEZH.

2.Qëllimi

Qëllimi i këtij raporti është të njoftojë anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, anëtarët e Kuvendit Komunal dhe të gjithë drejtorët e drejtorive me realizimin e investimeve të planifikuara, zhvillimin, shpenzimet dhe rezultatet e arritura në raport me buxhetin e aprovuar në fillim të vitit 2025. Këto raporte sigurojnë informacione të rëndësishme për opinionin publik lidhur me performancën fiskale, rezultatet e programeve dhe rrjedhën e parasë së gatshme.

3.Sektori për Ekonomi

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, personeli i sektorit të ekonomisë, në kuadër të Qendrës Komonale të Biznesit, ka realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- **Regjistrimi i bizneseve:** 72 biznese
- **Shuarja e bizneseve:** 9
- **Ndryshimi i bizneseve:** 23
- **Kërkesat për certifikata (duplikat):** 5
- **Informata për bizneset:** 26
- **Vertetimi i bizneseve:** 5
- **Këshillime për regjistrimin e bizneseve:** 152
- **Këshillime për ndryshime në biznes:** 85
- **Këshillime për shuarjen e bizneseve:** 18

Me vendim të MTI-së, regjistrimi i bizneseve bëhet pa pagesë, ndërsa taksat e tjera mbeten të aplikueshme për ndryshime në biznes, shtim aktiviteteve, ndryshimin e logos, etj.

Gjithashtu, është bërë **përcjellja e aktiviteteve ekonomike të bizneseve**, duke mbledhur dhe regjistruar informacionet për aktivitetet e tyre. Puna e sektorit ka përfshirë gjithashtu dërgimin e **shkrimeve zyrtare drejtuar Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim**, si dhe zbatimin e procedurave të tjera administrative.

4. Sektori i Zhvillimit

Sektori për zhvillim ka vazhduar të identifikojë projekte prioritare për propozime dhe ka marrë pjesë në aktivitete zhvillimore rajonale. Takime të rregullta janë mbajtur me AZHR-në dhe Ministrinë për Zhvillim Rajonal për të diskutuar fondet që do të ndahen si grante dhe për të punuar mbi propozimet e projekteve kapitale me prioritet. Po ashtu, janë mbajtur tryeza me organizatat e shoqërisë civile dhe bizneset në Komunën e Istogut për të ofruar mundësi bashkëpunimi me MZHR-në dhe për financimin e aktiviteteve zhvillimore të përbashkëta.

Në bashkëpunim me organizatën "Preda Plus – Wentrepreneur" Projekti Integra ka filluar zbatimin I projektit rajonal dy vjeçar "Të fuqizuar - Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara (PAK), bashkëpunimi dhe zhvillimi rajonal në Ballkanin Perëndimor" që synon të ofrojë mbështetje për zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës.

Po ashtu në kuadër të projektit Integra është mbajtur Forumi 4 ditor për parandalimin e emigrimit të rinjëve nga Kosova, që do të pasoj me organizimin e fushatave vetëdijësuese në muajin Korrik, për të ndikuar në zvogëlimin e këtij fenomeni.

Sektori për Zhvillim ka përgatitur pakon e aplikimit për fazën e tretë të projektit "Reload", I cili financohet nga Bashkimi Evropian (BE) dhe zbatohet nga Programi I Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe ka për qëllim fuqizimi në marrëdhënie veçveçrisht lokale – shoqëri civile – përmes OSHC-ve, përmes partneritetit me komuna, duke ndihmuar rritjen e transparencës së ndarjes së fondeve publike për OSHC-të. Gjatë kësaj periudhe, sektori për zhvillim ka kryer raportimin elektronik të matjes së performancës dhe transparencës komunale për vitin 2024 tek MAPL, për fushën e Zhvillimit Ekonomik.

Gjithashtu, sektori është angazhuar në **komisionet për vlerësimin e ofertave** për projekte kapitale dhe në **komisionet e pranimeve teknike** për punët e kryera në terren.

Përfundimisht, janë proceduar për pagesë të gjitha kërkesat e zotimeve për blerje të drejtuara nga Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim.

48017 PLANIFIKIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK - ISTOG	1,244,330.74	1,217,392.66	26,938.08	206,473.79	822,107.50	215,749.45
11 PAGA DHE SHITESA	55,547.24	28,609.16	26,938.08	25,766.89	0.00	29,780.35
13 MALLRA DHE SHËRBIME	240,000.00	240,000.00	0.00	119,030.90	10,000.00	110,969.10

30 PASURITË JOFINANCIARE	948,783.50	948,783.50	0.00	61,676.00	812,107.50	75,000.00
54919 NDËRTIMI I RRUGËVE NE BANJE, LAGJET E REJA	20,000.00	20,000.00	0.00	0.00	20,000.00	0.00
54925 NDËRTIMI I RRUGËVE NË VRELLË LAGJA "DEMAJ, BLAKAJ, DRESHAJ,	120,000.00	120,000.00	0.00	0.00	120,000.00	0.00
54928 NDËRTIMI I RRUGËVE NË ORROBERDË LAGJA MIRANAJ, MAKSUTAJ, RAB	40,000.00	40,000.00	0.00	26,676.00	13,324.00	0.00
55760 Ndërtimi i rrugës "Liridona", në Dubravë	13,783.50	13,783.50	0.00	0.00	13,783.50	0.00
55773 Ndërtimi i rrugëve në Tomoc	20,000.00	20,000.00	0.00	20,000.00	0.00	0.00
55776 Ndërtimi i rrugës lidhëse nga Rakosh në Zhakovë lagja Imeraj	15,000.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00
55779 Ndërtimi i rrugës në Llukafç lagja e Kadrive	15,000.00	15,000.00	0.00	15,000.00	0.00	0.00
55781 Ndërtimi i rrugëve në Trubohoc lagja Osmanaj, Cetaj dhe Mehm	25,000.00	25,000.00	0.00	0.00	25,000.00	0.00
55784 Ndërtimi i rrugëve në Shushicë Lagja Brahimaj, Sadikaj dhe	20,000.00	20,000.00	0.00	0.00	20,000.00	0.00

55787 Ndërtimi i rrugëve në Cerrcë , lagja Rexhaj, Maxharraj, Hask	60,000.00	60,000.00	0.00	0.00	60,000.00	0.00
55792 Ndërtimi i rrugës "Qendresa " në Tomoc- Llukafë i Begut	25,000.00	25,000.00	0.00	0.00	25,000.00	0.00
55794 Ndërtimi i rrugës në lagjen "Kastrati" në Bajicë	20,000.00	20,000.00	0.00	0.00	20,000.00	0.00
55797 Ndërtimi i rrugëve në Kërrninë lagja Fekaj,Ramaj, Mustafaj	25,000.00	25,000.00	0.00	0.00	25,000.00	0.00
55802 Ndërtimi i rrugëve në Suhogerrllë "Guri i Vogel"	15,000.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00
55804 Ndërtimi i rrugës "Agimi i Lirisë " në Kaliqan dhe Lagja Osm	65,000.00	65,000.00	0.00	0.00	65,000.00	0.00
55811 Ndërtimi i rrugëve në Zallq lagja e Shkolles	20,000.00	20,000.00	0.00	0.00	20,000.00	0.00
55812 Ndërtimi i rrugëve në Studenicë rruga Bekë Bali, Shaban Sadi	70,000.00	70,000.00	0.00	0.00	70,000.00	0.00
55813 Ndërtimi i rrugëve në Saradran Lagja Berishaj, Llugat e Sara	40,000.00	40,000.00	0.00	0.00	40,000.00	0.00
55816 Ndërtimi i rrugëve në Istog të Poshtëm lagjet e reja	15,000.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00

55820 Ndërtimi i rrugës "Rexhep Kajdaj" në Lubozhdë	40,000.00	40,000.00	0.00	0.00	40,000.00	0.00
55832 Ndërtimi i rrugëve në Prigodë, Lagja Gashi Mehaj	15,000.00	15,000.00	0.00	0.00	15,000.00	0.00
55841 Ndërtimi i rrugëve në Uçë	45,000.00	45,000.00	0.00	0.00	45,000.00	0.00
55849 Ndërtimi i rrugëve në Rakosh lagja Haxhijaj, Jahaj dhe Brahim	35,000.00	35,000.00	0.00	0.00	35,000.00	0.00
55907 Ndërtimi i rrugëve ne Gurrakoc lagja Kabashi, Bajramaj	25,000.00	25,000.00	0.00	0.00	0.00	25,000.00
55909 Ndërtimi i rrugës "Djemt e Vrellës" në Vrellë	65,000.00	65,000.00	0.00	0.00	65,000.00	0.00
55913 Ndërtimi i rrugëve përgjatë sheshit "Ibrahim Rugova" dhe lag	50,000.00	50,000.00	0.00	0.00	0.00	50,000.00
56189 Ndërtimi i rrugëve në Lubozhdë lagja Osaj dhe Pepaj	30,000.00	30,000.00	0.00	0.00	30,000.00	0.00

Projektet ne bashkëfinancim me donator dhe ministritë e linjës

1	Ndërtimi i rrugës "Smjal Bicaj" .	457,500.00 €
----------	--	---------------------

2	Ndërtimi i qendrës së Istogut rruga “Ibrahim Rugova”, Fadil Ferati” dhe UÇK .	4,027.982 €
3	Ndërtimi i rrugëve “2 Korriku dhe Liria” .	775,340.98 €
4	Ndërtimi i shtratit të Lumit Istogut dhe Rrugëve në Muzhevinë, Drejë dhe Lubovë	7,800.000.00 €

Përfundime

Sektori për Ekonomi dhe Sektori i Zhvillimit kanë arritur të realizojnë një sërë aktiviteteve dhe angazhimesh që kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e ekonomisë lokale dhe në mbështetje të projekteve zhvillimore. Puna e përbashkët me donatorë dhe organizata të tjera është forcuar, duke mundësuar financimin dhe zbatimin e projekteve kapitale dhe aktiviteteve zhvillimore që do të kontribuojnë në përmirësimin e kushteve ekonomike dhe sociale të komunës.

DREJTORIA PËR KADASTËR, PRONË DHE GJEODEZI RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Me qëllim të ushtrimit të funksioneve të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi, Drejtoria e Kadastrës, Pronës dhe Gjeodezisë është e organizuar në këta sektorë:

1. Sektori për Gjeodezi;
2. Sektori për Kadastër;
3. Sektori për Prona;

Gjatë kësaj kohe të raportimit, në këta sektorë, zyrtarët janë ngarkuar në kryerjen e punëve sipas përshkrimit të vendeve të punës.

Në Drejtorinë për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi për gjatë kësaj periudhe 6-mujore janë trajtuar gjithësejt 1005 Lëndë/Kërkesa të natyrave të ndryshme psh. Bartje e Posedimit-Blerje, Ndarje e Parcelave, Bartje e Posedimit-Dhurim, Bashkim i Parcelave, Bartje e Posedimit-Trashëgimi, Modifikim i Atributeve të Parcelës, Masa të Sigurisë etj.

Në këtë numër të lëndeve/kërkesave nuk janë të përfshira regjistrimi dhe fshirja e hipotekave gjithësejt (67), regjistrimi dhe fshirja e barrave tatimore (5) si dhe historiatet (22).

Poashtu në 6-mujorin e parë kemi vazhduar me shërbime për qytetarë, ku pas një riorganizimi dhe plotësimit të stafin edhe me 3 zyrtar të ri, kemi mundësuar që shërbimet të jenë më efikase dhe të shpejta.

Nga 03.01.2025 deri me 19.06.2025, Drejtoria për Kadastër, Pronë dhe Gjeodezi ka lëshuar rreth 2500 Çertifikata të Pronësisë, 1100 Kopje të Plani si dhe 625 Çertifikata të gjendjes ekonomike.

Gjithashtu kemi zhvilluar rreth 40 Matje-Dalje në Tëren duke ju përgjigjur kërkesave të qytetarëve, Drejtorateve respektive si dhe institucioneve të tjera si p.sh. Policia e Kosovës.

Bashkë me Agjencionin Kadastral të Kosovës, kemi zhvilluar dëgjime publike me qytetarë dhe ka filluar projekti i rindërtimit të kadastrit për 4 zona kadastarle në komunën e Istogut (Gurakoc, Carallukë, Dobrushë dhe Kashicë) projekt ky i cili financohet nga banka botërore përmes Agjencionit Kadastral të Kosovës. Ky projekt është në fazën fillestare të implementimit i cili do të zgjatë deri në muajin shkurt 2026, ku në kuadër të këtij projekti përfshihet fushata e matjeve, rregullimi i parcelave, bartja, aplikimi për legalizim etj.

Gjatë pjesës së parë të vitit 2025 ka vazhduar faza e 3-të e Projektit “Dixhitalizimi i Elaboratit Kadastral”, Projekt ky që ka filluar në vitin 2023 dhe do të përfundoj këtë vit në mënyrë që të arrihet Dixhitalizimi i plotë i Elaboratit Kadastral ku me këtë mundësohet ruajtja në formë elektronike e hartave dhe të dhënave të tjera si dhe marrja e shërbimeve Gjeodezike në formë Dixhitale. Implementimi i tërësishëm i këtij projekti mundëson poashtu ruajtjen në mënyrë të sigurtë të të dhënave Gjeodezike.

Në Sektorin e Pronës gjatë 6-mujorit të parë ka vazhduar trajtimi i Kërkesave për Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës me Pronën Private, ku disa nga këto kërkesa të cilat i kanë plotësuar kushtet ligjore janë proceduar për Kuvend. Poashtu ka vazhduar mbledhja e qerasë nga shfrytëzimi i pronës publike si dhe njoftimi i palëve të cilat nuk janë paraqitur me kohë për ti kryer obligimet e mbetura nga shfrytëzimi i pronës së Komunës.

DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN DHE MJEDIS RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Në Drejtorinë e Planifikimit Urban dhe Mjedis, në gjashmujorin e parë të 2025, kujdes i veçantë si qdo herë është kushtuar përfundimit të lëndëve me prioritet për leje ndërtimi dhe monitorimi i respektimit të afateve ligjore. Pas situatës të krijuar pas pezullimit të nënpunësve civil kjo Drejtori më kërkesë dhe me kohë ka kërkuar nga zyra e personelit zëvendësimin e zyrtarëve të pezulluar me zyrtarët tjerë të cilat do ti përgjigjen qytetarëve me kërkesat e tyre. Kanë vazhduar takimet e shpeshta brenda drejtorisë me zyrtarët e rinjë (të zëvendësuar), duke tentuar që të eliminohen pengesat në shqyrtim të lëndëve. Vonesat në shqyrtim janë evidentuar në lëndët që janë në trajtim, andaj është aprovuar zgjidhje urbane apo Harta Zonale Komunale 2024-2032 që do t’u ndihmojë kërkuarve që të konsultohen për zgjidhje urbane paraprakisht kërkesës për kushte ndërtimore dhe leje ndërtimore. Është punuar në atë që zgjidhjet urbane të sigurojnë qëndrueshmëri të zhvillimit, si proces para kushteve të ndërtimit për ndërtesat e kategorisë I - II.

Gjatë kësaj periudhe janë pranuar përmes QSHQ gjithësej 201 lëndë në të tre departamente. Në departamentin e Planifikimit urban janë regjistruar gjithësej 184 lëndë nga më të ndryshmet. Në sektorin e Legalizimeve lëndë të pranuar janë 31, të shqyrtuar 37 duke përfshirë edhe lëndë nga viti i kaluar në list të pritjes dhe këtë vit kanë plotësuar kriterin për legalizim, 33 lëndë të legalizimit është nxjerr akti administrativ Leje Për Legalizim dhe janë transferuar në regjistrim në zyrën kadastrale në Istog kurse 04 Lëndë të legalizimit kanë kaluar në listë pritjes por është duke vazhduar në përfundimin e lëndëve të vjetra për të dy kategoritë e ndërtimeve kurse në departamentin e Mjedisit janë regjistruar 13 kërkesa të Lejeve Mjedisore Komunale ku 10 prej tyre janë paisur me Leje Mjedisore Komunale kurse 03 janë në shqyrtim.

Sektori i urbanizmit

Gjatë kësaj periudhe janar – qershor të vitit 2025, është evidentuar numër mesatar i kërkesave, andaj dhe intensiteti i punës në këtë sektor ka vazhduar puna normalisht në zgjidhje të lëndëve. Janë evidentuar mbi 201 kërkesa, prej të cilave 73 kërkesa për kushte dhe leje ndërtimi. Janë trajtuar 73 kërkesa nga 121 sa janë pranuar për Kushte dhe Leje ndërtimore. Janë miratuar 46 leje ndërtimi të kategorisë I (parë) dhe II (dytë). Gjatë preudhes Janar-Qërshor 2025 janë lëshur Pelqime dhe Njoftime të ndryshme për 136 kërkesa, dhe të ngjashme. Janë në procesim edhe 15 kërkesa.

Drejtoria realizon të hyra nga taksat për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës dhe nga taksa administrative për leje të ndërtimit, bazuar në “Rregullore mbi taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 2025. Në të hyra kanë ndikuar edhe taksa për Shëndrrimin e tokës bujqësore në atë ndërtimore.

Në këtë periudhë raportuese janë në fazën projektuese këto projekte:

Rregullimi i shtratit të lumit të Istogut, prej burimit të ujit e deri te ura e Hotel Troftes (faza e dytë) me vlerë 110,000.00 eur. Projekt 3 vjeçar

Digjitalizimi i elaboratit kadastral me vlerë 30,000.00 eur,

Ndërtimi i parkut pushues dhe rekreativ në Banjë, me vlerë 80,000.00 eur

Rregullimi i trotuareve në zonat urbane Banjë, Vrellë, Gurrakoc dhe Istog me vlerë 70,000.00 euro

Është vazhduar puna në plotësimin e informatave në sistemin e monitorimit të procedurës për marrjen e lejes së ndërtimit ku paraqiten informatat për qytetarë, si dhe është punuar në informimin e zyrtarëve për lëndët të cilave u ofrohet afati ligjor i shqyrtimit. Në këtë periudhë është ripunuar dokumenti me udhëzues dhe informatorë për qytetarë për procedurën e aplikimit për leje të ndërtimit. Përveç trajtimit të lëndëve, zyrtarët e sektorit kanë qenë të angazhuar edhe me aktivitete të tjera përcjellëse, si mbikëqyrje të projekteve që investohen nga Komuna, si dhe mbikëqyrje të planeve rregulluese në revidim.

Një ndër aktivitetet është vazhdimi dhe mirëmbajtja e rrugëve, i udhëhequr nga DPUM-Istog bashkëpunim me Departamentin e Adresave Prishtinë, punë kjo e përfunduar me rezultat pozitiv.

Duhet theksuar se përmes Zyrës për marrëdhënie me publikun, në mënyrë të organizimit të ngjarjeve të ndryshme brenda drejtorisë, takimet me institucione dhe palë të ndryshme, si dhe prononcime mediatike të cilat kanë të bëjnë me DPUM-në.

Aktivitetet e planifikuara:

Zbatimi i Bazës ligjore për planifikim e ndërtim-shqyrtimit të lëndëve me një dinamikë të pranueshme, duke respektuar afatet ligjore;

Hartimi i dokumenteve me rregullativa që lehtësojnë funksionimin e Sektorit;

Vlerësimi i lëndëve nga Planerët urban, si dhe marrja e vendimeve për lëndët ku ka dilema në zgjidhje;

Përgatitjet që të integrohen të dhënat e lejeve të ndërtimit në Sistemin vrojtues;

Përpunimi i faqes së Komunës sa i përket Drejtorisë;

Përmirësimi i shërbimit të informimit të qytetarëve;

Hartimi i zgjidhjeve urbane dhe prezantimi në drejtori dhe në publik;

Avancimi i sistemit të vrojtimit të lejeve

Informimi i qytetarëve për çfarëdo informate që u intereson sa i përket Urbanizmit;
 Takimet me palë për identifikimin e problemeve, adresimin dhe shqyrtimin e tyre në bazë të legjislacionit në fuqi;
 Identifikimi i pengesave në zbatim të planeve;
 Kryerja e lëndëve në bazë të kërkesave të palëve në afat;
 Mbikëqyrja e kontratave të të gjitha llojeve;
 Finalizimi i rregulloreve të filluara;
 Këshillimi i drejtorit dhe sektorëve tjerë për çështjet e ndërtimit;
 Identifikimi dhe regjistrimi i objekteve – certifikatë përdorimi, të ndërtuara me leje;
 Fushata informuese dhe sensibilizuese;
 Pranimi i aplikacioneve të reja për legalizim;
 Legalizimi i objekteve të dy kategorive;
 Hartimi i përmbajtjes minimale (s qarimi) të dokumentacionit për aplikim për legalizim;
 Hartimi i draftit të parë për Planin lokal të veprimit në mjedis;
 Rritja e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjellja e drurëve, duke përfshirë disa parqe të planifikuara më parë;
 Fushata vetëdijësuese nëpër institucionet shkollore në lidhje me shumë aspekte mjedisore për qëllim vetëdijësi;
 Shtimi i sipërfaqeve gjelbëruese në pjesët e ndryshme të qytetit;
 Mbijellja e drurëve dekorativë;
 Shënimi i aktiviteteve mjedisore, si: 22 Prilli - Dita botërore e Tokës, 5 Dhjetori - Dita Botërore e Mjedisit, si dhe aktivitet rreth organizimit të Javës për ndryshime klimatike, në bashkëpunim me REC dhe MMPHI;
 Një ndër aktivitetet e planifikuara më të rëndësishme për vitin 2025, ka qenë Memorandumi i bashkëpunimit të Agjencionit kadastral për mirëmbajtje të adresave dhe vendosja e shenjave të emërimitin e rrugëve publike në komunën e Istogut dhe Nderlidhja e Adresave Zyrtare me ARC-Agjencionin e Regjistrimit Civil.
 Këtë vit ka qenë e planifikuar që përmes një analize më të thellë të lëndëve, ligjeve në fuqi dhe përmes një pune të palodhshme, të arrihet më shumë në ngritjen profesionale të nëpunësve të Sektorit të shërbimeve të përbashkëta, në mënyrë që të evitohen gabimet e kaluara në përpilimin e vendimeve të këtij organi.

Legalizimi

Me këtë raport ju njoftoj më punën dhe zhvillimet në procesin e legalizimit në DPUM për periudhën Janar –Qershor

Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis në periudhën Janar-Qershor 2025, ka pranuar kërkesa të reja për procesin e legalizimit gjithësej 31 aplikime për legalizim të ndërtimeve të dy kategorive.

Gjatë periudhës Janar-Qershor të vitit 2025 kemi shqyrtuar dhe marrë këto vendime për aplikimet e pranuar:

1. Vendime për Legalizim – 33,
2. Vendime për listë të pritjes – 04,

Sektori i Adresave

Sipas Autorizimit të Kryetarit të Komunës Nr.Br.01-527/022, të datës 25.07.2022 jam autorizuar për kryerjen e detyrave të punës shtesë pa Kompensim të zyrtarit për Regjistrim të Adresave, ku gjatë kësaj periudhe kam pranuar 4 kërkesa për emërtim, ndryshim të emrave të rrugëve, në kuadër të kësaj i kemi paisur me numra të shtëpisë shumë qytetarë të cilët janë paraqitur në zyrën e drejtoratit të urbanizmit.

Sipas vendimeve të kryetarit të komunës gjatë periudhës Janar –Qershor isha pjesë e grypeve punuese si anëtar në hartimin e rregulloreve të brëndshme Komunale dhe anëtar i komisioneve të ndryshme në cilësinë

e anëtarit dhe kryesuesit të komisionit, komisione disa nga të cilat janë me mandat dhe vazhdojnë të jenë aktive edhe për pjesën tjetër të vitit. Preji fillimit të muajit Mars 2023 sipas vendimit të kryetarit të komunës janë sistemuar në Zyrën Ligjore, për të cilën në vazhdimi sipas nevojave hartoj vendime, kontrata dhe marrëveshje të ndryshme.

Mjedisi

- Gjatë gjashtë muajit të vitit 2025 nga Sektori për Mbrojtje të mjedisit janë realizuar këto detyra:

Gjatë këtij gjashtë muajit janë parashtruar 13 kërkesa për tu pajisur me Leje Mjedisore Komunale, janë lëshuar 10 Vendime për LMK të shoqëruar me 10 procesverbale të hartuara në teren. Kurse 3 kërkesa të lejes mjedisore janë në proces.

Kemi përcaktuar të gjitha zonat përgjatë rrugëve dhe trotuareve për mbjelljen e fidanëve duke përfshirë edhe disa nga pronat publike dhe zonat e domosdoshme për gjelbërim.

Takimi më nxënës, bizneseve kanë ndikim në mjedis për ngritjen e Kapaciteteve për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit.

Po ashtu kemi qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, angazhime dhe Punëtori të Ekipeve Komunale AZIIR –Përfundim

Bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Planifikimit Hapësinorë dhe Infrastrukturës ka qenë në nivel për plotësimin e formularëve të ndryshëm dhe ofrimin e të dhënave nga sektori mjedisor duke përfshirë ajrin, ujin dhe token.

Kemi qenë pjesëmarrës në disa Komisione për probleme të natyrës mjedisore, në bashkëpunim me Inspektorët Komunal dhe të Drejtorive Komunale si Drejtorinë për Bujqësi, Drejtorinë për Kulturë Rini dhe Sport dhe atë për Zhvillim Ekonomik, të gjitha këto në bazë të detyrës zyrtare.

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT RAPORTI I PUNËS PËR PERIUdhËN JANAR-QERSHOR 2025

Drejtoria Komunale e Arsimit, kryen detyrat dhe obligimet në përputhje me Ligjin për Arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës nr.04/L-032, Ligjin Për Arsim në Komunitet të Republikës së Kosovës nr.03/L-068, Ligjin për Arsimin dhe aftësimin Profesional nr.04 L-138, Ligjin për Arsimin dhe Aftësimin e të rriturve në Republikën e Kosovës nr. 04/L-143, Ligjin për Edukimin në fëmijërinë e hershme nr.08/L-153, Ligjin Nr.03/L-212 i Punës, Udhëzimin Administrativ Nr.03/2022 për përfshirjen e Fëmijëve në Institucione Parashkollore në Kosovë, Rregulloren (QRK) Nr.19/2024 për procedurat e përzgjedhjes së drejtorëve zëvendsdrejtorëve, mësuesve, bashkëpunëtorëve profesional, asistentëve, instruktorëve dhe sekretarëve në institucionet publike edukativo-arsimore dhe aftësuese të arsimit parauniversitar, si dhe UA të MASHTI-it që përcaktojnë përgjegjësit e Komunës për organizimin e procesit edukativo-arsimor në të gjitha nivelet si dhe aktet tjera komunale dedikuar kësaj fushe.

Drejtoria Komunale e Arsimit në Istog, bazuar në vendimet dhe udhëzimet e Ministrisë së Arsimit , Shkencës ,Teknologjisë dhe Inovacionit ka ndërmarr të gjitha masat që viti shkollor-mësimor 2024/25 të përfundoj sipas normave të përcaktuara .

Viti mësimor 2024/2025, ka filluar me 2 shtator 2024 dhe ka përfunduar (sipas Kalendarit shkollor të MASHTI-it) sipas këtyre datave:

Përfundimi i vitit mësimor për klasë është:

-Klasat e 12-ta -maturantët,me 15 maj 2025,

-klasat e 9-ta ,10-ta dhe 11-ta,me 5 qershor 2025,

-klasët e parafillorës dhe nga 1-8-ta, më 23 qershor 2025.kurse

-Institucionet e parashkollës- kopshteve do ta përfundojnë më 31 korrik 2025.

Organizimi i punës së DKA-së dhe institucioneve arsimore,është udhëhequr dhe menaxhuar nga DKA-ja, drejtorët e shkollave dhe stafi profesional, prindër dhe nxënës, përmes organeve udhëheqëse të shkollës në bashkëpunim të vazhdueshëm me akerët tjerë si MASHTI dhe Inspektoratin e Arsimit pranë Zyrës Rajonale të Arsimit në Pejë,gjithnjë duke respektuar Ligjin e Arsimit parauniversitar si dhe udhëzimet e lartëcekura.

Avansimi profesional i mësimdhënësve gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bazuar në ofertën e MASHTI-it, ofertuesve tjerë dhe në të gjitha rastet është menaxhuar mirë nga DKA-ja dhe adresimi ka qenë aspekti profesional i mësimdhënësve.Për avansimin e tyre profesional janë organizuar këto lloj trajnimesh:

Trajnimi për ngritjen e kapaciteteve për rishikim të teksteve shkollore në arsimin e detyrueshëm (0-9)- IPK

Trajnimi për zbatimin e Kornizës së Kurrikulës së re të Kosovës

Trajnimi “The teacher’s chapter – beyond the classroom”

Trajnimi “Ilap Pas Ilapi”-KEC

Trajnim i zhvilluar nga Kryqi i Kuq për përgatitjen e nxënësve para garave republikane.

Tematika të ndryshme për zhvillimin e kompetencave personale, shëndetin mendor dhe orientimin në karrierë.

Sesione ONLINE të trajnimit nga mësimdhënësit e nivelit fillor në kuadër të marëveshtjes ndërmjet DKA-së dhe SHPIK-KODIMI

Edukatoret të trajnuara gjatë periudhes 2025 kanë këto trajnime:

Bashkëpunimi cilësor në institucionet edukative

Menaxhimi i sjelljeve të fëmijet me autizem në ambientet e shkollës.

Trajnim Vizitat ne shtepi për gratë shtatzëna dhe fëmijet 0.3 vjeç.

Pjesmarrja në Gara

Nxënësit tanë kanë marrë pjesë në gara të ndryshme shkollore, komunale dhe rajonale:

Gara regjionale në volejboll

Garat rajonale të Kryqit të Kuq

Garat republikane të Kryqit të Kuq

Gara komunale në shah

Gara e Robotikës KML Open 2024/2025-Kosova Makers

Gara e Karatesë – Kampionati i Kosovës për grupmoshta 7- U14 dhe Senior-Fedarata e Karatesë

Gara e Gatimit Tradicional dhe Modern – Nxënësit e klasës së dytë me grate dhe burrat e qendres së komunitetit për persona të moshuar pa përkujdesje familjare

Garat komunale në volejboll

Lojëra tradicionale dhe moderne në mes të gjeneratave në Qendrën për persona të moshuar pa përkujdesje familjare

Turneun Tradicional në futboll-kushtuar rënies heroike të deshmorit Demush Mavraj

Aktivitet sportive: garuese me KFOR-in Italian

“Gara për fëmijë” nga ETC

1 Qershori - “Dita e Fëmijëve” aktivitete garuese me nxënësit parafillor , 1-5.

Olimpiada shkollore dhe komunale në matematikë dhe fizikë.

Turneun Ndërkombëtar “Xhevat Makolli”, (KATA dhe LUFTA)

Vlerësimi i brendshëm i shkollës

Është realizuar Vlerësimi i Brendshëm (Vetë-vlerësimi) i shkollave dhe Vlerësimi i Përformancës së mësimdhënësve në përputhje me udhëzimet e MASHTI-t dhe DKA-së.

Në vlerësim janë përfshirë komponentët apo pesë fushat e cilësisë:

Menagjimi dhe qeverisja ,

Kultura dhe mjedisi shkollor

Mësimdhënia, të nxënës dhe vlerësimi

Zhvillimi profesional i mësimdhënësve

Përformanca e nxënësve

Vlerësimi është realizuar nga ekipi i vetë-vlerësimit dhe i Përformancës së mësimdhënësve , i bazuar në dëshmi ku janë identifikuar pikat e forta të shkollës si bashkëpunimi efektiv dhe angazhimi i stafit të shkollës. Janë identifikuar gjithashtu fusha për përmirësim si digjitalizimi dhe zhvillimi profesional i vazhdueshëm i mësimdhënësve.

Drejtoria Komunale e Arsimit bashkë me shkollat është e angazhuar në procesin e parandalimit braktisjes dhe mos regjistrimit të fëmijëve në shkolla.Në secilën shkollë janë të funksionalizuara Ekipa për parandalim dhe braktisje .

Sektori administrativ sipas planifikimit dhe dinamikës së punës për periudhën raportuese ka realizuar e që konsiderohet si me të rëndësishme:

Pranimi ,shqyrtimi dhe vendosja e lëndëve të natyrave të ndryshme që e karakterizojnë drejtoratin e arsimit.
Shpallja e konkursit për ndarjen e bursave Komunale

Janë lëshuar 75 kontrata për studentët përfitues të bursës komunale

Janë lëshuar vendime për pushim të lehonisë

Janë lëshuar vendimeve për pensionim të stafit arsimor

Janë lëshuar vendimi për pagës të mbi normës

Shpalljen e disa konkurseve për pranim të stafit arsimor

Janë lëshuar kontrata të punës për mësimdhënës dhe punëtor teknik të të gjitha niveleve të cilët janë pranuar sipas procedurave të rregullta ligjore.

Shqyrtimi i kërkesave për qasje në dokumente zyrtare.

Shqyrtimi i ankesave të drejtuara këtij drejtorati nga natyrat të ndryshme

Në përfundim të vitin shkollor 2024/25 numri i nxënësve që do të nënshtrohen :

Testit të arritshmërisë janë 513 nxënës i cili do të mbahet me 27 qershor,kurse

Testit të maturës 317 nxënës,i cili do të mbahet me 21 qershor

Projektet kapitale

Drejtoria Komunale e Arsimit me kohë ka bërë Planifikimin e projekteve kapitale per vitin 2025. Projektet e planifikuara janë:

Punimi I depos në IP"Lulet e Jetës"-Vrellë

Renovimi fasades dhe lyerja e klasëve në shfmu:Bajram Curri:-Istog

Renovimi i nujeve sanitare në shkollat Filllore „Hysni Zajmi dhe Trepça

Ndertimi I plemes së druve në shfmu"Mehmet Akif"-Shushicë

Fasadimi i Objektivit të Shkolles Mithat Frasheri në Gurrakoc

Projektet e reja kapitale të cilat janë financuara nga MASHTI-i janë:

-Përfundimi Palestrës sportive në shfmu Martin Camaj-Gurakoc

-Përfundimi i punimeve ne Palestren e shfmu"Hysni Zajmi"-Vrellë

-Rregullimi i infrastruktures se jashtme në shfmu"Fan Noli"-Ilukave i Begut-është duke u punuar.

-Punët në palestrën Sportive në Gjimnazin "Haxhi Zeka"-Istog, kanë rifilluar pas kërkesave të vazhdueshme dërguar Mashti-t.

Ndërsa nga Donacionet:

- 12 Laptop për shfmu "Mehmet Akif"-Shushicë(KFOR-i Italian).
- Lions Club Peja @ Kfori Italian paisje sportive për shfmu "Ismail Qemali"-Saradran
- Lions Club Abetone nga Italia dhe Lions Club Pejë dhuruan veshëmbathje dhe paisje tjera në shfmu "Zymcer Zeka"-Kaliqan
- Shtypëshkronja Smart Point dhuron qanta shkollore së bashku me paisje për nxënësit me gjendje jo të mirë ekonomike në 3 shkolla "Ndre Mjeda"-Rakosh,"Tre Dëshmorët"-Uçë dhe "Mehmet Akif"-Shushicë.

AKTIVITETET ME NXENËS:

- Aktivitet për 21 Mars Dita Ndërkombëtare e Sindromës Down,
 - 2 Prill-Dita Botërore e Autizmit(ligjërata vetëdijesuese nga psikologia e shkollës),
 - Nga Kfori Italian janë mbajtur këto kurse për nxënësit e shkollave të mesme dhe disa filllore
 - Vetëmbrojtja në raste të ndryshme, Siguria në përgjithësi dhe kursi i gjuhës italiane.
 - Vizitë me nxënësit e klasës së IX-të tek IAAP "Mithat Frashëri"-Gurakoc në aktivitetin "Ditët e Dyerve të hapura"
 - Sherbimi Policor i kosovës -dega në Istog ka mbajtur takime me nxënës me temat luftimi i :
 - Bullizmit në shkolla,
 - Dukuritë negative (droga,alkoolietj),shkaqet dhe pasojat e përdorimit të tyre.
- Si dhe takime informuese :
- Vetëdijësimi i nxënësve se si të sillem në komunikacion(është organizuar në të gjitha shkollat gjatë gjysmëvjetorit të dytë),si dhe Tema Ruajtja e trashëgimisë kulturore.

DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT
RAPORTI I PUNËS PËR PËRIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Projektet Kapitale në fushën e infrastrukturës:

Ndërtimi i Stadiumit të Qytetit “Demush Mavraj” faza V – mjetet janë marrë nga përmbaruesi.

Ndërtimi i Sallës së Sporteve në Vrellë – po vazhdojnë punimet sipas kontratës projekt dyvjeçarë ku shumë shpejt pritet të përfundojnë punimet

Ndërtimi i Fushës Ndihmëse të Futbollit në Istog në fazën përgatitore

Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës dhe Parkut në Vrellë në fazën përgatitore

Në Sektorin e Kulturës u realizuan këto aktivitete :

Për nder të Ditës së Pavarësisë së Republikës së Kosovë u mbajt Koncerti festiv për fëmijë “Kosova 17”
12 PRILLI – DITA E DËSHMORËVE TË ISTOGUT program kulturor – artistik (këngë dhe valle popullore)

Mbajtja e koncertit për ditën e fëmijëve 1 qershori aktivitete javore me korin e fëmijëve të Shtëpisë së Kulturës “Adem Jashari” në Istog

Përgaditja e librit tradicional me shkrime të nxënësve të shkollave të komunës sonë, dhe të tre (3) librave të tjera të autorëve të ndryshëm për botim – tenderim.

Nga Sektori i Rinisë dhe Sportit janë këto aktivitete :

Turniri Tradicional në Shah “Tre Dëshmorët e Shkollës Shqipe “

Gara në Hendboll për shkolla fillore për nder të “Tre Dëshmorët e Shkolles Shqipe “

Thirrje publike për Kategorizimi i Klubeve Sportive të Komunës së Istogut

12 PRILLI – DITA E DËSHMORËVE TË ISTOGUT - Aktivitete sportive: Turnir në Ping Pong, Shtëpia e Kulturës “Adem Jashari” – Istog

Mbështetja e Sportit Shkollor për organizimin e garave në mes shkollave të Komunë të Istogut

BIBLIOTEKA E QYTETIT “BREZI I RI”

Gjatë gjysmës së parë të vitit 2025 në bashkëpunim edhe me stafin kolegjial i kemi zbatuar me përpikëmeri të gjitha planet dhe detyrat e hartuara që në fillimvit:

Është bërë anëtarësimi lexuesve në bibliotekë për vitin 2025.

Është bërë sistemimi i tërë materialit bibliotekar, si dhe mirëmbajtja e hapësirës dhe e gjithë materialit posedues.

Kemi pranuar materiale të reja nga donatorë të ndryshëm, është bërë përpunimi i tyre fizik, regjistrimi si dhe sistemimi i tyre.

Kemi vazhduar me përpilimin e listës së materialeve të kërkuara (librave), në bibliotekë për vitin 2025.

Kemi zhvilluar kohë pas kohe biseda me lexues të rinjë, me qëllim stimulimi për lexim. Poashtu i kemi njoftuar lexuesit e rinjë për ruajtjen e librave si dhe kthimin e tyre me kohë të caktuar. Vazhdimisht kemi

qenë përkrah lexuesve për stimulim të vazhdueshëm për lexim,gjithnjë për qëllim të ndërgjegjësimit të tyre.

Për këta gjashtë muaj kemi të regjistruar:

74 lexues pa pagesë

24 lexues me pagesë

3 lexues me asistencë sociale dhe veteran dhe

60 lexues në degën e bibliotekës në Gurrakoc

SEKTORI I MUZIKËS

Puna më korit të fëmijëve – mbi -40.Fëmijë.më këngëtarët e vegjel,dhe puna më valltrë,ku kemi 2 grupe,sipas moshës-gr.parë nga kl.1 deri 5-grupi dytë nga kl.6-deri në kl.9.t pran pallatit të kulturës,,A.Jashari" në Istog –PREGADITJE PËR KONCERTIN e 17.shkurtit.2025. Ku do të shfaq një program më këngë ,valle, dhe recitime, nga fëmijët e sektorit të muzikës,udhëhequr nga Dardan Demaj-Zyrtar për muzikë,dhe udhëheqsi artistik iprogramit.

KONCERTI I 17.shkurtit.2025.nga ora 15.në pallatin e kulturës,,Adem Jashari" për nder të ditës së pavarësisë së Kosovës,udhëhequr nga Dardan Demaj-zyrtar për muzikë dhe udhëheqësi artistik I koncertit. Ushtrime aktive ditore dhe javore për aktivitetet e marsit dhe të prillit. më korin e fëmijëve,dhe grupet tjera.

Ushtrime javore më grupin AKTIVE,për pjesmarrjen në manifertimin –Dita e dëshmorëve të Istogut,që u mbajt më 12.04.2025.në ora 11.Ku sektori I muzikës në qndër të Istogut përfotmoi më një program artistik,udhëhequr nga zyrtari I muzikës dhe udh.art.Dardan Demaj

Puna me korin e fëmijëve – mbi -40.Fëmijë

pran pallatit të kulturës,,A.Jashari" në Istog

Pjesmarrja me femijet e sektorit te muzikes ne ditën e deshmoreve koncert qe u mbajt te permendorja e deshmoreve ne qender.

Ushtrime ditore më grupin e fëmijëve të sektorit të muzikës pran pallatit të kulturës në Istog, sipas orarit:

-grupi i parë para dite nga ora :10 deri në 11 e 30.h dhe

-grupi I dytë pas dite

nga ora: 13 e 30 deri në 15 e 30.h

Mbajtja e koncertit per ditën e femijeve I qershori aktivitete javore më: korin e fëmijëve të pallatit të kulturës,,Adem Jashari" në Istog

Aktivitetet e realizuara në Sektorin Muze – Arkcologji

Mirëmbajtja dhe sistemimi i materialeve – aseteve të Muzcut

Muzeu u pasurua me disa eksponate të reja por me vlere historike, kryesisht të dhuruara nga qytetarë të Komunës së Istogut,

Prezentimi dhe promovimi i aseteve të Muzeut para vizitorëve të shumtë, gjatë periudhës Janar – Dhjetor në Muzeun e qytetit kishte shumë vizita ekipore të shkollave të rajonit, OJQ të ndryshme si dhe vizita individuale

Janë mbajtur një sërë aktiviteteve me fëmijë dhe rini me qëllim të informimit dhe vetëdijësimit të tyre për rëndësinë e ruajtjes së vlerave tona të Trashëgimisë Kulturore gjatë “Javës së Trashëgimisë”, si dhe aktivitete me rastin e shënimit të datave të caktuara historike,

DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL **RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025**

1. Sektori i Bujqësisë

Aktivitetet në periudhën janar- qershor/2025

Bazuar në programin për bujqësi dhe zhvillim rural 2025 të Drejtorisë brenda periudhës raportuese janë zhvilluar takime me organizatat e ndryshëm partnere që fokus kanë bujqësinë, FAO-në, Syri i Vizionit, MBPZHR për koordinim të aktiviteteve dhe të programeve të ndryshme për vitin 2025. Po ashtu gjatë kësaj periudhe kemi pasur një numër të takimeve me palë të ndryshme-fermer – biznese dhe institucione të ndryshme etj. Realizimi i aktiviteteve të ndryshme në drejtorin sektorin e bujqësisë që kanë qenë të planifikuara në programin e punës.

1. Aktivitetet në periudhën, janar- qershor 2025

Në kuadër të DBZHR-së-së nga muaji janar janë realizuar një mori aktiviteteve. Ndër me kryesorët do të paraqiten të specifikuar sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

- Në muajin janar janë përgatitur të gjitha kërkesat dhe lëndët e vitit paraprak ,ku janë dorëzuar për arkivim tek zyrtarja kompetente e arkivës komunale
- Po ashtu jemi përgatitur dhe kanë përfunduar me kohë procedurat për rritje të stafit në drejtori për pagesa direkte (janë pranuar 4 zyrtar të rinj me kontrata për shërbime të veçanta ,përmes ligjit të prokurimit, të cilët janë trajnuar dhe të përgatitur për procedurat e aplikimit dhe digjitalizimit të parcelave dhe kanë punuar në aplikimin e fermerëve për pagesa direkte.
- Janë bërë të gjitha përgatitjet e furnizimit me material shpenzues dhe pajisje teknologjike për mbarëvajtjen e procesit të aplikimit për pagesat direkte
- Janë iniciuar procedurat e zotimit të mjeteve për projektet kapitale
- Pranim dhe përgjigjeje në kërkesa të palëve
- Shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si; këshilla, ekspertiza vërtetimi për fermer, etj
- Vlerësimi i dëmeve të ndryshme , nga fatkeqësitë natyrore dhe tjera etj
- Raportime pran nivelit qendror për aktivitete të ndryshme nga fushëprimtaria e drejtorisë
- Përgatitja e procedurave të prokurimit për investime kapitale dhe kërkesat për shpalljen e tenderëve

2. Lëndët e pranuar dhe zgjidhja e tyre

2.1 Kërkesat drejtuar drejtorisë së bujqësisë

- Gjatë kësaj periudhe raportuese janë pranuar 40 kërkesa të ndryshme të palëve, drejtuar në sektorin e bujqësisë.

Pranuar	Ne proces	Miratu ara	Cedua ra	Refuz uara	Pezull uar	Anulu ar
Kërkesa te rregullta	2	9				2
Aplikime për pagesa direkte-subvencione	0 0	1 2 8 0				0 0
Aplikimi qumsht,majmëri,akuakultur		1 2 8 0				
Vlerësimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore		1 5 0 0				
Totali i lendeve te trajtuara						1 5 3 6. 0 0

- Gjatë fazës se aplikimit te fermerëve për pagesa direktet janë pranuar dhe procedura 1280 aplikacione te specifikuara si me poshtë:

	Sektori		Viti 2025	Sipërf aqja/h a	Nr. i aplikacio neve
	Lavërtari	Grurë sipërfaqe		2,795 .58 ha	605
		Grurë kg		/	/
		Grurë për farë		95.96 ha	3
		Misër		1,707 .62 ha	521
		Thekër		10.97 ha	4

		Elb		61.07 ha	32
		Tërshërë		48.62 ha	27
		Lule dielli		2.14 ha	1
	Perime kulturë	Perime në fushë		115.0 5 ha	28
		Perime në sera		2.25	12
		Asparagu		1.29 ha	1
		Fasule monokult urë		4.54 ha	3
		Kunguj misiri		7.22 ha	13
		Vreshta		14.39 ha	1
	Pemëtari	Pemë		350.1 3 ha	272
		Pemë të imëta		7.28 ha	10
		Material fidanor		35.50 0	1
	Blegtori	Lopë qumësht ore	20 muaj – 12 vjet	4,691 krerë	415
		Mëshjtjerr a	14 – 20 muaj	435 krerë	173
		Qumësht litra	Gjashtëm ujori I	/	
			Gjashtëm ujori II	2,192 .987. 26 litra	88
		Blcë		5.911 koshe re	104
		Dele		7.430 krerë	82
		Dhi		951 krerë	18
		Viça për majmëri	Gjashtëm ujori I		
			Gjashtëm ujori II	575	35

		Dosa		11	2
	Therje të raportuara	Gjedhe-	Gjashtëm ujori I		
			Gjashtëm ujori II	938	2
	Shpeztari	Pula		28.800	3
	Akuakulturë	Peshk	Gjashtëm ujori I	/	
			Gjashtëm ujori II	265,610.28	3
	Bimë mjekësore dhe aromatike	Konvencionale		49.32 ha	13
		Konvertim		0.18 ha	1
	Bujqësi organike	Organike		190.22 ha	10
Totali:		Ara		5,463.83 ha .	
		Qumësht (litra) I+II			
		Akuakulturë (Peshk) I+II			
		Viça për majmëri I+II			
		Therje të raportuara (gjedhe) I+II			

Totali i lëndëve;

- Aplikim për subvencione- kultura bujqësore-kafshë ; 1280 copë
- Aplikim për subvencione, qumësht, majmëri, akuakultur 128 copë
- Kërkesa të palëve përmes arkivit, 40 copë
- Shkresa dhe komunikim me institucione të ndryshme 29 copë
- Vlerësimi i dëmeve nga fatkeqësitë natyrore- 59

Totali i kërkesave të trajtuara ; 1536.00 kërkesa

3. Projektet kapitale

Janë zotuar mjetet për projekte kapitale sipas listës së projekteve dhe kanë filluar procedurat e prokurimit për një pjesë të projekteve;

Janë shpallur tenderi për projektet:

- Mirëmbajtja e rrugëve malore ,
- Betonimi i Kanalit të Ujitjes Baicë-Kashicë

Për projektet kapitale ka pasur ngecje në inicim të procedurës tenderuese për shkak të mungesë së projekteve zbatuesë për shpalljen e procedurave të prokurimit dhe me pastaj anulim të shumicës së projekteve si pasojë e marrjes së mjeteve nga përmbartuesi

DREJTORIA E SHËNDETËSISË

RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Gjatë periudhës Janar-Qeshor të vitit 2025 të tërë puna dhe aktiviteti i Drejtoratit për Shëndetësi ka qenë e drejtuar në përmirësimin dhe në ngritjen e cilësisë së shërbimeve shëndetësore për qytetarët e komunës së Istogut. Rëndësi e veçantë i është kushtuar sidomos zbatimit të reformave në lëmin e Mjekësisë Familjare, përmirësimit të kushteve të punës dhe të infrastrukturës në objektet shëndetësore. Për kundër faktit se jemi duke punuar në hapësira të zvogëluara në QKMF për shkak se objekti i parë i QKMF është rrenuar i tëri dhe ka filluar ndërtimi i objektit të ri të QKMF, dhe shumica e shërbimeve janë bartur në objektin e dytë të QKMF, të gjitha shërbimet janë duke punuar normalisht pa ndërpre duke ofruar shërbime sa më të mira në dobi të qytetarëve. Gjatë kësaj periudhe të raportimit, në bashkpunim me menaxhmentin e QKMF kemi bërë vizita të vazhdueshme në QKMF dhe të gjitha qendrat tjera shëndetësore (QMF dhe AMF), ku jemi njoftuar për së afërmi me kushtet dhe kemi identifikuar problemet dhe nevojat e këtyre njësive. Problemet e identifikuar janë kryesisht të natyrës teknike të mirëmbajtjes së hapsirave dhe parqeve. Pastaj vëmendje i kemi kushtuar edhe shërbimit të diagnostikës (Rentëgenit dhe shërbimit të Laboratorit), kemi bërë furnizime të pa ndërprera me reagenca për nevojat të shërbimit të Laboratorit dhe filma për shërbimin e Rentëgenit. Në shërbimin e radiologjisë kemi angazhuar Radiologun si konsulent i jashtëm, i cili bënë leximin dhe punimin e raportëve për të gjithë ata të cilët i nënshtrohen egzaminimit me Mamografi. Furnizimi me barna dhe material tjetër shpenzues nga lista esenciale i cili realizohet nga Ministria e Shëndetësisë, nuk ka qenë gjithmonë i mjaftueshëm ashtu siq ka qenë planifikimi, prandaj Drejtorati për Shëndetësi për mbulimin e mungesës nga lista esenciale dhe për furnizime me barna jashtë listës esenciale të cilat janë të domosdoshme, ka planifikuar një buxhet prej rreth 130,000.00€. Nga kjo shumë deri me tani janë shpenzuar rreth **50,000.00€**

Sa i përket realizimit të projekteve, në këtë vit kanë qenë të planifikuara dy projekte, **Paisje Mjekësore** për nevojat të shërbimit të Mjekësisë Familjare dhe Shërbimit të Laboratorit në shumë prej 30.000.00€ dhe **Blerja e një automjeti për vizita shtëpiake** në shumë prej 35.000.00€. Mirëpo që të dy projektet kanë dështuar për t'u realizuar për shkak se mjetet e planifikuara për këto dy aktivitete janë marrë nga përmbartësit privat për realizimin e kërkesave që dalin nga Kontrata Kolektive për punëtorët Arsimore.

Gjatë kësaj periudhe, kemi përcjellë për së afërmi punimet të cilat janë duke vazhduar në ndërtimin e QKMF së re, punimet janë duke shkuar mirë dhe nëse vazhdohet të punohet sipas dinamikës së paraparë, atëherë faza e parë e ndërtimit do të përfundojë deri në fund të vitit.

Po ashtu në këtë vit kemi filluar me Ndërtimin e Objektit të ri të QMF në Gjurakoc. Ndërtimi i këtij objekti është mundësuar nga një donatorë nga Katari me ndërmjetësimin e BIK-it. Punimet janë në fazën përfundimtare dhe brenda një periudhe të shkurtër të gjitha punimet do të përfundojnë.

Shqyrtimi i kërkesave - Gjatë kësaj periudhe, këtij drejtorati i janë parashtruar një numër i madh i kërkesave të cilat kanë të bëjnë me kërkesa për ndihmë finaciare për shërim dhe blerje të medikamentëve, këto kërkesa janë në fazën e shqyrtimit dhe për këtë qëllim nga Kategorija Ekonomike Transfere dhe Subvencione kemi planifikuar rreth **25,000.00€**. Po ashtu gjatë kësaj periudhe janë paraqitur edhe një

numër të madhë të kërkesave për kompenzimin e shpenzimeve të karburantëve për personat të cilët janë në Hemo-dializë dhe janë duke u trajtuar në repartin Hemodilektik në Spitalin Regional në Pejë, të cilët janë në gjendje të rëndë shëndetësore dhe si mjet transporti përdorin automjetet private, pastaj për personat të cilët trajtohen me kemio-terapi dhe rrezatim në institutin Onkologjik pranë SHSKUK. Për grupin e parë kemi ndarë nga 57 lit. karburant në muaj ndërsa për grupin e dytë nga 10 lit. karburant për një relacion Istog-Prishtinë dhe anasjelltas. Për këto dy qëllime për periudhën janar-Qershor janë dhënë rreth **7743 litra** karburantë në shumë prej rreth **11,585.50€**.

Edhe në këtë vit kemi vazhduar me aktivitetin “**Përkujdesja Shëndetësore Shtëpiake dhe Ambulator – Home Care 2024**” i cili realizohet me vizita sistematike në shtëpi për personat dhe familjet me nevojë. Implementues i këtij projekti është Operatori i Ekonomik Kosova Med. Përmes këtij projekti kemi

Reperti/Njësia	Nr. i pacientëve	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
Emergjencë		18544	24265
Gjinekologji		423	586
Interno		3026	3913
Këshillimore	641		1271
Kujdesi për Nënë dhe fëmijë		275	
Kujdesi shtëpiak	587		3931
Laborator	3838		116660
Mamografi	73		300
Mjekësi familjare		8588	179795
Pediatri		1575	3663
Rentgen	2010		3927
Stomatologji	1374		3671

realizuar punësimin e 40 punëtorëve kryesisht staf shëndetësorë dhe social. Përmes këtij projekti gjatë kësaj periudhe janë realizuar **587 vizita shtëpiake** dhe **3931 shërbime** duke ju ofruar shërbime të ndryshme mjekësore për njerëzit me nevojë.

Home-Care në Istog ka pasur mbështetje të vazhdueshme nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare, janë siguruar vizitat në teren nga mjekët, për përfituesit e projektit, është bërë sigurimi i medikamentëve esenciale nga barnatoria qendrore e QKMF-së në Istog, sigurimi i gazave, instrumentëve sterile, sigurimi i katetrave , qesëve për stomë etj.

Kujdesi Primarë Shëndetësorë QKMF

Ky raport përmbledh aktivitetet, arritjet dhe sfidat e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Istog për periudhën Janar–Qershor 2025. Si institucion parësor shëndetësor në komunën e Istogut, qëllimi ynë mbetet ofrimi i shërbimeve cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme për të gjithë qytetarët, duke pasur në fokus kujdesin parandalues dhe trajtimin efikas të problemeve shëndetësore. Gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore, ekipi ynë profesional ka punuar me përkushtim për të përmbushur nevojat shëndetësore të popullatës, në përputhje me standardet dhe politikat e përcaktuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe institucionet përkatëse. Ky dokument synon të ofrojë një pasqyrë të qartë dhe të strukturuar të performancës sonë gjatë kësaj periudhe.

NUMRI I VIZITAVE DHE SHËRBIMEVE NË QKMF, QMF DHE AMF E KOMUNËS SË ISTOGUT

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare –ISTOG

Qendra e Mjekësisë Familjare-BANJË

Reparti/Njësia	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
Mjekësi familjare	2016	7139
Stomatologji	213	651

Qendra e Mjekësisë Familjare-VRELLË

Reparti/Njësia	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
Mjekësi familjare	1139	2066
Stomatologji	186	580

Qendra e Mjekësisë Familjare-GURRAKOC

Reparti/Njësia	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
Mjekësi familjare	1494	3107
Stomatologji	99	224

Qendra e Mjekësisë Familjare-RAKOSH

Reparti/Njësia	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
Mjekësi familjare	1339	1208
Stomatologji	91	264

Ambullantat e Mjekësisë Familjare

	Nr.vizitave	Nr. i shërbimeve
AMF-CËRKOLEZ	0	0
AMF-DOBRUSHË	0	501
AMF-KALIQAN	0	639
AMF-SARADRAN	0	1463
AMF-SHUSHICË	0	184
AMF-VERIQ	0	0
AMF-ZALLQ	0	1183

HEMODIALIZA

Gjatë periudhës raportuese, Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare – Istog ka vazhduar të ofrojë **shërbimin e transportit për pacientët e hemodializës** nga komuna e Istogut drejt **Spitalit Rajonal të Pejës**, ku realizohet trajtimi i rregullt hemodialitik.

Lista e pacientëve përditësohet rregullisht dhe transporti organizohet në koordinim të plotë me Spitalin e Pejës dhe Drejtorinë për Shëndetësi.

Nga janari deri në prill kanë qenë 6 pacientë, ndërsa aktualisht janë vetëm 4 pacientë.
Transporti organizohet tri herë në javë (martë, enjte, shtunë)

SHËNDETI MENDOR

Gjatë periudhës raportuese, në kuadër të ofrimit të shërbimeve të kujdesit parësor, QKMF-Istog ka vazhduar të sigurojë **shërbime në fushën e shëndetit mendor** për qytetarët e komunës, në bashkëpunim me institucionet sekondare të kujdesit shëndetësor. Mjeku specialist neuropsikiatër Dr.Nysret Pepaj, nga Qendra e Shëndetit Mendor në Pejë, vjen cdo te dyten javë si konsultant, ku përvec vizitave, stafi I QSHM-Pejë, aplikon edhe ineksjonet Amp.Moditen dhe Amp.Ialadol, medikamente antipsikotike që përdoren kryesisht për trajtimin e çrregullimeve mendore.

VAKSINIMI DHE IMUNIZIMI

Vaksinimi përbën një nga shtyllat kryesore të shërbimeve parandaluese në nivelin parësor të kujdesit shëndetësor. Në Qendrat e Mjekësisë Familjare, ky shërbim ofrohet në mënyrë të organizuar dhe të vazhdueshme, në përputhje me kalendarin e imunizimit dhe udhëzimet e Institutit Kombëtar të Shëndetit Publik.

Qëllimi kryesor është të sigurohet imunizimi i hershëm dhe i plotë i fëmijëve, ndjekja e vaksinimeve rutinë, si dhe ofrimi i vaksinave të rekomanduara për të rriturit dhe grupet e riskuara, siç janë të moshuarit, gratë shtatzëna, personat me sëmundje kronike dhe punonjësit shëndetësorë.

Vaksinimi dhe imunizimi ofrohet në QKMF-Istog dhe në katër QMF-të.

	Numri i vaksinave	Numri i shërbimeve
QKMF-Istog	3642	7284
QMF-Banjë	505	956
QMF-Vrellë	533	1059
QMF-Gurakoc	497	1044
QMF-Rakosh	322	620

Gjatë kësaj për të cilën po raportojmë, janë aplikuar gjithsej:

75-- Serum AntiTetanic -për parandalimin e tetanosit

2-- Serume AntiViperik-aplikohet pas kafshimit nga gjarpinjët

15--Vaksina AntiRabike- për parandalimin e tërbimit (rabies), pas kafshimit nga kafshë të dyshuara për të qenë të infektuara

BARNATORJA

Raporti I furnizimit të barnatores

FURNIZIMI PËR MUAJIN: JANAR-MARS

FURNIZIMI PËR MUAJIN: PRILL-QERSHOR

BARNA	Material Shpenzues
40.90%	56.60%
BARNA	Material Shpenzues
36.50%	70.00%

AKTIVITETET E SHËNUARA PËR PROMOVIM SHËNDETËSOR

Janar, 2025 -Java e Ndërgjegjësimit të kancerit të qafës së mitrës, kemi shenuar me aktivitete dhe ligjerata me stafin dhe grupe të ndryshme të shoqërisë, me qëllim të vetëdijësimit për rëndësinë e prevenimit të hershëm të sëmundjes dhe rëndësinë e vaksinës HPV.

Nr.	Muajt	PACIENTAT	ANALOG INSULINE ME VEPRIM TE SHPEJT (Novorapid)	ANALOG INSULINE ME VEPRIM TE ZGJATUR (Levemir)	ANALOG INSULINE BIFAZIKE ME VEPRIM TE MESEM DHE TE SHPEJTE	INSULINE ME VEPRIM TE SHKURTER insulinë e tretshme (Gensulin R)	INSULINE BIFAZIKE ISOPHANE 25-30/70-75 (insuline e tretshme 25%-30% / insulinë bazale 75%-70%)	INSULINE ME VEPRIM TE NDERMJETEM insulinë isophane (Bazal)
1	Janar	240	276	141	1001			
2	Shkurt	217	260	134	848			
3	Mars	229	271	151	895			
4	Prill	230	274	140	885			
5	Maj	241	263	152	961			
6	Qershor							

Prill, 2025-Java Botërore e Shëndetit, me aktivitete me fëmijet e Kopështit “Gëzimi Ynë” në Istog, ata realizuan vizitë në repartin pediatrik, ku morën këshilla për ruajtjen e shëndetit.

Maj, 2025-Java Evropiane e Imunizimit, e shënuar këtë javë me promovimin e vaksinimit si masë preventive e shumë sëmundjeve dhe vaksinimin e fëmijëve sipas vaksinave të kalendarit të rregullt.

12 Maj, 2025-Dita Botërore e Infermierisë, në qendrën e qytetit ishin ekipi me infermier nga QKMF, të cilët ofruan këshilla shëndetësore, matjen e glikemisë dhe tensionit arterial

31 Maj, 2025-Dita Botërore Pa Duhan, kemi shënuar fushatë vetëdijësuese me nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, shpërndarjen e broshurave informative.

VIZITAT SISTEMATIKE NË SHKOLLAT

Qëllimi i vizitave sistematike në shkollë është të monitorohet dhe përmirësohet mirëqenja fizike dhe mendore e nxënësve, duke kontribuar në zhvillimin e tyre të shëndetshëm. Më konkretisht, vizitat sistematike kanë për qëllim:

1. **Zbulimin e hershëm të problemeve shëndetësore** – identifikohen çrregullime fizike, shqisore (si dëgjimi dhe shikimi), rritja jonormale apo sëmundje kronike.
2. **Monitorimin e rritjes dhe zhvillimit** – mjekët dhe infermierët shikojnë parametrat si pesha, gjatësia, dhe zhvillimi pubertal për të siguruar që fëmijët po rriten normalisht.
3. **Promovimin e shëndetit** – fëmijët dhe prindërit marrin këshilla për ushqyerjen e shëndetshme, higjienën, aktivitetin fizik dhe mënyrën e jetesës pa rreziqe (si duhani, droga, etj.).

4. Edukimi dhe promovimi i shëndetit oral

Gjatë muajit Maj të këtij viti kemi realizuar programin e vizitave sistematike në institucionet shkollore parafillore dhe fillore të mesme të ulët.

Në këtë program këtë vit janë angazhuar 7 specialist të mjekësisë familjare, 3 doktor të mjekësisë, 16 infermier, 5 stomatolog dhe 6 asistentë të stomatologjisë. Ky program është realizuar në koordinim të plotë të drejtoratit për arsim në Komunën e Istogut.

TË HYRAT VETANAKE

Të hyrat vetanake të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) **përfaqësojnë mjetet financiare që institucioni i gjeneron vetë**, përmes ofrimit të disa shërbimeve të pagueshme, përtej financimit të rregullt nga buxheti komunal apo shtetëror.

Gjatë kësaj periudhe për të cilën po raportojmë, nga të hyrat vetanake janë grumbuluar gjithsej **22,572.10€**. Në këtë shumë janë të përfshira

DREJTORIA PËR EMERGJENCA, MBROJTJE DHE SHPËTIM RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

- ❖ Bazuar në Rregulloren Nr. 25/2020 për Vlersimin e Rrezikut kemi filluar me procesin e rivlersimit të rrezikut i cili duhet të kryhet sipas afateve deri në vitin 2026.
- ❖ Plani Operativ Emergjent është miratuar nga Asambleja Komunale porë i njëjti duhet rishikuar pas vlersimit të rrezikut sipas Rregullores Nr.25/2020
- ❖ Plani në rast tërmeti është bërë grumbullimi i shënimeve të bodrumeve të ndërtesave kolektive të cilat në situata emergjente mund të plotësojnë kushtet për strehim kolektive, por levizjet e shpeshta të banorve në disa ndërtesa shumë kështu paraqesin problem për hartimin e planit për strehim dhe evakuim në rast rreziku. Poashtu mos mbulimi i vendit të lirë të zyrtarit për planifikim në kuader të sektorit për Mbrojtje dhe shpëtim shkakton ngecje reale në hartimin e Planit.
Lidhur me hartimin e këtij plani problem në vazhdim paraqet mungesa e akteve nënligjore normative dhe mungesa e hapësirave për strehim, gjegjësisht strehimoreve.
- ❖ Do të ishte mirë që Drejtorati i Administratës së bashku me Drejtorin e Financave të nënshkruajn marrveshje të mirkuptimit në pritje, me klauzulë se kompenzimi për angazhim do të bëhet proporcionalisht me çmimin e tregut në ditën e angazhimit në intervenim.
- ❖ Sektori është përgjigjur kërkesave të Policisë për mirëmbajtje të kamerave në Istog, Osojan dhe Lubozhdë si dhe kërkesave të qytetarëve me shkrim siç janë: lëshimi i certifikatave mbi shërbimin ushtarak, vërtetime në raste të zjarrit në pronë personale, ndihma për dëmet e krijuara etj.
- ❖ Shefi i Sektorit për mbrojtje dhe shpëtim përpos detyrave në kuadër të sektorit është i angazhuar edhe në kuadër të Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi (EVSb-së) si dhe në organizimin e mbledhjeve të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, komisioni për të zhdukur, Shërbimin Sprovues të Kosovës për monitorimin e të denuarve me punë në dobi të përgjithëshme.

Problem të madhë paraqet **komunikimi në raste të fatkeqsive (situata emergjente)**, sistemi i radiolidhjeve nuk funksionon fare. Në si sektor bazuar edhe në përshkrimin e detyrave të punëve kemi qenë të angazhuar në kryerjen e detyrave bazuar në kërkesat e qytetarëve, si dhe kemi kontribuar në hartimin e projekteve të ndryshme nga lista e projekteve të parapara për këtë vit.

Mungesa e kapaciteteve në personel si dhe në teknikë Njësinë Profesionale të Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit paraqet problem me që sipas të dhënave nga Enti Hidrometeorologjik do të kemi një verë me temperatura

të larta pa të reshura atmosferike, e që paraqet rrezik për zjarre fushore dhe malore si dhe kërkesat për furnizim me ujë për amvisni.

Realizimi i numrit të përgjithshëm të intervenimeve, struktura e zjarreve dhe int.tjera Jan-Qersh 2025

	Nr.i përgj. i daljeve	Nr.i zjarreve	Nr. i Teknike	Nr.i shërbimeve	Aksidente rrugore	Vërshime	Të rejsh	Të lënduar			Të vdekur		
								zj.	qyt.	tot	zj.	qyt.	tot
23	9	5	2	0	2	0	0	1	6	7			
r	13	12	0	1	0	0	0	0	0	0			
irt	31	27	1	3	0	0	0	0	0	0			
s	11	8	1	2	0	0	0	0	0	0			
	11	8	0	2	1	0	0	0	0	0			0
hor	19	7	1	10	1	0	0	0	0	0			1
rik													
at													
tor													
r													
tor													
tor													
isejtë	94	67	5	18	4	0	0	1	6	7	0	0	0

Sektori i parandalimit :

Forma tabelare e rasteve të zjarreve për të cilat janë punuar raportet përkatëse dhe është bërë vendshikimi e rastit, 2025

r, data.	Pronari , adresa	Shtëpi / biznes	Obj. percejellëse	Te tjera (ushqim bagëti e dru prod.bujq. vetura), etj.	Shkak i zjarrit.	Dëme
ate : 1.01. 2025 r: 001/ 5	Afrim Ramush Abazaj nga fshati Mojstir dhe Sali Osman Shoshi nga fshati Kashicë		Stane ne bjeshten e Radushes, 2 stane	/	Zjarrvënije	
ate : 1.02. 2025	Enver Halil Dreshaj.		Aneks shtëpije,		Oxhaku i improvizuar,	Orend dhomë

r: 002/ 5	rruga; „Naim Dreshaj”, nr: 18, Vrellë		dhomë verore			kaplue zjarri
ate : 1.02. 2025	Mirsad (Feriz) Kelmendit, rruga Hajriz Metaj Rakosh			Pemishte, fidane kumbullash	Zjarrvënije	Fidar pik t
r: 003/ 5						
ate : 2.03. 2025	Diamant e Bengjamin Shatri ,rruga Deshmorët e Kombit, Tomoc			Livadh I papunuar, dhe pemishte molle	Zjarrë I shkaktuar nga djegëja e mbetjeve; neglizhimi I zjarrit	Fidar
r: 004/ 5						
ate : 1.03. 2025	Polanë, malor- fushorë, pronë e perzier			Fushorë -Malorë	Faktori njeri, Me qellim te pastrimit te livadheve te pakosituar nga viti paraprak	Dëme dhe fa
r: 005/ 5						
ate : 1.03. 2025	Branisllav Simonoviq Llukafe i Thatë			Pemishte Fushorë malorë	Faktori njeri,	Fidan
r: 006/ 5						
ate : 1.03. 2025	Mehdi Osman Brahimaj, fshati Kashicë			Mexhë me masë drunore	Faktori njeri,	Nexhë drunjë
r: 007/ 5						
ate : 1.03. 2025	Nadire Loxhaj Baicë, rruga „Lidhja e Pejës”			Pemishte Zjarrë fushorë	Faktori njeri, ndezje e livadheve te pakositura.	Pemis livadh
r: 008/ 5						
ate : 7.03. 2025	Artan Haxhi Selmanaj rruga Pishat nr; 63. Istog	Shtepi, dhoma e kontrollit,			Deshtim ne instalim, shtepi me instalime Smart.	Instali shtepi
r: 009/ 5						
ate : 5.05. 2025	Granit Pacaj Prekallë, rruga Lidhja e Pejës			Ushqim bagëtiye	Moskujdesi i vet pronarit,	Pastri mbetu
r: 010/ 5						
ate : 5.05. 2025	Shkelzen Sejdijaj , rrugen Ali Fethau në Istog		Objekt percjelles (saunë verore)		Moskujdesi i vet pronarit,	Kamir ndezur qynga kontak masen
r: 011/ 5						

ate : 1.06. 2025 r: 012/ 5	Kosovë Rexhaj			Traktor	Problem me instalimet ne traktor	I tërë 1
ate : 1.06. 2025 r: 013/ 5	Adem (Isa) Hajdaraj e Shushicë e Ulët , rruga Ali Demi nr 79	Shtëpi banimi, një dhomë			Dyshohet te jet shkaktuar nga nje adapter.	Dhom orendi dera d e haps
ate : 1.06. 2025 r: 014/ 5	Fadil Berisha Dobrushë, rruga Lidhja e Pejës			Grunajë, rreth 10 ari	Kabllo e vazhduara per furnizim te pompes ne bunarë	Rreth grurë
ate : 1.06. 2025 r: 015/ 5	Xhevat Ramiz Kelmendit, Dubovë e Vogël, rruga Driloni nr: 37		Objekt përcjellës, garazh dhe dhomë vere		Moskujdesi njerëzor, harres e ndonje mjeti qe ka shkaktuar zjarr dyshohet ne nje poq elektrik, dhe inst I improvizuar	E tërë me gjë dhe or përkat

DREJTORIA PËR PUNË DHE MIRËQENIE SOCIALE
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Gjatë periudhës Janar – Qershor 2025, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka luajtur një rol kyç në përballjen me sfidat sociale që prekin komunitetet tona. Në një kohë kur nevojat sociale janë në rritje, kemi punuar me përkushtim për të ofruar shërbime të qëndrueshme, efikase dhe të orientuara drejt përmirësimit real të jetës së qytetarëve në nevojë.

Ky raport pasqyron punën intensive të ekipit tonë, arritjet konkrete dhe pengesat që kemi hasur gjatë kësaj periudhe, si dhe masat e ndërmarra për të adresuar këto sfida. Synimi ynë është të vazhdojmë të forcojmë kapacitetet dhe të avancojmë strategjitë e mirëqenies sociale, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më solidaritet.

Gjatë periudhës Janar-Qershor, në Drejtorinë e Mirëqenies Sociale të Komunës së Istogut janë pranuar rreth 260 kërkesa me karakter social. Staf i është angazhuar maksimalisht për t'u përgjigjur këtyre kërkesave në mënyrë të drejtë dhe të barabartë, duke u mbështetur në mundësitë që ofron buxheti i disponueshëm.

- Ofrimi i shërbimeve logopedike dhe psikologjike të fëmijëve me nevoja të veçanta dhe sociale
Ofrimi i shërbimeve logopedike , psikologjike dhe sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta është një proces gjithëpërfshirës dhe shumëdimensional që synon mbështetjen e zhvillimit të tyre dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Drejtoria e Mirëqenies Sociale , është përfutur e projektit “ SORI3” , iniciativa kryesore e këtij projekti është dedikimi për të promovuar përfshirjen sociale dhe ekonomike të grupeve të cënueshme . Përfutur kryesor janë: Personat me aftësi të kufizuara, Gratë në situata të vështira ekonomike dhe Sociale dhe Grupet e Margjinalizuara .

- Qendra e qëndrimit ditor për pensionistët në Istog

Qendra e qëndrimit ditor për pensionistët në Istog ofron një hapësirë të dedikuar për të moshuarit, ku organizohen aktivitete të ndryshme sociale, kulturore dhe rekreative. Kjo qendër ka një rëndësi të veçantë për komunitetin, pasi u mundëson pensionistëve të kalojnë kohën në mënyrë aktive, të shoqërohen me njëritjetrit dhe të ndihen të vlerësuar. Aktivitetet e organizuara ndihmojnë në ruajtjen e shëndetit mendor dhe fizik të pjesëmarrësve, duke përmirësuar cilësinë e jetës së tyre.

- Subvencionimi i Shtëpisë së Sigurtë në vlerë prej 4.000 euro.

Femrat që përfutur dhunë në familje strehohen për një periudhë të caktuar në strehimoren në Pejë. Drejtoria e Mirëqenies Sociale siguron subvencion vjetor në vlerë prej 4,000 €, me qëllim mbështetjen dhe sigurimin e kushteve të nevojshme për qëndrimin e tyre.

- Subvencionimi i Familjeve Strehuse

Me qëllim ruajtjen dhe trajtimin adekuat të familjeve strehuse, Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka subvencionuar tre familje strehuse. Këto familje kanë qenë gjithashtu me prioritet në mbështetjen e tjera që kemi ofruar për qytetarët e komunës së Istogut.

- Subvencionimi i nënave vetëushqyese në vlerën prej 200€

Qëllimi kryesor i subvencionimit është përmirësimi i kushteve ekonomike dhe sociale, si dhe fuqizimi i këtyre nënave për t'u përballur më mirë me sfidat e përditshme.

- Realizimi i pagesave të qerasë
Aktualisht, kemi mbi 10 pagesa qeraje për familjet në kushte të rënda ekonomike, duke iu dhënë përparësi femrave që përjetojnë dhunë në familje, në përputhje me Planin Trevjeçar të Banimit Social.

- Shpërndarja e pakove ushqimore
Drejtoria e Mirëqenies Sociale ka shpërndarë rreth 400 pako ushqimore dhe higjienike për familjet që gjenden në kushte të vështira ekonomike, me qëllim mbështetjen e tyre në përballimin e nevojave bazë.

-
- Inspektimet javore në Shtëpinë e të Moshuarve në Gurrakoc.

Një praktikë shumë e rëndësishme për të siguruar cilësinë e kujdesit dhe mirëqenien e rezidentëve janë inspektimet javore në shtëpinë e të moshuarve. Këto inspektime synojnë që të mbikqyrin standartet e shërbimeve, të adresojnë sfidat dhe të promovojnë një mjedis të sigurtë dhe të përshtatshëm për të moshuarit.

- Plan i strategjik për përfshirje Sociale të fëmijëve me aftësi të kufizuara
Aktualisht ndodhemi në fazat përfundimtare të hartimit të Planit Strategjik për Përfshirjen Sociale të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara. Ky plan synon të ofrojë masa konkrete për përfshirjen e barabartë dhe mbështetjen e plotë të kësaj kategorie në jetën shoqërore dhe institucionale.

- Përmirësimi i lëvizshmërisë dhe jetës së përditshme për personat e moshuar
Në kuadër të përkushtimit për kujdesin dhe përfshirjen sociale të personave të moshuar, kemi ndërmarrë iniciativa konkrete për përmirësimin e cilësisë së jetës së tyre. Gjatë kësaj periudhe, kemi furnizuar disa qytetarë të moshuar me karroca elektrike, duke u mundësuar atyre lëvizshmëri më të lehtë dhe më të pavarur. Po ashtu, janë shpërndarë edhe veshmbathje të nevojshme, si pjesë e mbështetjes së drejtpërdrejtë për ta. Këto veprime janë realizuar në bashkëpunim me donatorë dhe përmes planifikimit të kujdesshëm të burimeve të Drejtorisë për Mirëqenie Sociale. e të Moshuarve në Gurrakoc.

QENDRA PËR PUNË SOCIALE – ISTOG

Raporti Gjashtëmuor Janar - Qershor 2025 të Ekipit për të Drejtat e Fëmijës

1.1 Në kuadër të shërbimeve sociale Qendra për Punë Sociale ofron shërbime të ndryshme për kategoritë si në vijim:

- Fëmijë i braktisur
- Fëmijë jetim
- Fëmijët e prindërve të privuar nga e drejta prindore
- Fëmijët me aftësi të kufizuara
- Fëmijët e prindërve të shkurorëzuar apo të ndarë
- Fëmijët e keqtrajtuar
- Fëmijët në punë
- Martesa e të miturve
- Fëmijët me sjellje asociale
- Delikuentë të mitur
- Përdorues të substancave narkotike
- Trafikimi i qenieve njerzore

- Dhuna në familje
- Regjistrim i mëvonshëm i fëmijëve

Në kuadër të Qendrës për Punë Sociale bëhen shërbime për të gjitha kategoritë e fëmijëve të cilat i kanë nevojat e ndryshme sipas kategorive të ndryshme.

Puna fillon me identifikimin e nevojave të fëmijëve e gjithmonë nëse fëmija kanë familje, në bashkëpunim me familjet e tyre si dhe me institucionet tjera të cilat punojnë me fëmijë.

Pas identifikimit të nevojave punohet me plotësimin e tyre me shërbimet e ndryshme të cilat ofrohen tek ne si, strehimi i fëmijëve, adoptimi, regjistrimi i tyre, kujdestaria, mbikqyrja dhe realizimi i kontaktimeve në mes fëmijëve dhe prindërve, përfaqësimi në Gjykatë, këshillimi psikosocial, këshillimi ligjor, ofrimi i ndihmave sociale si dhe ndihmave emergjente, etj dhe gjitha këto shërbime për interesin më të mirë të fëmijës.

1.2 Komuna e Istogut fatmirsisht i ka përmbushur standardet minimale dhe ka arritur të ketë gjithsej 3 familje strehuese të cilat që të trija për momentin kanë 11 fëmijë të strehuar. Gjatë këtij gjashtëmujori nuk kemi pasur asnjë fëmijë të braktisur. Në vazhdimësi kemi realizuar vizita në familje për të monitoruar kujdesin që i'u ofrohet fëmijëve të strehuar aty.

Për nder të ditës së Familjes kemi vizituar familjet me që rast iu kemi dërguar nga një pako ushqimore në shenjë përkrahje si dhe është mbajtur Tryeza në bashkëpunim me Drejtorinë e Mirëqenies Sociale, Drejtorinë e Administratës Publike - Sektorin e Barazisë Gjinore dhe Familjet Strehuese.

Nga Komuna e Istogut, familjet strehuese kanë përkrahje të vazhdueshme në formë të ndryshme.

1.3 Në muajin Mars, nga Shkolla Fillore "Bajram Curri" jemi informuar për 8 raste të braktisjes së shkollës. Si organ i Kujdestarisë, jemi marrë me rastin dhe kemi vizituar familjet e fëmijëve të cilët kanë braktisur shkollën për arsye të ndryshme e kryesisht nga gjendja e dobët ekonomike.

1.4 Nga Gjykata kemi pranuar 29 raste të mitur delikuentë, të përfshirë në Kundërvajtje në komunikacion, për të cilët Gjykata nga ne kërkon që t'i realizojmë raportin social. Ne ju jemi përgjigjur pozitivisht kërkesave të pranura duke realizuar takimet me të miturit dhe prindërit e tyre dhe i kemi dorëzuar Raportet Sociale në Gjykatë.

1.5 Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2025 kemi qenë të pranishëm në 21 raste tek të miturit me sjellje asociale gjatë marrjes në pyetje në Stacion Policor të cilëve i'u ofrojmë këshillim psiko-social.

1.6 Në periudhën Janar-Qeshor kemi pranuar 10 raste të reja të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara. Kemi realizuar gjithsej 64 vizita tek të gjitha familjet e fëmijëve të cilët janë përfitues të Ndihmës Materiale për Familjet me Fëmijë me Aftësi të Kufizuar të Përhershme.

1.7 Kemi proceduar me rastin e dy fëmijëve të paregjistruar ku kemi realizuar vizitë në Shërbimin Sprovues Korrektues në Dubravë tek babai i fëmijëve për të marrë deklaratë lidhur me pranimin e atësisë.

1.8 Në Qendrën për Punë Sociale kemi 9 fëmijë të cilët realizojnë kontaktimet me prindin me të cilin nuk jetojnë në bazë

Shërbimet Sociale

RAPORTI GJASHTËMUJOR 2025 NË SHËRBIMET SOCIALE

Institucioni i Qendrës për Punë Sociale në kuadër të Drejtoratit për Mirëqenie Sociale të Komunës së Istogut, gjegjësisht sektori i Shërbimeve Sociale ka ofruar shërbime për qytetarë të kategorive të ndryshme, drejtëpërdrejtë si dhe me aktivitete të shumta duke bashkëpunuar me zingjirin e institucioneve, të cilat e kanë objektiv mirëqenien e fëmijëve, të rriturve si dhe të moshuarve.

Pergjatë gjashtë mujorit të parë të vitit 2025 llojet e shërbimeve që janë ofruar nga sektori i Shërbimeve Sociale janë të shumta dhe ne gjithmonë jemi në dispozicion, duke përfshirë edhe Organin e Kujdestarisë i cili është 24 orë nën shërbimin e qytetarëve në nevojë.

Në tabelën në vijim janë të paraqitura shërbimet dhe numri total për secilën nga to si dhe përshkrimi i Shërbimeve të ofruara.

	Lloji i shërbimit	Numri i rasteve	Përshkrimi i Shërbimeve të ofruara në sektorin e Shërbimeve Sociale
1	Fëmijë të braktisur	0	<i>Përcaktimi i kujdestarit ligjor, vendosja në strehim familjar, ndihmat e përgjithshme për familjet strehuese dhe për fëmijet.</i>
2	Adoptim	0	<i>Adoptimi është një aspekt i mbrojtjes së fëmijës, vlerësimi i familjës për adoptim dhe monitorimi fazës paraadoptuese.</i>
3	Keqtrajtim i fëmijës	0	<i>Keshillim psiko-social me familje</i>
4	Strehim familjar tek familja strehuese	4	<i>Ofrimi i strehimit fëmijëve të braktisur dhe të lënë pas dore dhe percjellja e trajtimit të fëmijëve në familje strehuese.</i>
5	Strehim familjar tek të afërmit	6	<i>Ofrim i strehimit tek familja e gjerë dhe percjellja e zhvillimit dhe trajtimit të tyre.</i>

6	Kujdestaria për të mitur	5	<i>Fëmija pa kujdes prindëror duhet të ketë një kujdestar ligjor.</i>
7	Fëmijë me aftësi të kufizuar të plotë (FAKP)	9	<i>Kompletimi i dokumentacionit, pas vleresimit të komisionit mjekësor percjelllet mundësimi i marrjes së pagesës përkatëse si dhe monitorimi i Qendrës Ditore për FAKP dhe udhëzimet e nevojshme.</i>
8	Braktisje e shkollës	8	<i>Bashkëpunimi me shkolla, me prindër me fëmijë si dhe këshillime për të gjitha keto në interes me të mirë të fëmijëve.</i>
9	Fëmijë me vështirësi në sjellje	0	<i>Këshillime psiko-sociale, të miturit gjithashtu.</i>
10	Të miturit në konflikt me ligjin	29	<i>Këshillim dhe ofrim i shërbimit përkatës për referim në institucionet relevante.</i>
11	Martesa e të miturëve	0	<i>Vlerësimi i pjekurisë emocionale të të miturëve të cilët dëshirojnë të hyjnë në martesë si dhe referimi në institucionet tjera.</i>
12	Ikje nga shtëpia	0	<i>Këshillim psiko-social dhe bashkim familjar dhe përcjellja e zhvillimit të përgjithshëm të të miturit.</i>
13	Këshilla martesore	2	<i>Organizimi i seancave të pajtimit të bashkeshortëve me objektiv të pajtimit të tyre.</i>
14	Besimi i fëmijës	5	<i>Besimi i fëmijëve bëhet pasi pajtimi bashkëshortor nuk është arritur dhe vlerësohet lidhja e fëmijës me prindin si dhe kujdesi i prindit ndaj</i>

			<i>fëmijës. Vizita në terren me qëllim të identifikimit të kushteve ekonomike dhe sociale të dy prindërve dhe të përcaktohet cili është interesi më i mirë i fëmijës dhe të jepet mendimi me cilin prind fëmiu ambientohet me mirë.</i>
15	Kontakttime	9	<i>Me vendim të gjykatës ku specifikohet që kontaktimi të mbahet në lokalet e QPS- së, ne i percjellim që keto kontaktime të realizohen në rrethana sa me të mira.</i>
16	Pjesëmarrja gjatë intervistimit në polici	23	<i>Ne si Organ i Kujdestarisë jemi të obliguar që t'i mbrojmë interesat e fëmijës gjatë intervisimit të tyre në polici. Gjithashtu gjatë intervistimit të viktimave të dhunës, ne marrim pjesë për mbeshtetje dhe këshillim të viktimës për me tutje.</i>
17	Viktimat e dhunës ne familje	19	<i>Pasi jemi njoftuar me viktimën i ndërmarrim hapat si ne vijim: vendosja në strehimore (sipas nevojës), pjesëmarrja gjatë marrjes së rrobave në shtëpi me shoqerimin e policisë, organizojmë bashkimin e nënës me fëmijën në rast se fëmija ka mbetur i ndarë nga nëna, këshillim psiko- social, ofrojmë pagesë për banim social të viktimave të dhunës, i ndihmojmë rreth punësimit të viktimës, i</i>

			<i>ndihmojmë rreth perfshirjes së fëmijëve në institucionet parashkollore, si dhe ofrimi i pakove ushqimore.</i>
18	Konflikt familjar	2	<i>Këshillim psikosocial për zgjidhje të konflikteve mes antarëve të familjes.</i>
19	Ngacmim seksual	0	<i>Prezenca në seanca gjyqësore dhe këshillim si dhe percjellja e viktimës.</i>
20	Caktim i kujdestarit të përkohshëm	0	<i>Për nevojat gjyqësore me intervistimin e antarëve të familjes caktohet një kujdestar.</i>
21	Person me problem të shëndetit mendor	0	<i>Ndihmë e përgjithshme për klientin si dhe vendosja në strehim rezidencial.</i>
22	Strehim rezidencial	1	<i>Kompletimi i dokumentacionit të nevojshëm dhe sipas pranimi të antarëve të komisionit të rregullorës bazë, vizitat e rregullta në shtëpi.</i>
23	Vërtetim për zotësi të veprimit	168	<i>Në hazë të dëshmive të siguruar nga Gjykata. Ne i lëshojmë vërtetimin që nuk i'u ka marrë zotësia e veprimit për armëmbajtje.</i>

24	Konstatim për lirim nga shtetësia	2	<i>Ne bazë të dokumentacionit që posedon QPS, e që nuk ka të caktuar alimentacion për fëmijët e tij e lëshojmë vërtetimin për lirim nga shtetësia.</i>
25	Konstatim për marrje të shtetësisë	6	<i>Në bazë të deklaratës nën betim që ka mjete të mjaftueshme për jetesë në Kosovë dhe nuk do të bëhet barrë e sistemit social të shtetit dhe argumentimi i vendbanimit përmes faturës së rrymës. Ne i lëshojmë vërtetimin për fitim ose rifitim të shtetësisë.</i>
26	Qertifikatë për punësim	20	<i>Në bazë të dëshmive të siguruar nga Gjykata. Ne i lëshojmë vërtetimin që nuk i'u ka marrë zotësia e veprimit për punësim.</i>
27	Konstatime të ndryshme	7	<i>Qendra për punë Sociale sipas nevojave të ndryshme lëshon edhe konstatime të ndryshme.</i>

	Aktivitetet/aktivnosti	Kategoria I-rë	Kategoria II-të	Gjithsejt / Okup.
APLIKIMI APLIKACIJA	1. Nr. i rast. qe kane aplik. për herë të parë Br. Aplik. koji su apli ko.po prvi put	8	6	14
	Sa prej tyre janë të aprovuara Koliko od njih je odobreno	0	2	2
	Numri i landve te cilat jane ne shqyrtim	0	—	0

	Sa prej tyre janë të refuzuara Koliko od njih je odbijeno	0	1	1
RIAPLIKIMI RIAPLIKACIJA	2. Nr. i rast. të larguara për mos ri-aplikim Br. prdmeta deregistrovani zato sto nisu re-aplikovali	-	-	-
	Nr. i rasteve që kanë ri-aplikuar Br. predmeta koji su re-aplikovali	115	137	252
	Nr. i rasteve të larguar për mungesë të dokumentacionit Koliko od njih je derigistrovano zbog ne kompletiranja dokumentacije	0	0	0
VERIFIKIMI VERIFIKACIJE	3. Numri total i familjeve të verifikuara/riverifikuara Ukupan br. porodica verifik./riverifikov.	115	137	252
	3.1 Sa prej tyre janë aprovuar Koliko od njih je usvojeno.	112	137	252
	3.2 Sa prej tyre janë refuzuar/çregjistruar Kol.od njih je odbijeno/derigistrovano	6	4	10

KOM . MJEKSOR DOK . KOMISIA	4. Nr. i rasteve të dërg.në Komis.Mjek.(KM) Broj predmeta poslatih na Lekarsku Komisiju(LK)	71	51	122
	4.1 Numri i rasteve të aprovuara nga KM Broj predmeta odobrenih od LK	71	51	122
	4.2 Numri i rasteve të refuzuara nga KM Broj predmeta odbijenih od LK	0	-	0
	4.3 Nr. i rasteve të kthjera nga KM për kompletim dokumentacioni Broj predmeta vracenih od LK za kompletiranje Dokumentacije	5	-	5
ANKESAT ZALBE	5. Nr. i ankesave të paraqitura nga shfrytëzuesit Broj zalbi podneti od korisnika	—	—	—
	a) Në shkallë të parë (I) Na prvi stepen (I)	—	—	—
	b) Në shkallë të dytë (II) Na drugi stepen (II)	—	—	—
	5.1 Nr. i ankesave të aprovuara Broj odobrenih zalbi	—	—	—
	5.2 Nr. i ankesave të refuzuara Broj odbijenih zalbi	—	—	—
	5.3 Nr. i ankesave në shqyrtim Broj zalbi u procesu resavanja	—	—	—
	5.4 Kontestet në Gjykata Sudski sporovi	—	—	—
	a) Konteste të pranuar Odobreni sporovi	—	—	—

	b) Konteste të refuzuara	—	—	—
	Odbijeni sporovi			

- Vërtetime49
- Vërtetimet për nevoja personale.....10
- Vërtetimet për marrjen e shtetësisë Kosovare.....35
- Marrje e fletëinformacionit për ndihmë sociale.....104
- Kartela të lëshuara për familjet shfrytëzuese të SNS-së.....156
- Vizitë rutinore tek rastet sociale.....157
- Rastet e larguara nga krasimi përmes ATK.....6
- Raste që kanë aplikuar përmes pilotimit në QPS.....0
- Gjithsej raste aktive360
- Vizita në teren18

Projekti për Reformën e Sistemit të Asistencës Sociale

- Vlen të theksohet se nga data 20.05.2024 kemi filluar me pilotimin e SAS-it, i cili është projekt testimi i një modeli të ri për ofrimin e asistencës sociale, ku nga ky projekt mund të përfitojnë familjet e varfra dhe në kushte të rënda ekonomike, si vazhdimësi e skemës sociale egzistuese, por me dallimin që është pa kritere diskriminuese. Ky është projekt qeveritar i përkrahur nga Banka Botërore.
- Nga data 14.08.2024 kemi pranuar listen e parë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 41 familjet sipas listes së dhënë.
- Me datë 05.11.2024 kemi pranuar listën e përfituesve të listës së parë ku gjithsej janë 36 përfitues.

- Me datë 18.09.2024 kemi pranuar listën e dytë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 76 familjet sipas listes së dhënë.
- Me datë 11.11.2024 kemi pranuar listën e tretë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin dhe kemi realizuar vizitat te 85 familjet sipas listes së dhënë.
- Me datë 13.01.2025 kemi pranuar listën e katërt në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin , e cila ka permbajtur gjithsej 83 familje të cilat i kemi verifikuar.
- Me datë 27.05.2025 kemi pranuar listën e pestë në Qendren për Punë Sociale nga Ministria e Financave për SAS Pilotimin , e cila ka permbajtur gjithsej 29 familje të cilat i kemi verifikuar.
- **Gjithsej përfitues nga SAS- Pilotimi janë 97 familje.**

Ky proces na ka ndihmuar në rritjen e transparencës në përzgjedhjen e përfituesve, standartizimin e vlerësimit të nevojave sociale dhe testimin praktik të funksionalitetit të sistemit SAS- Pilotimit në terren. Gjatë kësaj periudhe gjashtë mujore kemi realizuar të gjitha verifikimet në terren sipas afateve të përcaktuara dhe kemi siguruar transparencë në vlerësimin e përfituesve.

Jemi të përgatitur dhe të angazhuar për të vijuar me fazat e ardhshme të këtij projekti, në pritje të udhëzimeve të mëtejme nga insitucionet përkatëse, dhe për të kontribuar në përmirësimin e mëtejshëm të skemës së asistencës sociale në përputhje me standardet e reja.

DREJTORIA PËR SHËRBIME PUBLIKE
RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Në kuadër të Drejtoratit për Shërbime Publike, gjatë periudhës Janar-Qershor-2025 nga ana e palëve gjegjësisht nga qytetarët janë parashtruar kërkesa të ndryshme:

Gjithësejtë 446 kërkesa e nga të cilat deri në këtë periudhë janë :

- | | |
|----------------|-----|
| • Të miratuara | 209 |
| • Të refuzuara | 20 |
| • Anuluar | 7 |
| • Në Proces | 210 |

Kërkesat e parashtruara nga palët, gjegjësisht qytetarët janë të natyrave të ndryshme dhe atë:

Kërkesa për furnizim me gypa të ujësjellësit dhe kanalizimit,
Kërkesa nga lëmia e komunikacionit (transport, sinjalizim),
Kërkesa për furnizim me Zhavor për rrugët lokale të pa asfaltuara,
Kërkesë për prerje Asfalti,
Kërkesa për shpenzime të varrimit,
Licencë Auto-Taxi, etj.

SEKTORI I SHËRBIMEVE PUBLIKE:

Gjatë kësaj periudhe bazuar në kërkesat e qytetareve kemi dalë në teren duke shqyrtuar dhe analizuar të gjitha rastet varësisht prej mundësive buxhetore ju kemi dalë në ndihmë duke u bazuar edhe në kontratat e aktiviteteve të ndryshme të cilat përbushin edhe kërkesat e qytetareve qofshin ato furnizim me zhavorr, furnizim me gypa të ujësjellësit dhe kanalizimit etj. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe gjashtëmujore është përgatitur dokumentacioni me kohë për shpalljen të tenderëve të paraparë në planin buxhetor,

Deri me tani **janë në proces të realizimit këto projekte:**

- Mirëmbajtja dhe sanimi i pushtave,
- Mirëmbajtja e ndriçimit publik,
- Blerja dhe furnizimi me gypa të kanalizimit dhe ujësjellësit,
- Riparimi i rrugëve lokale të rendit të IV-të dhe sanimi i gjendjes nga vërshimet,
- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale të asfaltuara,
- Mirëmbajtja e Parkut të qytetit
- Ndërtimi i Kanalizimit në Kalëqan-Orroberdë-Studenicë-Faza e tretë
- Ndërtimi i murit mbrojtës të mulliri në Vrellë
- Ndërtimi i kanalizimit në Lluga të Saradranit
- Ndërtimi i Tregut të ri në Istog
- Ndërtimi i Trotuarit në Shushicë të Epërme dhe Shushicë të Poshtme

Ndërsa në procedura te tenderimit dhe vlerësimit janë këto projekte:

- Ndërtimi i kanalizimit në rrugën Ilaki I loti në Dubravë
- Ndërtimi i kanalizimit në Istog të Poshtëm në lagjen Hul Huli
- Ndërtimi i kanalizimit në Lluga Lagja Balaj, Ibërdemaj dhe Blakaj
- Ndërtimi i kanalizimit në Cerkoz, lagja Sadrijaj dhe Balaj
- Ndërtimi i kanalizimit në lagjet Arifaj, Zekaj dhe Bardhecaj
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Kovragë
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Shushicë
- Ndërtimi i ndriçimit publik në Kaliqan
- Ndërtimi i urave në Komunën e Istogut
- Ndërtimi i Trotuarit në Istog të Poshtëm
- Furnizimi me gypa të ujësjellsit dhe kanalizimit- projekt 2 vjeçar

Po ashtu në aspektin profesional në sektor kemi qenë të kyçur në kryerjen e shumë projekteve-paramasa dhe parallogarit, gjithashtu kemi qenë të kyçur në komisione për vlerësimin e tenderëve tjerë, mbikëqyrje të projekteve të ndryshme dhe në verifikime të punimeve për projekte të ndryshme. te Drejtorisë së Shërbimeve publike dhe drejtorive tjera

Gjatë periudhës Janar –Qershor, në bashkëpunim me konsulentët e Gizit Gjerman dhe komisioneve ndërkomunale për rajonin e Dukagjinit, për Komunitat Pejë, Istog, Klinë , Deqan dhe Junik është hartuar Plani Ndërkomunal për menaxhimin e Integruar të mbeturinave – PNMIM po ashtu është hartuar edhe VSM – Plani i Veprimit Strategjik për Mjedis dhe të njëjtat plane janë në diskutim Publik.

Nga Zyra e Kryetarit është themeluar grupi punues për projektin e Fizibilitetit të Qendrës të Riciklimit në Komunën e Istogut dhe i njëjti Grup së bashku me konsulentët e jashtëm është në përfundim të hartimit të Fizibilitetit të kësaj Qendre ku paraprakisht edhe është caktuar lokacioni i oborrit riciklues për implementimin e këtij projekti.

ZYRA KOMUNALE PËR KOMUNITETE DHE KTHIM RAPORTI I PUNËS PËR PERIUDHËN JANAR-QERSHOR 2025

Për	z. Ilir Ferato, Kryetar i Komunës së Istogut
Zyra	Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim
Raportuesi	Rasim Mahmutović, Shefi i Zyres Komunale për Komunitete dhe Kthim
Periudha raportuese	Janar – qershor 2025

HYRJE

Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim (në vazhdim do i referohemi si ZKKK), është përgjegjëse për rritjen mbrojtjes së të drejtave të komuniteteve dhe për sigurinë e qasjes së drejtë të komunitetit në

shërbimet publike në nivel komunal. Është pjesë integrale e Komunës dhe strukturës së përgjithshme administrative.

Që nga fillimi, ZKKK ka qenë e inkuadruar në procesin e përmirësimit të marrëdhënieve ndëretnike dhe formimit të klimës së duhur për riintegrim të të gjitha komuniteteve që jetojnë në Komunën e Istogut. Struktura e ZKKK-së sipas pozitës, gjinisë dhe përkatnisë etnike, është paraqitur më poshtë.

NR	EMRI DHE MBIEMRI	POZITA	GJINIA
1.	Rasim Mahmutović	Shef i ZKKK-së	M
2.	Almina Eco	Zyrtar për integrim dhe drejta të komuniteteve	F
3.	Vesna Maliković	Zyrtare për kthim të qëndrueshëm	F
4.	Esad Samkić	Zyrtar për buxhet dhe financa	M
5.	Abedin Ncziraj	Zyrtar për kthim të qëndrueshëm	M
6.	Armend Keraj	Zyrtar për kthim të qëndrueshëm	F
7.	Aida Kelmenaj	Zyrtar për integrim dhe drejta të komuniteteve	F

PËRMBLEDHJE

Gjatë peridhës së lartëcekur, ZKKK-ja në Komunën e Istogut ka pranuar gjithsej 18 lëndë. Kemi realizuar vizita në terren, kemi pasur takime me organizta të huaja dhe vendore lidhur me realizimin e projekteve që ka ZKKK-ja.

Në kuadër të punëve të rregullta, ZKKK kryen edhe punë të tjera si në vijim:

- Angazhohet për integrimin e të gjitha komuniteteve në komunë tonë, duke iniciuar çështjen e bashkëjetesës së komuniteteve pakicë me atë shumicë;
- Merrë pjesë në mbledhjet e Komiteteve, si: Komitetin për Komunitete, dhe në këtë Komitetë kontribonë dhe mbronë interesat e të gjitha komuniteteve të cilat jetojnë dhe punojnë në Komunën e Istogut.
- Bashkëpunon me Ministrin për Komunitete dhe Kthim me qëllim të realizimit të shumë projekteve në të mirë të të gjitha bashkësive minoritare etnike dhe bashkësive të tjera;
- Viziton familjet të cilat janë kthyer nga shtetet fqinje dhe vendet tjera, me qëllim që të njihet me problemet e tyre në të cilat ata hasin dhe integrimin e tyre në shoqërinë Kosovare. Gjithashtu viziton edhe familjet që ende gjenden në hapësirat e shteteve fqinje, ku bisedon me ata persona të shpërngulur dhe njëkohësisht i njofton me mundësinë e kthimit dhe mënyrën si mund të kthehen ata.
- Bashkëpunon me organizatat joqeveritare të cilat merren me kthimin e personave të kthyer siç janë: UNHCR, IOM, USAID, MercyCorps, OSCE, DRC etj.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA (Në kuadër të Planit të Punës së ZKKK-së)

ZKKK-ja, duke u bazuar në kompetencat e saj, ka planin e punës, në të cilin përfshihen planifiket për aktivitet të cilat presin që të realizohen gjatë vitit. Planifikonë dhe menaxhon me të gjitha kodet buxhetore, me përjashtime të shpenzimeve komunale. Me poshtë i gjeni të listuara aktivitetet e planifikuara:

- Asfaltimi i rrugës "sarajeva dhe Isuf Visoqi" në Dobrushë

- Ndertimi I rruges Kamer Loshi ne Veriq
- Ndërtimi i rrugës "Shaban Hajrezaj" në Llukafë të Thatë
- Ndertimi I rruges ne lagjen Gerguri dhe Berishaj ne Llukafë
- Ndërtimi i rrugës "Musë Brahimi" dhe Nurqaj në Kashicë
- Asfaltimi i rrugës "Bjelopoljska" në Dobrushë
- Ndërtimi i rrugës në Llukafë të Thatë
- Ndertimi I rruges ne Saradran- Lugu i Drinit

AKTIVITETET NË BASHKËPUNIM ME MKK

- Komuniteti komunal për kthim ka jep ropozimin komisionit qendror për ndërtimin të 20 shtëpijave për ndertimtari

PROCESI I RIATDHESIMIT

Të riatdhesuar siapas SMR

- Sipas Sistemit të Mënaxhimit të Rasteve, kemi 3 persona të cilët janë riatdhesuar si individ

Kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së

- Kemi gjithsej 5 kërkesa të parashtruara pranë ZKKK-së për ndihmë në Programi, të cilat KKR-ja i ka shqyrtuar dhe ka vendosur si në vijim:
 - 2 kërkesa për Akomodim me qira, të aprovuara nga KKR-ja,
 - 2 kërkesë për Renovim, në pritje të kompletimit të dokumentacionit nga pala e riatdhesuar, në mënyrë që të shqyrtohet nga KKR,
 - 1 kërkesë për Orendi Shtëpiake, në pritje të kompletimit të dokumentacionit nga pala e riatdhesuar, në mënyrë që të shqyrtohet nga KKR.

Komuna Istog
Datë;10.07.2025

Kryetari i Komunës
z. Ilir FERATI





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



ZKA

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KOMUNËS SË ISTOGUT PËR VITIN 2024

Raporti i nënshkruar nga
Vlora Spanca,
Auditore e Përgjithshme

Prishtinë, qershor 2025

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Komunës së Istogut për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2024, në përputhje me Ligjin për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i kualifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Istogut (KI), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2024.

Sipas opinionit tonë, përveç ndikimit të çështjes/ve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore të Komunës së Istogut, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, Ligjin nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për Opinion të Kualifikuar

- B1 Pagesat në vlerë 626,785€, sipas vendimeve gjyqësore përmbartimore për mbulimin e obligimeve që rrjedhin nga kontrata kolektive për paga jubilarë dhe shujta, ishin paguar dhe regjistruar në kategori ekonomike jo adekuate; dhe
- B2 Nënvlërim i pasurisë në vlerë 24,543€ si rezultat i mos regjistrimit në sistemin "e-pasuria" të pasurisë jo kapitale të blerë gjatë vitit 2024.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.1 Çështjet që ndikojnë në opinion të auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Në kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjes/ve të përshkruara në seksionin Baza për Konkluzion të pajtueshmërisë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit Komunës së Istogut kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

- A1 Në dy (2) raste, ishte bërë shfrytëzimi i pronave komunale me kontratë të skaduar;
- A2 Në dy (2) raste, kishte mangësi në procedurat e dhënies së subvencioneve; dhe
- B3 Në tre (3) raste, faturat në total prej 127,675€ kishte vonesa në pagesë deri në 30 ditë pas afatit të lejuar për pagesë.

Më gjerësisht shih nënkapitullin 2.2 Çështjet që ndikojnë në konkluzionin e pajtueshmërisë

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat e tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Kryetar i Komunes është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Kryetar i Komunes është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryetar i Komunes është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës së Istogut.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Komunës së Istogut është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Komunës së Istogut në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objekti ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Komunës së Istogut me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontroleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
